

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7346 E martë 7 Nëntor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

**Është fjala për tri data historike** ngjitur me njëra-tjetrën, datat 7, 8 dhe 9 Nëntor që ndryshuan historinë. Plot 100 vjet më parë, më 7 Nëntor 1917 Revolucionari ...

Vijon në faqen 20

Nga JORGJI KOTE

**Mbi tri data që ndryshuan historinë**



Opinion i Ditës

Nga BARDH SPAHIA

**Nga çunat e Ramës e Tahirit, te zotërinjtë e drogës**

Cdo qytetar shqiptar, në veri apo në jug, në Shkodër apo në Korçë, në Tropojë, Malësi të Madhe, Pukë apo në Sarandë e Gjirokastrë, i majtë, i djathtë ..

Vijon në faqen 21



Rama: Shkelësit do procedohen penalisht

## Sahatet e ujit, 270 mijë familje kanë 90 ditë afat për matësit

"Kush ka puse në shtëpi, duhet të pajiset me leje dhe me sahat. Janë 25 mijë familje në këtë gjendje"

Nga ORNELA MANJANI

Nga 1 shkurti 2018 të gjithë konsumatorët që kanë lidhje të paligjshme në sistemin e ujit do të procedohen penalisht. Kryeministri Edi Rama bëri këtë deklaratë në mbledhjen e Task Forcës, që do të zbatohet ...

Në faqen 11

## "ZAGANI 3" / RREFIMI I NJE TJETER OFICERI POLICIE, I DEKORUAR NGA VETE TAHIRI

# "INCIDENTI ME HABILAJT KUR BLOKUEM 'AUDIN' E MINISTRIT"

Bledar Naçi: Përplasja pasi i ndalua në postblokun e Levanit. Na shanë dhe na kërcënuan, por u liruan me urdhër të drejtorit të policisë



(Në foto) Ish-efektivi i Antigrögës së Fierit Bledar Naçi. Ish-Ministri i Brendëshëm Saimir Tahiri. Audi i perdorur nga vëllezërit Habilaj



### PROPOZIMI I MINISTRISË

"Çdo e ardhur të tashme 13-23%, të drejtat e autorit taksim 15 për qind"

Në faqen 10

### BATUTAT MES DEPUTETEVE

PD-ja ikën nga komisionet, çfarë s'u pa te Siguria, Ligjet dhe Ekonomia

Në faqen 5

### REAGIME E KRITIKA

Kanadaja hap rrugën për 1 mln emigrantë, Hussen: Përse na duhen

Në faqen 17

### AKUZAT NDAJ TIJ

Kontrabanda e naftës "Virxhin", kapet në Zvicër biznesmeni Adrian Xhillari

Në faqen 14

### RREGULLAT E SIGURISË



**Vendimi i qeverisë, Garda do të ruajë drejtuesit e vetingut, përfutuesit**

Në faqen 7


Blutë kontrolle antikanabis në banesat e 2 të rinjve dhe në Vlorë, 6 persona në pranga

## U arratis me pranga në duar, "blindohet" Saranda

Ermir Idrisllari u kap me kushëririn e tij për vjedhje me dhunë

Nga ARBËR SULO

Një 26-vjeçar nga Saranda është arratisur nga furgoni i policisë me pranga në duar. Ermir Idrisllari u arrestua dy ditë më parë nga blutë e qytetit bregdetar së bashku me kushëririn e tij, Kosta Pashajin, pasi i grabitën me



dhunë shtetasit F.M. shumë prej 30.000 lekësh. Në momentin që shoqëroheshin në rajon me furgonin e policisë, Idrisllari ka hapur derën e automjetit dhe është larguar me vrap. Mësohet se ai është ndihmuar nga bashkëfshatarët e tij. Menjëherë ...

Në faqen 15

## DOSJA "HABILAJ-TAHIRI"

### INTERVISTA

Ish-efektivi i Antidrogës u arrestua, pasi u akuzua nga një i dënuar se mori 10 mijë lekë

# U dekorua nga Tahiri, Bledar Naçi: Më ngritën kurth pas përplasjes me Habilajt

"Zagani 3"/ Rrëfimi i policit të tretë, që u fundos pasi guxoi

Basir Çollaku

**B**ledar, djem si ti i bëjnë nder policisë. Sot je shembull për të gjithë efektivet e Policisë së Shtetit". Këto fjalë i ka shkruar Saimir Tahiri në tetor 2013, pasi oficer Bledar Naçi shpëtonte një vajzë 9-vjeçare nga rrëmbimi. Ky polic u quajt hero nga ish-ministri i Brendshëm.

Një vit më pas, pasi Bledar Naçi bashkë me efektivet të tjerë si Antonio Nazeraj dhe Dritan Zagani guxuan dhe ndaluan "Audi"-n famëkeq të vëllezërve Habilaj, nisi tatëpjetë për të gjithë.

Në një intervistë të gjatë për "Gazeta Shqiptare", ish-efektivi i Antidrogës së Fierit, Bledar Naçi tregon incidentin që pati në fillim të 2014-ës, kur u shoqëruan në komisariat dy kushërinjtë e ish-ministrit të Brendshëm. Ai rrëfen se si "Audi" AA003GB kundërshtoi kontrollin dhe i iku postbllokut të policisë. Më tej, ata u shoqëruan, megjithëse kërcënuan efektivet e policisë. "Do ta shikoni ç'a do ju bëjmë, është makina e ministrit", rrëfen Naçi përplasjen me Habilajt. Pas këtij incidenti, njësoj si shokët e tij, Naçi u akuzua se i kishte marrë 10 mijë lekë të reja një personi, që sot rezultoi i dënuar për disa vepra penale. "Gazeta Shqiptare" ju sjell sot pjesën e parë të intervistës me ish-efektivin e policisë, Bledar Naçi (sot ndodhet në një vend të BE), i cili është dekoruar dhe përgëzuar nga kryeministri Edi Rama dhe ish-ministri Saimir Tahiri.

**Bledar Naçi një oficer policie i dekoruar nga kryeministri dhe ministri i Brendshëm, për çfarë jeni dekoruar?**

Jam dekoruar nga ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri dhe kryeministri gjithashtu, në datë 12 tetor 2013, për rezultate të larta në punë.

**Jeni ndër të paktët e dekoruar?**

Mund të them se jam i pari i dekoruar nga ish- ministri, kam qenë i ftuar dhe falënderuar personalisht nga ministri dhe kryeministri i vendit.

**Në zyrën e tij?**

Jam ftuar në zyrën e kryeministrit në datën 12 tetor dhe gjatë prezantimit të 12 drejtorëve të rinj të qarqeve dhe drejtorit të përgjithshëm të policisë në atë kohë, Artan Didi.

**Por pas disa muajsh, nga i dekoruar për sakrificë në punë, ju u deklaruar nga kryeministri dhe ministri në trafikant, kriminel, ordiner, si u shndërruar kaq shpejt?**

Nuk më ka pëlqyer të prononcohem shumë nëpër media, por duke marrë shkas nga emërtimi që më ka bërë zoti kryeministër me fjalët ordiner, kriminel trafikant, dua t'i them zotit kryeministër se unë, qhem Bledar Naçi dhe jam djali i dy prindërve punëtorë, që kanë qenë anëtarë dhe kontribuues në Partinë Socialiste nga viti 1991 dhe kanë qenë ndër themeluesit e saj në Frakull të Fierit dhe dua që të menjdojë se për këtë intervistë kam qenë i shtyrë, shitur apo



Ish-efektivi i Antidrogës së Fierit, Bledar Naçi

paguar nga të tjerë persona. Dua t'i kujtoj në radhë të parë se kam qenë një punonjës i thjeshtë në Policinë e Shtetit dhe kam punuar nga viti 1999 deri më 2 maj 2014, datë në të cilën jam arrestuar. Por, kjo nuk i jep të drejtë atij të emërojtë me fjalët, ordiner, hajdut, bandit.

**Sepe ju nuk jeni dënuar nga gjykata për këto vepra që ju akuzon kryeministrit?**

Absolutisht jo. Për kryeministrin është më e lehtë të besojë një trafikant të genieve njerëzore dhe fëmijësh, që ka qenë dhe i skeduar nga ana jonë në fushën e narkotikëve, se sa të besojë tre ish-punonjësit policie, që kanë punuar shumë vite në Policinë e Shtetit.

**Nga dekorata, të këto emërtesa...**

Dua t'i kujtoj edhe një herë z. zryemistër se pasuria e vetme ime janë dy dynym tokë sipas ligjit 7501 dhe kam jetuar në shtëpi me qira e jo në ndonjë vilë, si mund të menjdojë ai. Këto mund të verifikohen.

**Dhe...**

Dua të shtoj akoma se gjatë punës kam kaluar sasi të ndryshme e të shumta të drogës së kapur, drogë të llojeve të ndryshme dhe më janë ofruar të bashkëpunoj me trafikantët, oferta nga trafikantët të ndryshëm, por nuk jam shitur dhe këto sasi droge janë sekuestruar e personat janë arrestuar.

**Të mbetemi edhe një herë këtu, ka pasur përpjekje nga trafikantët për t'ju korruptuar ju dhe kolegëve tuaj?**

Po, pikërisht. Më janë ofruar edhe sasi të ndryshme parash.

**Sa?**

Për të favorizuar persona të ndryshëm. **Nëse mund të themi raste, sa ju janë ofruar?**

Sasirtë kanë qenë të ndryshme, varet nga sasi që kemi kapur dhe rrezikshmëria e veprave penale të personave që kemi kapur; qoftë persona në kërkim, që ishin me dosje

apo për favorizim trafiku të lëndëve narkotike.

**Deri ku kanë shkruar me ofertat e tyre?**  
Dua të them se më kanë ofruar mbi 50 mijë euro për të bashkëpunuar dhe favorizuar trafikun në qarqun e Fierit.

**Dhe si keni vepruar?**

Absolutisht jo.

**I ndaluar?**

Nuk i kanë ofruar vetë direkt, por indirekt me persona të ndryshëm, nuk vinin vetë ata.

**Jeni dekoruar dhe më pas arrestuar, çfarë ka ndodhur saktësisht që ju përfunduat në qeli, ta saktësojmë e qartësojmë me detaje?**

Po jua shpjegoj se si ka ndodhur arrestimi im dhe ngjarja konkrete, që ndikoi në arrestin tim dhe kolegëve të mi, Antonio Nazeraj dhe një kolegj tjetër. Jam akuzuar nga një person, që quhet Mikel F.

**Dhe që është?**

Aktualisht ky person është i burgosur në Fier për vepra penale të trafikut të genieve njerëzore, trafik fëmijësh, e prostitucioni...

**Ky është një nga akuzuesit tuaj?**

Ky është një person i përdorur nga SHKB për të ngritur këtë kurth ndaj meje dhe kolegëve të mi.

**Vetëm ky?**

Personi ka qenë karremi le të themi, që është përdorur, por nxitësit kanë qenë të tjerë. Sepe historia nuk është vetëm nga SHKB e Fierit, por nxitësit janë lart.

**Ku lart?**

Lart në qeveri. Unë jam arrestuar me urdhër të Saimir Tahirit dhe të askujt tjetër.

**Si e provoni ju që jeni arrestuar me urdhër të Saimir Tahirit, keni fakte, dëshmi, argumente?**

Po ju tregoj ngjarjen. Personi që më ka akuzuar ju thashë se quhet Mikel F., që është në burg i dënuar për ato vepra që ju përmenda. Por nuk është i vetëm, sepe është ndihmuar edhe nga një oficer policie jo i SHKB, i cili është oficer policie në qarqun e



"Audi" i ish-ministrit Tahiri

Fierit, por që para disa vitesh ka qenë person i dënuar për drogë.

**Ku e bazoni këtë, keni parë vendime, shkresa, apo keni thjesht informacion?**

Këtë person ne e dimë mirë që ka qenë i dënuar me vite burg për trafik droge dhe është futur tashmë në Policinë e Shtetit.

**E dinë edhe eprorët tuaj këtë informacion?**

Po, patjetër që e dinë.

**Emri i tij?**

Tani emri i personit është i qartë, se është thënë jo vetëm nga unë, por edhe nga kolegët e tjerë.

**Pra, ju pretendoni se dy njerëz të dënuar për trafik janë përdorur kundër jush?**

Doja të sqaroja se si ka qenë ngjarja dhe se si është bërë montazhi i saj. Mikel F (drege emrin e plotë) ka qenë i dënuar dhe kish të detyrim paraqitje një here në javë në sektorin e luftës kundër krimit të organizuar dhe trafiqeve, ku duhej të paraqitej pranë një oficeri të caktuar për këtë mbikëqyrje. Ne e njihim se ishte kontingjent.

**Dhe çfarë ka ndodhur?**

Një natë kemi qenë me shërbim, unë, Nazeraj dhe kolegu tjetër i sektorit tonë, por edhe punonjësit të tjerë të policisë të sektorit të trafiqeve, nuk ishim vetëm ne. Ky person është ndaluar nga unë, Nazeraj dhe kolegu tjetër. Ishte me një mjet "Audi", është kontrolluar dhe kishte bidonë që transportonin lëndë djegëse, benzol, që përdorin skafet dhe gomonet.

**Ky që ju akuzoi?**

Po, ky person, Ferko. Ne e ndaluan dhe e kontrolluam, sepe kishim dyshimet tona dhe informacione se ishte duke tërhequr dhe furnizuar skaf me karrel. Këtë informacion e kishim nga burimet tona, ndaj e kishim në mbikëqyrje. Atë natë e kemi ndaluar dhe nuk gjetëm gjë veç bidonëve me benzol, si ai që përdorin skafet. Nuk është pyetur shumë për të mos e bërë të dyshonte se e kishim në vëzhgim.

**Pastaj?**

Rezultoi se ishte pa leje drejtimi. Unë kam marrë sallën operative dhe e kam pyetur për verifikim nëse kishte vepra të tjera penale apo ishte në kërkim.

**Si ju përgjigjen?**

Më thanë se personi është person me probleme që paraqitet të trafiqet, por është pa leje drejtimi, që ishte e bllokuar në Lezhë.

**Si vepruar?**

Kërkua nga salla të dërgonin një patrullë policisë rrugore, sepe personi ishte pa patentë dhe u larguam për të mos e bërë të dyshonte dhe të vazhdonim ta ndiqnim. Kjo ka qenë ngjarje e marsit, për të cilën ne jemi akuzuar më vonë nga SHKB.

**Akuza thotë se ju keni marrë 10 mijë lekë të reja nga ky person?**

Personi pretendon, pasi ka ardhur





← dy javë me vonë, duke na akuzuar në dhe ka thënë se këta persona më kanë marrë 10 mijë lekë të reja, për mua personalisht me emër dhe për kolegët.

#### Ja keni marrë, apo jua ka dhënë?

Kjo është sajësë dhe gjenjështër, nuk është provuar asnjëherë, sajësë dhe manipulim i SHKB. Pas dy javësh Ferko më ka marrë në telefon duke më thënë se më keni marrë 10 mijë lekë dhe kam kërkuar të di kush është ky person. Më ka marrë sërisht në numrin e punës dhe numrin personal, të dy numra të deklaruar duke më provokuar për t'u sqaruar kjoja për lekët e marra.

#### E takuat?

I thashë eja te policia dhe këtu sqarohemi. Më ka marrë sërisht dhe në qendër të qytetit e kam takuar, ndonëse e dija se ishte një inskenim dhe kombinacion. E kam takuar, isha edhe me dy kolegët të tjerë të punës dhe e takova për shumë pak minuta. Personi ishte me të njëjtin mjet që e ne e kemi ndaluar, një "Audi" me ngjyrë gri.

#### Dhe pastaj?

Kam parë nga pas tij makinën e SHKB, sepe e kam njohur dhe kam njohur personat që ishin në këtë makinë, sepe ishte manipulim, ishin gjashtë apo shtatë metra afër për të na përgjuar. Personi ka zbritur me një aparat në dorë dhe me emër më ka thanë se ti dhe kolegët tuaj duke përmendur emrat, më keni marrë lekët.

#### Ju si reaguat?

I thashë nëse ti na akuzon për këtë atëherë, eja të shkojmë në polici dhe të bësh akuzën dhe ankesën për këtë pretendim që ke. E kam tërhequr për krahu dhe e i thashë eja të sqarojmë ankesën dhe akuzën ndaj meje dhe kolegëve të mi.

#### Çfarë tha?

Kur i thashë të shkojmë në polici, se doja të shkoja atje dhe t'i zbuloja përgjuesit, ai është marrë në telefon nga shefi i SHKB se ishte shumë afër punës metrash nga ne dhe ka ikur me nxitim dhe është larguar. Me kaq bisedë unë jam arrestuar nga SHKB, me këtë bisedë të bërë me Mikel P. Si ka mundësi që një person pa leje drejtimi, i skeduar nga trafikët, që paraqitet rregullisht në polici e mbikëqyrje, përdorej nga SHKB në Fier dhe Tiranë për të bërë skema të tilla? Këtu ka një shkelje dhe paligjshmëri totale.

#### Ka një fillësë më të hershme?

Sigurisht. Kjo si për mua, edhe kolegët e mi. Se kam punuar në shumë sektorë në polici, duke përfshirë edhe sektorin e përgjimeve, ndaj e kuptoja dukshëm skemën e tyre.

#### Dalim të ngjarja?

Duke qenë edhe një punonjës i dekoruar, nuk ka mundësi, vetëm se me urdhër të ish-ministrit...

**Përsë, çfarë i keni bërë ju atij që ministri të përfshihet në këtë histori. Unë pyes, ju dhe kolegët tuaj keni ndaluar një tjetër "Audi", një tjetër makinë, keni qenë në ngjarje, çfarë ka ndodhur?**

Gjatë 2013-ës dhe 2014-ës ka qenë një plan masash veprimi miratuar nga drejtoria dhe

INTERVISTA/ Bledar Naçi tregon përplasjen me kushërinjtë e ish-ministrit të Brendshëm

# Oficeri i policisë: Incidenti me Habilajt, na shanë, por drejtori na urdhëroi t'i lironim

"Ndalua 'Audi'-n AA003GB, vëllezërit na thanë: Është makina e ministrit"

3

## OFICERE POLICIE "TE PERNDJEKUR"

Bledar Naçi është i treti efektiv policie që u përndoq në Shqipëri, pasi guxoi të përplasej me kushërinjtë e ish-ministrit të Brendshëm. Në fillim ishte Dritan Zagani, i cili denoncoi lëvizjet e "Audi"-t famëkeq tek eprorët e tij. Zagani u akuzua se "u shiti" informacion italianëve. I dyti, Antonio Nazeraj, efektiv i Antidrogës, pjesë e "postbllokut të Levanit", që ndaloi Habilajt u arrestua nga SHKB dhe më pas u lirua. I treti, Bledar Naçi u vu nën vëzhgim nga SHKB, u arrestua dhe u lirua.



Bledar Naçi

eporët e saj. Ka qenë për pika të lëvizshme kontrolli në segmentet nacionale, në autostradën Levan-Fier dhe në akse të tjera rrugore, duke bërë shërbime edhe gjatë natës.

#### Dhe?

Një natë kemi qenë me shërbim në aksin Levan-Tepelenë, me dy ish-kolegë të mi, Antonio Nazeaj dhe kolegë të sektorit Antidrogës dhe dy punonjës policie të komisarariatit. Këtë natë gjatë kontrolleve të shumta kemi ndaluar një automjet të markës "Audi A8" i zi, AA003 GB.

#### Arsyeja e ndalimit?

Arsyeja e ndalimit të këtij mjete, sepe kishim dyshime për transport të këtij automjeti të lëndëve narkotike dhe për të verifikuar personat që ndodheshin në të. Në momentin e parë të prezantimit kanë qenë katër persona, dy vëllezërit Habilajt të shoqëruar me dy femra. U kërkuam të bëjmë kontroll mjete dhe dokumentet e identifikimit.

#### Pranuan?

Jo, nuk kanë pranuar asnjëherë. Kemi pasur një debat me vëllezërit Habilajt, që na kanë fyer e kërcënuar.

#### Çfarë kërcënim?

Na thanë se nuk keni shanse dhe nuk ka asnjë mundësi që ju të kontrolloni këtë automjet dhe kur jemi munduar të bëjmë kontroll me forcë, ata na janë larguar me shpejtësi, duke xhiruar gomat.

#### Përsë nuk donim?

Kemi debatuar dhe na kanë fyer, dhe janë larguar me forcë. Mjeti ishte i ndezur. Në këto momente kemi marrë në radio pikën tjetër të kontrollit, kolegët tanë që ishin më poshtë nesh, duke iu thënë se ky automjet që u dhamë targën na ka ikur. Iu thamë që është larguar dhe s'ka pranuar kontroll, iu thamë që po ju vijmë edhe ne në ndihmë, ndaj duhet ndaluar.

#### U nisët?

Po, në këtë momente kemi shkuar në ndjekje dhe "Audi" ishte ndaluar nga kolegët tanë. Sërisht dhe këtu ka pasur debat edhe me kolegët dhe është nxehur edhe më shumë situata. Ne, grupi, unë dhe kolegët donim t'i shoqëronim, nuk po na jepnin dokumentet dhe nisën kanosjet dhe fyerjet ndaj nesh me fjalor të rëndë.

#### Kërcënim?

Ju nuk e dini se kë keni ndaluar, se kush jemi ne dhe ju do ta merrni vesh shumë shpejt se kush jemi dhe aty na kanë thënë se kjo makinë është e ministrit. Kështu kanë thënë kur kanë parë se situata ishte agravuar.

#### Dhe si ndodhi?

Na kanë fyer e kërcënuar, pastaj thanë se kush janë dhe e kujt është makina. Duke

përmendur emrin e ministrit u stepëm pak, nuk e besuam, menduam se është lojë. Në këto momente, njëri nga Habilajt ka marrë në telefon dikë dhe i ka thënë se ku ishin dhe janë këta të Antidrogës së Fierit dhe duan të na shoqërojnë atje tek ju. Nga ky moment janë shoqëruar.

#### Janë shoqëruar?

Po, janë shoqëruar dhe ne të gjithë siç ishim, kemi vazhduar për në komisarariat.

**Të saktësojmë diçka, në një vendim pushimi prokurorle, drejtues të policisë Fier thonë se ky mjet nuk është shoqëruar, ndërsa ju dhe kolegët thoni se e keni shoqëruar?**

Jam duke ju thënë se është shoqëruar në komisarariat, makina ka shkuar në mjediset e Drejtorisë së Policisë Fier, është futur në oborrin e kësaj drejtorie.

**Dhe ju keni qenë një nga oficerët që e kanë shoqëruar?**

Po, kam qenë një nga pjesëtarët e këtij shoqërimi. Sepse ishim ne pika e parë e kontrollit që u konfrontuam me ta dhe na kanë fyer banalisht, kanosur e kërcënuar, ishim pjesë e këtij shoqërimi.

**Shkuat bashkë me mjetin në Drejtorinë e Policisë Fier?**

Po, personat kanë shkuar bashkë me mjetin në Drejtorinë e Policisë, Fier.

#### Çfarë ka ndodhur aty?

Pasi kemi shkuar aty, kemi tentuar për të bërë kontrollin. Në momentin që kemi tentuar për të bërë këtë kontroll, këta persona janë pritur nga shoferi i ish-drejtorit të policisë së qarkut Fier.

#### Kush ishte ky person?

Personi që ishte shofer personal, ishte një djalë nga Fieri, e thërrisnin Dume, me sa kujtoj quhej Ar. Tahiri (tregon emrin e plotë) dhe është kushëri shumë i afërt i Saimir Tahirit.

#### Jeni i sigurt?

Patjetër që po, unë jam rritur në Fier dhe kam punuar gjatë si oficer policie në këtë qark, shoferi është nga Fieri me këtë emër dhe kushëri i afërt i ish-ministrit Saimir Tahiri.

#### Si u veprua më pas?

Këta persona kur janë takuar me shoferin, kanë nisur sërisht të bëjnë fyerje, kanosje të mëdha ndaj nesh, ndaj të gjithë ne policëve që ishim aty në oborrin e Drejtorisë së Policisë në Fier dhe pikërisht e kishim me ne, grupin që i ndalua. Te oborri i drejtorisë na kanë kërcënuar dhe na kanë thënë nuk keni bërë mirë që na keni ndaluar, sepe kjo është makina e ministrit dhe do ta shikoni se çfarë do t'ju bëjmë ne, do t'i shikoni pasojat, do ta shikoni se çfarë do të ndodhë me ju.

**Kur një mjet dhe personat shoqërohen në polici, ka një procedurë ku duhet të këtë gjurmë të këtij veprimi, të shënohet nëpër libra, apo filmohen veprimet nga kamerat?**

Sigurisht. Çdo makinë që shoqërohet regjistrohet, verifikohen personat, shënohen të dhënat, si dhe arsyeja e shoqërimit të këtij automjeti, që duhet ta relatojmë ne. Makina nuk ka qëndruar më shumë se 10, 15, apo 17 minuta, jo më tepër mendoj dhe jemi urdhëruar nga salla operative që makina dhe personat duhet të lihen të lirë.

#### Ju nuk reaguat?

Po, sigurisht po. Iu thamë për çfarë arsye kjo makinë duhet të largohet, sepe në përveç të tjerash kemi pasur një konflikt me këta persona të këtij mjete në pikën e kontrollit.

#### Cila ishte përgjigja?

Kur i kemi kërkuar shpjegime për këtë veprim sallës, na është thënë se këta persona dhe ky mjet duhet të dalin, sepe është urdhër nga drejtori. Dhe për mua, me kaq vite punë në Policinë e Shtetit është rasti i parë që një mjet hyn i shoqëruar në mjediset e komisarariatit, në këtë rast drejtorisë së policisë, dhe të mos verifikohen të dhënat, të mos shënohen e të mos bëhet as identifikimi i personave e jo më të mos kontrollohet as makina.

**Në regjistrat e policisë nuk ka gjë të shënuar?**

Këtë nuk e di, ne donim të bënim raport shërbimi për shoqërimin e këtij automjeti, por nuk e kemi bërë atë ditë, por të nesërmen, na është urdhëruar nga salla me urdhër të drejtorit, se makina duhet të dalë, sepe është makinë e Ministrisë së Brendshme dhe dalja është bërë me urdhër të drejtorit. Ndonëse ne nuk kemi pranuar, na është thënë se është urdhër i prerë për ju. Dhe kështu u është hapur porta dhe janë larguar.

**Ju bëte informacion tek eprorët tuaj për këtë ngjarje?**

Tek eprorët tanë e kemi bërë këtë duke e shpjeguar.

#### Edhe me shkrim?

Po, e kemi bërë të nesërmen me shkrim dhe e kemi dërguar tek eprorët tanë, për të gjithë ngjarjen që ka ndodhur.

#### Ka gjurmë?

Po, ky informacion duhet të këtë gjurmë, sepe ne kemi bërë raport shërbimi dhe informacioni arkivohet. Sepse ka informacione SK1 dhe SK2 dhe ka informacione që ne kemi bërë për persona nën hetim për këtë ngjarje, për arsyen e shoqërimit të automjetit.

(vijon në numrin e nesërm)

# PROKURORI OPOZITA

"Nuk lejojmë që prokuroria të bjerë në kthetrat e narkomafies"

## Mandati i Liallës, Basha paralajmëron Edi Ramën: Mos ceno Kushtetutën

"Tahiri, të enjten në Kuvend, përballje totale"

Valentina Madani

Kreu i opozitës, Lulzim Basha paralajmëroi dje një javë përballjeje me qeverinë pas sekuestërimit të mbi 800 mijë eurove në Elbasan dhe patentave të Tahirit në makinën e biznesmenit Sota. Kryetari i PD theksoi se java e përballjes ka nisur në komisionet parlamentare, ndërsa do të vijojë edhe ditën e enjte në Kuvend në seancën plenare. "Shikoni analizën e GF për parcelat e drogës që janë zbuluar nga viti 2015. Këtë vit që kultivimi i drogës nuk është i njëjtë si në 2016, Rama bërtet 'fitore', por nuk është as Rama dhe as policia e korrupsuar, por përgjegjëse për rënien e prodhimit është çmimi. Shkoni në Tepelenë, më lirë do të blihi kanabisin se çajin. Ka shkuar kilja e kanabisit nga 50 deri 80 euro kilogrami, pasi presin të trafikohen drejt Europës. Jemi në kushtet e narko-republikës", deklaroi z.Basha, pas mbledhjes së grupit parlamentar të PD-së. Sipas tij, "zgjidhje është largimi i Ramës që të shemben lidhjet e politikës me krimin dhe këtë nuk e bën Rama me planet sekrete. Plani sekret, që Edi Rama nuk është më plan sekret. Rama duhet të jepje dorëheqjen, do të zgjerohet koalicionin me çdo faktor politik dhe jo politik". Qeveri antimafie për të realizuar reformën zgjedhore. Kemi një strategji, e cila po shpaloset ditë pas dite. Kjo javë që ka nxjerrë në pah edhe trafikun e parave cash të trafikut të drogës është një javë përballjeje totale e opozitës në komisionet parlamentare, sikur do të vijojë edhe ditën e enjte në Kuvend", deklaroi Basha.

### MANDATI

Qeveria dhe opozita priten që të përfshihen në një tjetër përplasje, këtë herë për mandatin e kryeprokurorit Adriatik Lialla. Mandati i Liallës përfundon në datë 4 dhje-



Kreu i opozitës, Lulzim Basha

### ÇLIRIM G-JATA

"Komandimi i një prokurori të ri në vend të Liallës - shprehet juristi Çlirim Gjata - do përgjykonte titullarin e organit të akuzës si produkt politik. Kemi një parlament pluralist, por njëngjyresh, jo me një balancë si deri në 25 qershor. Kjo mazhorancë i ka votat për ta komanduar një prokuror të ri, me forcën e kartonit. Në këtë rast, edhe sikur të ishte njeriu më i ndershëm, do politizohej", deklaroi z.Gjata.

## Kryemadhi: S'ka më kthim pas, fillimi i fundit të qeverisë

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, me anë të një video përmblidhëse nga konventa që u mbajt të dielën në pallatin e sportit "Asllan Rusi" ka paralajmëruar aksion opozitar. Sipas saj, tashmë ka ardhur koha që shqiptarët të kenë një qeveri të re. Mes të tjerash, ajo shton se LSI ka marrë marshimin politik për të çliruar shqiptarët nga makthi i drogës. "Ky është aksioni për të shpëtuar Shqipërinë dhe shqiptarët. Prandaj, ne si LSI kemi marrë vendim për të nisur pa kthim pas marshimin tonë politik për të çliruar shqiptarët nga makthi i drogës, i krimin, i varfërisë, i papunësisë dhe pabarazisë. Ekonomia shqiptare është e sëmurë nga varfëria, nga keqeverisja, nga korrupsioni galopant. Ky është vetëm fillimi i fundit të saj. Sot gongu ra. Është emergjencë kombëtare krijimi i një qeverie të re, një qeveri antimafie që rikthen stabilitetin. Asnjë njeri nuk mund



Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi

të blejë dot zemrën, shpresën dhe pasionin e një anëtarë dhe një votuesi të Lëvizjes Socialiste për Integrim", thuhet në videomesazhin e Kryemadhit. Kurse para mediave, Kryemadhi deklaroi dje se nuk do të lejojë që Rama të vijojë me projektin e tij për Shqipërinë. Ajo u shpreh se Rama nuk është zgjidhja e problemit, por ai është vetë burimi i problemit e peng i krimin të organizuar. "Këtyrë kryeministri që mishëron regresin,

të keqen, negativën, i dhanë përgjigjen mijëra anëtarë të LSI në konventë. S'ka më asnjë kohë për të humbur. Rama po i hap përditë plagë të thella Shqipërisë dhe familjes shqiptare. Rezoluta e Konventës së LSI-së është pikërisht ajo që shqiptarët na kanë kërkuar. Kjo vetëdije politike po forcohet orë pas ore dhe ditë pas dite, duke u kthyer në vullnet popullor", deklaroi z.Kryemadhi.

i cili mbaron më 4 dhjetor të këtij viti dhe pritet të shkaktojë një përplasje të fortë mes opozitës dhe



Gjatë një seance parlamentare

### OERD BYLYKBASHI

"Nuk e fshihin me shoshë këtë pakt kriminal të Edi Ramës. Edhe agjentët e FBI-së që po vijnë në Tiranë nuk janë gjë tjetër, veçse 'pranga' të partnerëve në duart e këtyrë Puparogje të krimin, që nuk po di të ndalet në marrëveshjen e tij me krimin.?? Saimir Tahiri ishte vetëm stacioni i parafundit i kësaj 'linje metroje', për momentin të mbyllur për riparime kapitale", tha Bylykbashi.

mazhorancës. "Mandati i kryeprokurorit është zbatimi i ligjeve dhe çdo hap për të vendosur kthetrat e narko-mafies, do të përballet me opozitën. Rama ka hallin e Tahirit dhe të tjerëve dhe në funksion të ndalimit. Qëndrimi ynë është zbatimi pikë për pikë i Kushtetutës dhe ligjeve dhe çdo hap për të vendosur mafien në prokurori do përballet me ne. Rama ka hallin e Tahirit, nuk ka hall mandati. Në funksion të ndalimit të hetimit për Tahirin është gati t'i thotë këmbës dorë dhe e kundërta. Qëndrimi ynë është respekti i plotë i Kushtetutës. Nuk lejojmë asnjë tentim të kapjes së prokurorisë", - deklaroi kreu i PD-së.

### REFORMA

Teksa pritej që të niste puna për reformën zgjedhore, kreu i PD-së, Lulzim Basha, përjashtoi dje mundësinë që sipas tij, reforma zgjedhore të fillojë pa pasur një qeveri antimafie, duke vendosur kushte. "Reforma zgjedhore do të fillojë atëherë kur vend të ketë një qeveri antimafie, e cila në vend që të përdorë kriminelët dhe paratë e drogës për të blerë vota, t'i çojë ata para drejtësisë dhe t'i lërë shqiptarët të vendosin të lirë me votën e tyre qeverisjen dhe qeverinë që dëshirojnë", deklaroi Lulzim Basha. Me vendimin e fundit të Bashës, duket se reforma zgjedhore futet në një tjetër ngërç.



### Mandati, Panariti: Presim Liallën

Lëvizja Socialiste për Integrim përmes deputetit Edmond Panariti shprehu dje qëndrimin e saj lidhur me debatin e fundit për mandatin e kryeprokurorit Adriatik Lialla. Panariti deklaroi se duhet të pritet dhe të shikohet se çfarë do të ndodhë. Edmond Panariti u shpreh se, "presim Liallën, do apo s'do që të jetë dhe dy vite të tjera. Kryeprokurori i ri është në detyrë deri në dhjetor, më pas do të shohim si do të avancojmë me zëvendësin e tij. Jemi me vonesë për funksionin e komisionit që do të adresonte ndryshimet e reja. Mbetet për t'u parë. Nuk besoj se do të arrijmë në çështje vakumi. E përjashtoni mundësinë t'i zgjatet mandati edhe dy vite Liallës? Nuk kemi asnjë qëndrim, do të presim nëse do të kërkojnë në prokurori një gjë të tillë. Kjo çështje do të diskutohet në Komisionin e Ligjeve", theksoi deputeti i LSI-së.





“Mos u sill si mësuese, na je bërë si Baba Taku”... socialistët përplasen te ‘Siguria’

# PD braktis komisionet, debatet mes deputetëve për drogën dhe Tahirin

## Llaka-llaka e derr-dërr tek Ekonomia

Valentina Madani

Në komisionet parlamentare po disku tohet paketa fiskale 2018, por ajo është shoqëruar me debate të forta në katër komisione respektive mes mazhorancës dhe opozitës. Deputetët e opozitës vijojnë të ndjekin strategjinë e largimit nga komisionet parlamentare, pasi paraqesin pretendimet për ligjet dhe akuzat për drogën.

### SIGURIA

Komisioni parlamentar i Sigurisë Kombëtare diskutoi dje projektbuxhetin për vitin 2018 për SHISH. Ky shërbim nuk e ka pranuar shumën e planifikuar nga qeveria. Në mbledhjen e zhvilluar me detyrë të mbyllura pas kërkesës së zyrtarit të SHISH, me argumentin se mund të dalë informacion sekret, drejtori ekonomik, Ylvi Aga kërkoi shtesë fondi nga qeveria. Burime brenda komisionit konfirmojnë se SHISH e cëllosoi të pamjaftueshëm buxhetin e parashikuar. Qeveria ka planifikuar 1.5 mld lekë, por SHISH kërkoi fonde shtesë për godinën dhe për shpenzime operative (paga dhe përgjime). Burime për "Report TV" sqaruan se deputetët të PS kanë pranuar kërkesën e përfaqësuesit të SHISH që fondi të shtohet. "Kontribonin të siguria kombëtare" mësohet se janë shprehur ata. Ndërsa, Ministria e Financave i ka tërhequr vëmendjen SHISH, pasi sipas tyre, "nuk argumenton kërkesat". Në këtë moment kanë ndërhyrë deputetët e PD-së, të cilët deklaruan se ministria nuk mund të flasë me këtë gjuhë. Në përfundim të mbledhjes, të gjitha palët kanë rënë dakord për të votuar pro për rishikimin e rritjes së buxhetit për SHISH me 5.2%. Pas dorëheqjes së Visho Ajazit, në krye të SHISH është komanduar Helidon Bendo.

**LIGJET**  
Edhe Komisioni i Ligjeve diskutoi Buxhetin e vitit 2018. Edhe këtë herë debati i zhvilluar mes anëtarëve të opozitës në komision dhe atyre të mazhorancës ka pasur sërish në fokus ish-ministrin Tahirin. "Pak ditë më parë, një biznesmen u kap me 863 mijë euro dhe patentat e ish-ministrit, që betohej se nuk kishte patentë skafi. Politika nuk



Komisioni parlamentar i Sigurisë Kombëtare

dhi akuza edhe për qeverinë, për të cilën është shprehur se është e lidhur me krimin dhe se u ka dalë krah Habilajve për tri javë. "Qeveria u doli në krah Habilajve për tri javë. Në një situatë normale, me do të diskutonim për këtë ligj kaq të rëndësishëm. Por, kjo ndodh në një qeveri normale, jo në një qeveri të kapur në flagrancë me krimin", deklaroi Halimi, duke shtuar se qeveria në vend që të mbanet anën e drejtësisë, u bën alibinë kriminelëve. Nga ana tjetër, edhe anëtarët e Komisionit të Ligjeve të Lëvizjes Socialiste për Integrim nuk kanë qëndruar në komision për të diskutuar buxhetin e vitit 2018.

### EKONOMIA

Debatet për situatën e drogës krijuan dje tension mes deputetëve në Komisionin e Ekonomisë, ku ka qenë i pranishëm dhe ministri Arben Ahmetaj, për të diskutuar paketën fiskale 2018. Deputeti demokrat, Arben Shehaj është përplasar me deputetët socialistë dhe ministrin Ahmetaj, duke shkëmbyer edhe sharje mes tyre. "Që ne të mos flasim për hashashin, patentat, e demokratizimin, këtu kemi të bëjmë me një teatër, me një shfaqje, qytetarët shikojnë, e thonë këta nuk janë mirë nga mendja", - u shpreh deputeti i PD-së.

### INTEGRIMI

Një tjetër komision kuvendor u përshi paraditen e djeshme nga debatet. Seanca e shkuar e Komisionit të Integritimit u shoqërua me debate të ashpër dhe replika mes Genc Pollos, i cili ka hedhur akuza në drejtim të ministrit Dimitër Bushati pas arrestimit të Moisi Habilajt në Itali, si kreu i një bande droge dhe që sipas opozitës ka lidhje me ish-ministrin Saimir Tahiri. Po dje, debatet e një jave më parë ishin ende të freskëta dhe deputetët vazhduan me të njëjtën linjë. Komisioni i Integritimit është përfshirë nga debatet që kanë degjeneruar në fyerje dhe ofendime, pasi Genc Pollos duket se ende nuk i ka dalë inati me ministrin Bushati, i cili e quajti "Salikuq" një javë më parë. Në nisje të seancës, Pollo e cëllosoi fjalor prej halabaku, atë të përdorur nga Bushati një javë më parë, ndërsa më pas janë përfshirë edhe deputetët e tjerë. Në fund të debateve, deputetët e opozitës të PD dhe LSI janë larguar nga Komisioni i Integritimit.

### DEBATI

Komisioni i Ligjeve diskutoi Buxhetin e vitit 2018. Edhe këtë herë debati i zhvilluar mes anëtarëve të opozitës në komision dhe atyre të mazhorancës ka pasur sërish në fokus ish-ministrin Tahirin. "Pak ditë më parë, një biznesmen u kap me 863 mijë euro dhe patentat e ish-ministrit, që betohej se nuk kishte patentë skafi.

### DEBATET NË KOMISION E SIGURISË

**ERMONELA FELAJ:** Në këtë mbledhje kemi thirrur SHISH. Të gjithë anëtarët janë njohur me kalendarin. Për herë të parë kemi vendosur të thërrasin Ministrinë e Financave dhe të Drejtësisë për Burgjet dhe Shërbimin e Provës. Të ftuar nga SHISH janë Enkeleida Peka dhe drejtori ekonomik, Ylvi Aga.

**YLVI AGA:** Meqenëse se informacioni është i klasifikuar, kërkojmë që mbledhja të zhvillohet pa praninë e medias. I gjithë informacioni është i klasifikuar.

**FLAMUR NOKA:** Nuk jemi kundër, por kur të hyjmë te buxheti, mund të jetë me detyrë të mbyllura se jo çdo gjë për buxhetin është sekret.

**ERMONELA FELAJ:** A mund të bëhet i hapur shqyrtimi në parim, pastaj i mbyllur?

**YLVI AGA:** Mund të dalin edhe informacione të klasifikuara, prandaj kërkoj të bëhet i mbyllur.

**YLVI AGO:** Qeveria ka parashikuar të japë më pak fonde.

**ERVIN SALIANJI:** Në kushtet ku jemi, SHISH duhet të marrë jo vetëm fondet e kërkuara, por edhe shtesë.

**ERMONELA FELAJ:** Salianji, kërko fjalën përpara se të ndërhysh.

**Felaj nuk i jep fjalën Sterkaj.**

**PAULIN STERKAJ:** Mos më ndërpre më, se je bërë si mësuese, je bërë si baba Taku... Edhe unë mendoj që për të ardhmen e fëmijëve tanë duhet të heqim, nëse është e nevojshme edhe heqja e fondeve për ndonjë institucion tjetër, përballë të ardhmes së fëmijëve tanë. SHISH është një institucion shumë i rëndësishëm për sigurinë kombëtare.

**PJERIN NDREU:** Duhet mbështetur institucioni me kërkesat... Ministria e Financave i tërheq vëmendjen drejtorit ekonomik të SHISH-it, për mënyrën se si flet...

**SALIANJI:** Kujt i tërheq vëmendjen ti, përpara një komisioni të pavarur?! As Parlamenti s'mundet, e jo më ti që i tërheq vëmendjen një institucioni të pavarur.

**FLAMUR NOKA:** Kjo është qeveri e krimt (dhe pastaj largohet opozita).

### DEBATI TE KOMISIONI I EKONOMISË

**AGRON SHEHAJ:** Unë e kuptoj shumë mirë që ju doni të na e mbyllni gojën.

**NDËRHYN ERJON BRAÇE:** Pyetje? Ku të mbyllt goja ty!

**AGRON SHEHAJ:** Që në këtu mos të flasim për hashashin, patentat, për demokratizimin, kemi të bëjmë me një teatër, me një shfaqje, qytetarët të shikojnë thonë këta nuk janë mirë nga mendja.

**ERJON BRAÇE:** Që nuk je mirë nga mendja, këtë e kuptoj unë, por bëj pyetjen.

**AGRON SHEHAJ:** Nuk e fshihni dot drogën. Trafiku i drogës vlen 1 miliard e gjysmë.

**ARBEN AHMETAJ:** Nëse ju mendoni se qytetarët mendojnë që ndonjëri këtu ka ikur nga mendie e kokës, unë besoj që po, se jemi të regjistruar edhe në "Youtube".

**ERJON BRAÇE:** Ke illogarinë më të madhe se çdo deputet tjetër i kuvendit. Tani të lutem shumë, lëre këtë komision të bëjë mbledhje, në qoftë se s'do, largohu.

**ANASTAS ANGJELI:** Të lutem shumë rri atje, u bërë ti tani, ke një orë që flet. Bëj pyetjen atje dhe merr përgjigjen.

**AGRON SHEHAJ:** Unë do flas se është e drejta ime.

**ANASTAS ANGJELI:** Shko fol në shtëpinë tënde, jo këtu. Po kështu, që të vijmë të degjojmë një orë llaka-llaka, derr-dërr pa bërë as procedurë, as pyetje, ky komision nuk funksionon kështu.

### DEBATI TE KOMISIONI I INTEGRIMIT

**GENC POLLO:** Fjalori i ministrit një javë më parë ishte fyes dhe fjalor prej halabaku.

**SADRI ABAZI:** Tërhiqe mbrapsht fjalën halabak ndaj ministrit, se përndryshe hakabaku je vetëm ti. Vërejtja ime ishte për gjuhën e përdorur nga ministri.

**GENC POLLO:** Faleminderit zoti Abazi, por nuk kemi problem me pallatet dhe ndërtime pa leje.

**ÇUÇI:** Ju përdorët fjalë ofenduese ndaj ministrit të Jashtëm. Ju lutem shumë të mos vazhdojmë më me këtë diskutim. Ta mbyllim me kaq këtë histori, ta lëmë pas dërr.

**POLLO:** Propozoj të futet në rend dite një pikë për çështjen e imunitetit dhe mandatit për lidhjet e politikës me krimin.

**ÇUÇI:** Për çështje që janë jashtë buxhetit 2018 nuk ka vend në axhendë. Nëse doni të thërrasim dikë për interpellancë, e diskutojmë.

**ABAZI, POLLOS:** Krimi je ti. Voto çfarë të ka shkruar Luli.

raporti, mbi 800 mijë euro nuk mund të kalojë kesh. Fugoni i policisë së burgut ka ndërhyrë në këtë ngjarje, policia e ka fshehur. Ose biznesmeni, ose 'Kurum' du-

het të shkojë në burg. Arrestimi është bërë pak metra larg burgut të Elbasanit", është shprehur anëtar i PD në komision, Eduard Halimi. Gjithashtu, Halimi ho-

## INTEGRIMI DEKLARATAT

### Bashkëpunim me ministrinë e linjës për idetë e qytetarëve

## Ngrihet Agjencia e Bashkëqeverisjes, në bord edhe pjesëtarë të trupit diplomatik



të hapur dhe për institucione më pranë qytetarëve. Në sqarimin që bën VKM kjo agjenci do trajtojë në bash-

këpunim me ministrinë e linjës nismat me interes publik, të ardhura nga qytetarët si dhe propozime e idetë

për projekte e reforma qeverisëse. Kjo agjenci do të ketë një drejtor të përgjithshëm dhe një bord këshillimor, dhe financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera ligjore. Bordi Këshillimor ka në përbërje të tij: anëtarë/drejtuues të organizatave shqiptare të shoqërisë civile; pjesëtarë të trupit diplomatik, të akredituar në Shqipëri; ekspertë, akademikë, profesorë të universiteteve prestigjioze, shqiptare dhe të huaja, etj.



Gjatë ceremonisë së inaugurimit të godinës së vettingut

Qeveria vendosi dje, krijimin e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, si një institucion juridik, publik, në varësi të Kryeministrit. Sipas sqarimit, kjo agjenci ka si mision ofrimin direkt të shërbimeve publike, për të garantuar bashkëqeverisje e gjithëpërfshirje në politikëbërje dhe vendim-marrje, nëpërmjet ndërveprimit në platformën elektronike "Me ty, për Shqipërinë që duam" të qytetarëve, organizatave jofitimprurëse e sipërmarrjes private me administratën shtetërore dhe institucionet qeverisëse, si dhe mbështetjen e projekteve e të programeve për një shoqëri

### Shkrimi i Këshillit Evropian: Trafikimi i drogës dhe pastrimi i parave lulëzon në Shqipëri

## Raporti i BE në prill, Vlahutin: Kërkuam luftë kundër kanabisit

"Korrupsioni, një kriter për integrimin"

### JOHANNES HAHN

Komisioneri për Zgjerimin, Johannes Hahn pritet të vizitojë Tiranën këto ditë. Ai do të qëndrojë dy ditë në vendin tonë, ku në axhendë janë të parashikuara takime me të gjithë faktorët politikë në Shqipëri, me shoqërinë civile, si dhe një ndalesë në qytetin e Vlorës ku do të vizitohet shëtitja e Lungomares, e financuar nga Bashkimi Europian.

Darina Tanushi

Celja e negociatave të BE-së me Shqipërinë nuk do të bëhet pa u siguruar rezultatet pozitive në luftën kundër korrupsionit, kanabisit dhe reformës në drejtësi. Në nisje të konsultimeve me shoqërinë civile për hartimin e progres-raportit të vitit 2018, shefia e delegacionit të BE në Shqipëri, Romana Vlahutin u shpreh dje: "Progresi i raportit të vitit 2018 është me rëndësi për Shqipërinë. Vitin e kaluar u kërkuam zbatim i disa rekomandimeve si lufta kundër korrupsionit dhe kanabisit, zbatimi i vettingut dhe reforma në administratë. Korrupsioni është një nga objektivat që duhet të luftohet nga qeveria shqiptare, si një kriter për të ecur përpara në integrimin e BE-së. Kjo është një punë kolektive në të cilën është e rëndësishme bashkëpunimi mes vendeve dhe jo vetëm". Sipas ambasadores së BE-së në Tiranë, shqiptarët dhe politika duhet ta kenë të qartë se ligjet nuk bëhen për BE, por për vetë shtetasit shqiptarë. "Reformat nuk duhet të bëhen për BE-në, por për vetë shtetasit shqiptarë. Institucionet duhet të angazhohen për të bashkëpunuar me shoqërinë civile, roli juaj është i rëndësishëm për të kuptuar ritmet e progresit në vend. Dhe këtë vit kemi vendosur që t'i kushtojmë më shumë kohë konsultimit me shoqërinë civile dhe dëshirojmë që të punojmë fort me ju", u shpreh Vlahutin. Ambasadorja e BE Romana Vlahutin tha se për të arritur këtë qëllim duhet edhe bashkëpunimi mes palëve politike. "Këtu janë dy sfida dhe jo vetëm kaq, megjithatë me anë të bashkëpunimit rezultatet do të jenë të frytshme. Këtu evidencohet progresi i arritur deri në këto momente, por edhe



Ambasadorja e BE Romana Vlahutin

hapat që do të ndiqen për hapjen e negociatave të Shqipërisë", u shpreh Vlahutin. **KËSHILLI I BE**  
Në kohë, Këshilli Evropian për Marrëdhëniet me Jashtë në një shkrim të publikuar në faqen e saj zyrtare ka bërë një analizë të situatës në cilën gjendet aktualisht Ballkani Perëndimor: "Ballkani nuk po kalon një kohë të mirë. Shkalla e madhe e dhunës që përjetoi rajoni në vitin 1990 nuk është më pjesë e politikave ballkanike. Ka progres, sigurisht. Megjithatë, mungesa e dhunës nuk do të thotë se ka mungesë problemesh. Ekonomia e dobët, rritja e pakënaqësisë së popujve karshi liderëve që kanë dhe ripërtëritja e tensioneve etnike ka krijuar tension të lartë poshtë një sipër-

faqeje të qetë në dukje." -shkruan KE.  
Në analizën e bërë flitet edhe për Shqipërinë, ku flitet për politika klorore të ndërthurura me korrupsion. Po ashtu nuk është lënë pa u përmendur edhe çështja e trafikut të drogës. "Shqipëria ka ndasi politike të thella ku politika dhe marrëdhëniet klanore ndërthurën në një rrjetë hakmarrjeje dhe korrupsionit. Trafikimi i drogës dhe pastrimi i parave lulëzon në këtë mjedis. Në vend që t'u përgjigjet këtyre dështimeve të qeverisjes, Edi Rama, së fundmi e ka bërë të gjithën edhe më keq duke ngritur fantazmën e Shqipërisë së Madhe, duke ushqyer frikën e separatizmit me Maqedoninë fqinje"-shkruhet në analizën e KE.

### Ruçi në Kosovë: Lëvizja e lirë duhet të zgjidhet me BE, jo mes shqiptarësh

Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi u takua dje, në Kosovë me krerët më të lartë të shtetit. Në konferencën e përbashkët për shtyp me homologun e tij kosovar, Ruçi bëri të ditur se dy parlamentet janë dakordësuar për krijimin e një komiteti që ka për qëllim zgjidhjen e problemeve legislative mes dy vendeve dhe se inkurajon politikën në Prishtinë që të zgjidhë sa më parë çështjen e demarkacionit. "Inkurajojmë përpjekjet në Kosovë për çështjen e demarkacionit. Demarkacioni një çështje e rëndësishme, të zgjidhet sa më shpejt", tha Ruçi. Ndërkohë gjatë takimit me Presidentin Hashim Thaçi, Ruçi mori edhe dekoratën "Urdhri i Lirisë" Kryetarit të Kuvendit Gramoz Ruçi. Motivacioni ka qenë "për kontributin e dhënë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës". Pas marrjes së dekoratës, kryetari i Kuvendit tha se "kontributi për lirinë e Kosovës nuk i përket asnjë individi". Gjatë takimit me kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinaj, është shprehur se Kosova se Shqipëria e mbështet zgjidhjen e BE për qytetarët e Kosovës, të cilët nuk do t'i lërë të izoluar. "Unë besoj se Kosova i ka përmbushur kriteret për liberalizimin e vizave, por nuk duhet të humbet durimi. Kjo gjë duhet të zgjidhet me partnerët tanë ndërkombëtarë dhe jo mes shqiptarëve", tha Ruçi.



### Studimi i "Euroactiv": Shqipëria në BE vetëm në vitin 2050

Shumica e vendeve as Spirante për anëtarësim në BE nuk do të bëhen dot pjesë e bllokut përpara vitit 2050", shkruan "Euroactiv", platforma mediatike e specializuar në publikimin "online" të artikujve të fokusuar të politikbërja në Europë. Duke cituar një studim të ri, të realizuar mbi aspektet praktike, ligjore dhe teknike të zgjerimit të mëtejshëm të Bashkimit Europian, ajo thotë se vetëm njëri prej këtyre shteteve, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë mund të përmbushë kriteret e bashkimit me unionin përpara vitit 2023. Në studimin e profesoreshës Tina Freyburg, të Universitetit të St Gallen, thuhet se Shqipëria dhe Bosnja-Hercegovina do t'i përmbushin kushtet e anëtarësimit nga viti 2050.





Rregulla të forta sigurie për gjyqtarët e komisionerët. Mbrojtje edhe për kreun e ILDKP

# Vendimi i qeverisë: Garda do të ruajë drejtuesit e vetingut

## Truprojë e shofer edhe për ndërkombëtarët e ONM-së

Darina Tanushi

Qeveria vendosi dje të ruajë dhe mbrojë me truprojë e shofer të posaçëm të gjithë trupën e gjyqtarëve, komisionerëve që do të bëjnë vetingun. Me një vendim të posaçëm, Këshilli i Ministrave vendosi t'u japë siguri të plotë anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, të personelit vendës dhe ndërkombëtar, të objekteve ku ushtrojnë veprimtarinë si dhe inspektorit të përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe kontrollit të pasurive dhe konfliktit të interesave. Kështu, këtë detyrë do ta ketë Garda e Republikës. Sipas vendimit, punonjësit e Gardës do të ruajnë kryetarin dhe komisionerët e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit; kryetarin dhe gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, Komisionerët Publikë, vëzhguesit ndërkombëtarë të emëruar nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit.

Inspektorin e Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave. Garda e Republikës së Shqipërisë do të ruajë dhe të mbrojë objektet (mjediset e punës), ku ushtrojnë veprimtarinë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisionerët Publikë dhe vëzhguesit ndërkombëtarë të emëruar nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit.



Kryetarja e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Genta Tafa Bungo, Kryetarja e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese, Natasha Mulaj dhe Komisionerët Publikë

**ILIR ZELA**  
Këshilli i Ministrave i ka propozuar Kuvendit emërimin e zotit Ilir Zela si anëtar të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare. Ky vendim vjen në një kohë kur në Kuvend është depozituar edhe kërkesa për lirim nga detyra të anëtarit, njëkohësisht kryetar i AKEP-it, Pirro Xhixho nga kjo detyrë. Ilir Zela më herët ka mbajtur detyrën e kreut të Inspektoratit Qendror pranë Këshillit të Ministrave.

### ZV.MINISTRAT E RINJ NGA KOSOVA

Në mbledhjen e djeshme të Këshillit të Ministrave u emëruan edhe tre zv.ministrit e rinj. Të tre emrat vijnë nga përtej kufirit, nga Kosova dhe kanë marrë vetëm dje firmën e kryeministrit Edi Rama, edhe pse ai i publikoi në mbledhjen e Asamblesë së PS-së, kohë më parë. Kështu, zëvendësministrat e Arsimit, Sportit dhe Rinisë do të jetë Besa Shahini, zv.ministrit e Kulturës emërohet Valbona Shujaku si dhe Hajrulla Çeku emërohet zv.ministrit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.



### SHBA dorëzon 12 mjete të blinduara për FA

## Xhaçka në janar shkon në Pentagon, Lu: Krisim mbështetjen për ushtrinë

Rritja e buxhetit të Mbrojtjes dhe faza e re e marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe SHBA-ve ishin mesazhet kryesore të ministres së Mbrojtjes, Olta Xhaçka dhe ambasadorit amerikan Donald Lu, gjatë ceremonisë së dorëzimit të 12 mjeteve të blinduara nga qeveria amerikane për Forcat e Armatosura shqiptare. Në fjalën e tij, ambasadori Lu u shpreh: "Ministrja Xhaçka po investon në të ardhmen. Ne i ofrojmë mbështetjen tonë të plotë për këto investime për ushtarët dhe marinarët heroikë të Shqipërisë. Kam nderin të njoftoj që në muajin janar, Departamenti i Mbrojtjes do të presë ministrin tuaj të re të Mbrojtjes, ministrin Olta Xhaçka dhe një delegacion të nivelit të lartë në Pentagon për të diskutuar se si mund të zgjerojmë marrëdhëniet tona ushtarake dhe të rrisim mbështetjen tonë për FA shqiptare", - u shpreh ambasadori Lu, i cili çmoi vendimin e qeverisë shqiptare për të rritur ndjeshëm buxhetin për Mbrojtjen dhe gjithashtu njoftoi edhe rritjen e buxhetit të qeverisë amerikane për trajnimin e ushtarakëve shqiptarë në SHBA. Nga ana e saj, ministrja Xhaçka falënderoi qeverinë amerikane për mbështetjen e treguar ndaj Forcave të Armatosura shqiptare, si dhe theksoi fazën e re të marrëdhënieve me SHBA, të cilat ajo i cilësoi si aleat strategjik.

### VENDIMI I QEVERISË

1. Garda e Republikës së Shqipërisë të ruajë dhe të mbrojë, me truprojë/shofer (nëoficer), si më poshtë vijon:
  - a) Kryetarin dhe komisionerët e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
  - b) Kryetarin dhe gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.
  - c) Komisionerët Publikë.
  - d) Vëzhguesit ndërkombëtarë të emëruar nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit.
  - e) Inspektorin e Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.
2. Garda e Republikës së Shqipërisë të ruajë dhe të mbrojë objektet (mjediset e punës), ku ushtrojnë veprimtarinë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisionerët Publikë dhe vëzhguesit ndërkombëtarë të emëruar nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit.
3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Garda e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

gjyqtarëve ose prokurorëve. Ligi për statusin parashikon që gjyqtari dhe prokurori e kanë pagën sa 106% e pagës së drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme

në Kryeministri. Ndërsa, gjyqtari i Kolegjit të Apelit merr pagë dhe përfitime të tjera financiare në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin "Për orga-

nizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë". Këshilltari ligjor dhe ekonomist përfiton përkatësisht 80 për qind të pagës mujore përkatëse të anëtarit të institucionit të rivlerësimit. Ata përfitojnë një pagesë shtesë për shkak të vështirësisë, sipas rastit. Pas përfundimit të mandatit të institucioneve të rivlerësimit, këshilltari ligjor dhe ekonomik, me pëlqimin e tij/saj, ka të drejtë të emërohet në funksionin ose detyrën publike që kishte para zgjedhjes së tij/saj ose në një vend të përafërt në administratën publike.

## Meta takon shoqërinë civile: Do jem në krah të fëmijëve në nevojë

Presidenti i Republikës, Ilir Meta viziotoi dje në 20-vjetorin e themelimit, Qendrën e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri, një nga agjencitë më të njohura të shoqërisë civile, ku pati takime me aktivistë të saj si dhe drejtues të 15 organizatave jofitimprurëse në vend. Presidenti Meta u njoh prej drejtorit të Përgjithshëm të saj, z. Altin Hazizaj për veprimtarinë e qendrës si dhe problemet që shqetësojnë fëmijët, përfaqshuesit e tyre në jetën social-kulturore si dhe rolin e kom-



munitetit dhe individëve të zgjedhur në përmirësimin e jetës së tyre. "Shqipëria, theksoi presidenti - ka më tepër nevojë për vlera shpirtërore, solidaritet komunitar si dhe për dashur-

inë dhe pasionin e qytetarëve të saj". Presidenti theksoi se, "për shoqërinë tonë është shumë i rëndësishëm kujdesi dhe vëmendja për rritjen dhe edukimin e brezit të ri. Fëmijët dhe rinjtë shqiptarë, veçanërisht ata pa përkrahje kanë nevojë për më tepër ngrohtësi, barazi, respekt dhe progres". "Presidenca e Shqipërisë, - garantoj z. Meta, - do të jetë përherë e hapur për kërkesat dhe iniciativat e shoqërisë civile për rritjen e kapaciteteve si dhe synimin tuaj për mbrojtjen të rinjve në nevojë nga diskriminimi".

## DOSJA CEZ-DIA DENONCIMI

Sekretari i Përgjithshëm i PS denoncon: Po bëhen pazare që vijnë erë të keqe

# Balla: Po mbyllet dosja korruptive e CEZ. Prokuroria: Çështje e prokurorëve

## Vendimi u mor më 29 shtator, u pushua pas 10 ditëve

Darina Tanushi

Kryetari i Grupit Parlamentar të PS-së, Taulant Balla deklaroi dje, se "Prokuroria po përpqet të mbyllë një prej dosjeve më të qarta të korrupsionit në këto 27 vite: skandalin "CEZ". Sipas tij, prokuroria kërkon ta mbyllë këtë skandal "pa kryer asnjë hetim minimal; pa marrë në pyetje asnjë të akuzuar, asnjë dëshmitar, asnjë person në dijeni; pa marrë në konsideratë asnjë prej gjetjeve të raportit përfundimtar të komisionit hetimor parlamentar". "Prokuroria që u ngrit brenda ditës për të arrestuar një deputet mbi bazën e një materiali të botuar në media me përgjimet e dy kriminelëve, jo vetëm nuk e vë ujën në zjarr për një material të shkruar me fakte komprometuese e me emra peshqish të mëdhenj e të vegjël, të dyshuar për krim ekonomik e korrupsion me përmasa tronditëse, po na e paska dërguar dosjen në gjykatë duke kërkuar mbylljen e saj!", tha dje, sekretari i Përgjithshëm i PS-së. "Kush janë këta prokurorë? Kush u ka dhënë këtyre prokurorëve pushtetin që të sillen me drejtësinë si tregtarë qënieësh të gjalla dhe ta trajtojnë popullin shqiptar si mish për top? Kush është pas këtyre kukullave të këtij teatri të neveritshëm, me drejtësinë si mjet për të sulmuar dhe për të mbrojtur në emër të interesave politike e korruptive që fyejnë Shqipërinë, popullin, drejtësinë", ngriti pyetjen Balla. Sipas tij, "Prokuroria po bën



### KOMISIONI HETIMOR

Komisioni hetimor i ngritur nga maxhoranca për privatizimin e Operatorit të Shpërndarjes nga kompania CEZ miratoi në 20 mars raportin, ku konkludohet se procesi i privatizimit i ka shkaktuar Shqipërisë një dëm prej 415 milionë eurosh. Sipas komisionit hetimor, përgjegjës për këtë dëm janë ish-kryeministri Sali Berisha, ish-ministra të PD-së dhe Nue Kalaj.

pazare që vijnë erë të keqe me kilometra larg! Prokuroria po shfaqet hapur si vegël e politikës dhe padrejtësisë! Prokuroria po provon me veprimet e mosveprimet e saj, një kalbëzim të tmerrshëm!". "Por prokuroria nuk ka për ta ndaluar dot orën e drejtë-

sisë, që po vjen dhe që ka tmerruar politikanët, prokurorët e gjykatës të korruptuar! Kurë nuk do ta ndalojë dot, edhe sikur të gjejë në gjykatë njerëz të tregur e të korruptuar, njësoj si ata që e kanë çuar dosjen e CEZ-it për ta varrosur pa asnjë lloj proce-

### PROKURORIA

Prokuroria e Përgjithshme nuk pranoi të komentonte dërgimin e dosjes në gjykatë për t'u mbyllur, me firmën e kreut të prokurorisë së Tiranës. Vendimi është marrë më 29 shtator, ndërsa vetëm 10 ditë pas regjistrimit çështja është pushuar. Hetimi është regjistruar më 19 shtator, pas hetimit parlamentar. Pushimi i çështjes është firmosur nga prokurorja Alma Bramo.

si minimal hetimor!", u shpreh më tej, kryetari i Grupit Parlamentar të PS-së. Nga ana tjetër, Prokuroria e Përgjithshme nuk pranoi të komentonte dërgimin e dosjes në gjykatë për t'u mbyllur, me firmën e kreut të prokurorisë së Tiranës. Sipas saj, tashmë prokurorët janë të pavarur në veprimet e tyre dhe hetimin e dosjeve. Vendimi është marrë më 29 shtator, ndërsa vetëm 10 ditë pas regjistrimit çështja është pushuar. Hetimi është regjistruar më 19 shtator, pas hetimit parlamentar. Pushimi i çështjes është firmosur nga prokurorja Alma Bramo.



Gjatë një mitingu të PS-së për zgjedhjet e 25 qershorit

### Shkolla e Administratës Publike: Rekrutimi elektronik, më i suksesshmi në rajon

Procesi elektronik i rekrutimit të personave në administratën publike në Shqipëri, është një ndër praktikatat e suksesshme të identifikuar tashmë në rajon. Ky ishte një nga rekomandimet e ekspertëve gjatë prezantimit dje, në takimin e 8-të të Bordit Drejtues në nivel ministror të Shkollës Rajonale të Administratës Publike, që u zhvillua në Tiranë. Zv/kryeministria Senida Mesi, e cila kryesoi këtë takim u shpreh sipas ATSH, se bashkëpunimi ndërmjet vendeve anëtare të ReSPA-s në fushën e administratës publike, është një mekanizëm i mirë për të lehtësuar shkëmbimin e përvojave të përbashkëta, të praktikës me BE-në dhe institucioneve të BE-së. Sipas saj, prezenca në këtë takim e përfaqësuesve të lartë nga Ballkani Perëndimor, tregon qartë vendosmërinë e secilit vend për të çuar përpara angazhimet e ndërmarrja për një bashkëpunim sa më efikas në drejtim të forcimit të kapaciteteve për implementimin e reformës së administratës publike, si dhe ndarjes së përvojave respektive, duke ecur kështu krahas krahas njëri-tjetrit drejt integritimit në BE. Në takim morën pjesë edhe ministrat përkatës që mbulojnë administratën publike në vendet e Ballkanit Perëndimor (Bosnia & Herzegovina, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi & Serbia), përfaqësues të rëndësishëm nga Komisioni Evropian, si dhe ekspertë të shumtë rajonal.



### TENDER NOTIFICATION

"Training Centre Furniture" in the frame of the project:  
"Direct funding to INSTAT for procurement of IT-equipment and establishing the training centre."  
Sida contribution 55020289

Institute of Statistics of Albania intends to award a supply contract for "Training Centre Furniture" for the project funds: "Direct funding to INSTAT for procurement of IT-equipment and establishing the training centre." in Tirana, Albania. The project is financially supported by the Government of Sweden represented by the Swedish International Development Cooperation Agency (Sida).

The tender dossier is available from 24.10.2017 at [www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al), [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

The deadline for submission of tenders is November 23, 2017, 11:00 hrs local time, at Institute of Statistics of Albania, Bul. Zhan D'Ark, Nr. 3, Tirana, Albania. Possible additional information or clarifications/questions shall be published on the [www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al) and <https://www.kommersannonns.se/sida/>.

Tenderers may request clarification on any of the documents of the Tender not later than 14 days before the deadline for submission of bids.

### Tourism Investment and Finance Fund

#### Invitation to Bid

**Subject:** Hotel bedding, toilet kits and kitchen equipment in Seferan, Belsh

The Tourism Investment and Finance Fund is a nonprofit financial foundation supported by USAID Albania and the Embassy of Sweden in Tirana. The mission of the Fund is to create vibrant local economies with a focus on tourism. Within this context, the Fund is working – among other places – to revive tourism in the prominent village of Seferan, Belsh. Around Lake Seferan the Fund has finished construction of 2 guesthouses (8 rooms total), including two small restaurants in each location.

The Fund is now interested in working with vendors that supply hotel equipment (like beddings, comforters, and towels) as well as kitchen equipment like stoves and fridges. Interested vendors are invited to visit [www.fondi.al/procurement](http://www.fondi.al/procurement) to download a copy of specifications for this call as well as the official bid form.

Deadline for submitting bids is November 14<sup>th</sup>, 2017 at 17:00. Bids can be sent physically to the following address or electronically at [info@fondi.al](mailto:info@fondi.al).

**Address:**  
Tourism Investment and Finance Fund  
Rr. Themistokli Gërmenji, Pallati Ambasador 1, Kati 6, apt. 4, Tirane





Fushata elektorale e 25 qershorit 2017, 66 emra personash dhe subjektsh

# Lista e donatorëve të partive, kush dhuroi mbi 100 milionë lekë

## Rastet kur fshihet identiteti i donatorit

Valentina Madani

Donatorë të shumtë kanë dhuruar mbi 100 milionë lekë për partitë politike gjatë fushatës elektorale të 25 qershorit, por në të shumtën e rasteve janë fshehur identitetet e donatorëve. Open Data Albania, publikoi dhe listën e donatorëve të partive politike, subjekte zgjedhore në fushatën për zgjedhjet e përgjithshme 2017. Sipas Open Data Albania donatorët për vlera mbi 100 milionë lekë regjistrohen gjatë fushatës në një regjistër të posaçëm. Ata duhet të bëjnë pagesa vetëm në llogarinë bankare të çelura nga subjekti i elektorat në një bankë të nivelit të dytë dhe të paracaktuar për dhurime zgjedhore. Kjo listë-regjistër konsiderohet si informacion me akses të përfurcuar për publikun. Neni 90 i Kodit Zgjedhor, me titull "Regjistrimi i fondeve jo publike", parashikon të drejtë të shtuar informimi, parashikuar përmes togjalëshit "kurdohërit publike". Ky detyrim ligjor i subjekteve dhe njëkohësisht e drejtë ligjore e publikut, nuk është respektuar asnjëherë gjatë fushatës. Sipas studimit të Open Data, emrat e donatorëve të deklaruar zbardhen vetëm në procesin e ekspertimit kontabël të shpenzimeve elektorale, proces që pason gjatë në kohë fushatës zgjedhore. Lista e donatorëve partiakë është bërë e njohur për publikun vetëm në nëntor 2017, pra katër muaj pas përfundimit të fushatës. Publikimi i kësaj liste ka burim të raporte financiare për fushatën, të dërguara nga partitë politike kryesore. Këto raporte nuk kanë raporte auditim të ekspertëve kontabël të autorizuar. Në raporte të mëhershme të auditimit nuk është zbardhur në asnjë rast një listë donatorësh sipas subjekteve apo shumave. Open Data Albania po zbardh listë tërësore të donatorëve për vlera më të mëdha se 100 000 lekë në fushatën zgjedhore 2017. Kjo listë ka 66 emra personash dhe subjektsh. "Lista e donatorëve fushatë 2017", përbëhet kryesisht nga individë dhe dy grupe të tregtare të regjistruara me NIPT. Janë vetëm katër subjekte elektorale që paraqesin informacion për donatorë në vlera mbi njëqindmijë lekë, konkretisht PS, LSI, Partia Aleanca Popullore për Drejtësi dhe Partia Bashkimi Demokratian Shqiptar. Në total nga donacionet janë mbledhur nëntë



Selia e PD-së

milion e katërqind e pesëdhjetë e pesë mijë lekë. Nga të cilat partia në pushtet, nga donatorë për vlera mbi njëqindmijë lekë, ka mbledhur vetëm shtatëqind mijë lekë, partia LSI nga donator për vlera mbi njëqindmijë lekë,

ka arritur të mbledhë shtatë milion e tetëqind e dyzet e pesë lekë. Aleanca Popullore për Drejtësi deklaroi vlerën katërqind e tetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë lekë nga një firmë ligjore dhe Partia Bashkimi Demokratian Shqiptar

dhurimin prej pesëqind e një mijë lekë nga një shoqëri biznesi me përgjegjësi të kufizuar. Partitë deklarojnë që kanë marrë donacione edhe në vlera nën njëqind mijë lekë, donacione për të cilat nuk është dhënë identiteti i donatorit. LSI ka deklaruar si donacion edhe minutat e kohës televizive të llogaritura pa pagesë e të përfuturra nga "Top Channel". Kodi Zgjedhor parashikon disa rregullime me qëllim parandalimin e konfliktit të interesit për rastin e donatorëve partiakë. Këto parashikime zakonisht nuk janë pjesë e kontrollit institucional dhe nuk kemi një mekanizëm që ka tagër të bëjë kontroll të konfliktit të interesit për subjektet donator elektorale.

### DENONCIMI

"Kam ngelur pa punë tani për momentin, kam ngelur mes katër rrugëve. Nuk kam asnjë të ardhur. Kam dy fëmijët në shkollë të lartë në Tiranë dhe nuk kam më çfarë t'i mbaj", - thuhet në mesazhin dërguar Berishës.



Ish-kryeministri Sali Berisha

## Berisha: Inspektorët e AKU abuzime me qytetarët

Ish-kryeministri Sali Berisha publikoi dje dy mesazhe të një vijnë nga kasapë dixhitalë, të cilët denoncojnë Autoritetin Kombëtar të Ushqimit. Një qytetar nga Berati dhe një nga Shkodra i shprehin shqetësimet e tyre Berishës, sa i takon ligjit të ri për thertoret. Berisha shkruan se inspektorët e AKU po abuzojnë dhe po bëjnë korruption ndaj qytetarëve. Ndërkohë, qytetari nga Berati pohon se AKU i mbylli thertoren, ndërsa ai në Shkodër mori një gjohë prej 500 mijë lekësh, sipas tij padrejtësisht. "Jam një tregtar mishi nga Berati. Po bëj 25 vjet që po punoj si kasap. Para 20 ditësh na erdhën punonjësit AKU-së për të bërë kontrollin e higjienës dhe na vunë si kusht që të bënim disa rregullime në dyqan. Deri këtu jemi ok, se duheshin ca riparime, të cilat unë i bëra. Kur na vijnë përsëri pas 15 ditësh, përsëri drejtori me gjithë punonjësit e AKU dhe me thotë që mbyll dyqanin, se gjoka ka dalë një ligj që dyqani duhet minimumi 30 m2. Dyqani im është 23 m2 dhe ma mbyllën. Nuk e di se çfarë ka në plan ky qen bir qeni kryeministër dhe ministri i Bujqësisë. Kam ngelur pa punë tani për momentin, kam ngelur mes katër rrugëve. Nuk kam asnjë të ardhur. Kam dy fëmijët në shkollë të lartë në Tiranë dhe nuk kam më çfarë t'i mbaj", thuhet në mesazhin dërguar Berishës.

Shoqëria përbarimorë "AFA-2010" sh.p.k shpall Ankandin për shitjen e pasurisë së palauzshme:

Pasurisë me Nr.3/369 e llojit "Truall + Banesë 3 katëshe" me sip. truallit 350 m<sup>2</sup> dhe sip. banesë 191,9 m<sup>2</sup>. ( katërrësh 191,9 m<sup>2</sup>, katërrësh 1,269,03 dhe katërrësh 269 m<sup>2</sup> ) ndodhur në L. "11 Janar", ZK 2310, Kuçovë, në pronësi Agim Isa Zeqva, Çmimi fillestar në ankandin e dytë është është 11,200,000 Lekë. Ankandi zhvillohet në datë 09.11.2017, ditën e Enjte ora 15.30 n në ambientet e Shoqërisë Përbarimorë "AFA-2010" sh.p.k në adresën Rruga "Sulejman Delvina", Nd.51, H.9, Ap-1, Tiranë. Për info. Tel:044503458 ose E-maili shoqeriaepërbarimorerafa2010@gmail.com

TABELA 1. LISTA E DONATORËVE, ME DHURIME MBI 100.000 NE ZGJEDHJET PËR KUVEND, 2017

| Emri i donatorit   | Emri i partisë | Adresa | Kodi postar | Shuma / Vlera monetare | Sipërfaqja |
|--------------------|----------------|--------|-------------|------------------------|------------|
| Lirjan Hyseni      | Enxhak         |        | F90301078D  | ALL                    | 100.000,00 |
| Nerald Hyseni      | Enxhak         |        | 807101461   | ALL                    | 100.000,00 |
| Nerruz Hasani      | Enxhak         |        | F60410328J  | ALL                    | 100.000,00 |
| Thoma Zisi         | Enxhak         |        | G11115124R  | ALL                    | 100.000,00 |
| Agim Radozi        | Enxhak         |        | F70103008C  | ALL                    | 100.000,00 |
| Beqari Tota        | Kukes          |        | K9382074E   | ALL                    | 100.000,00 |
| Klodian Gashi      | Kukes          |        | I70810045T  | ALL                    | 100.000,00 |
| Mustafa Hoxha      | Tirane         |        | G41129125P  | ALL                    | 676.050,00 |
| Ardian Alushi      | Tirane         |        | 27782952    | ALL                    | 100.000,00 |
| Nasip Naco         | Tirane         |        | 2883636     | ALL                    | 100.000,00 |
| Viktor Tushaj      | Tirane         |        | 27597182    | ALL                    | 121.235,00 |
| Edmond Stojku      | Tirane         |        | 28812551    | ALL                    | 100.000,00 |
| Alfred Sadikaj     | Tirane         |        | 24408151    | ALL                    | 100.000,00 |
| Eliana Guri        | Tirane         |        | 28532464    | ALL                    | 100.000,00 |
| Edira Dhaneri      | Tirane         |        | 28933349    | ALL                    | 200.000,00 |
| Erisi Zaimi        | Tirane         |        | 27784350    | ALL                    | 100.000,00 |
| Gezim Podgorica    | Tirane         |        | 50709049    | ALL                    | 100.000,00 |
| Bahri Shaqiri      | Tirane         |        | 24667440    | ALL                    | 100.000,00 |
| Endrit Brahmillari | Tirane         |        | 80516068    | ALL                    | 100.000,00 |
| Vangel Tavo        | Tirane         |        | 27419141    | ALL                    | 100.000,00 |
| Iir Meta           | Tirane         |        | DC3436032   | ALL                    | 100.000,00 |
| Masilind Lazimi    | Tirane         |        | 27732997    | ALL                    | 100.000,00 |
| Luan Rama          | Tirane         |        | 33185074    | ALL                    | 100.000,00 |
| Dorian Naci        | Tirane         |        | 28019307    | ALL                    | 100.000,00 |
| Eduart Gashi       | Tirane         |        | 27533050    | ALL                    | 100.000,00 |
| Aurel Lamçe        | Tirane         |        | 27525108    | ALL                    | 100.000,00 |
| Taulant Kalo       | Tirane         |        | 29860682    | ALL                    | 100.000,00 |
| Juliana Hoxha      | Tirane         |        | 24405467    | ALL                    | 100.000,00 |
| Enxhak Laco        | Tirane         |        | 28918666    | ALL                    | 100.000,00 |
| Xhelasin Toro      | Tirane         |        | 28918666    | ALL                    | 100.000,00 |
| Mirela Meke        | Tirane         |        | 24838160    | ALL                    | 100.000,00 |
| Eriçona Basha      | Tirane         |        | 26568539    | ALL                    | 100.000,00 |
| Valbona Balajqiri  | Tirane         |        | 3597070107  | ALL                    | 100.000,00 |
| Argent Albani      | Tirane         |        | 24857116    | ALL                    | 100.000,00 |
| Gjovanni Bushi     | Tirane         |        | 27979492    | ALL                    | 100.000,00 |
| Rudina Hoxha       | Tirane         |        | 28045131    | ALL                    | 100.000,00 |
| Argita Totocari    | Tirane         |        | 33190635    | ALL                    | 100.000,00 |
| Aleksander Luvjani | Tirane         |        | 31326075    | ALL                    | 100.000,00 |
| Adrianas Krasa     | Tirane         |        | 2           | ALL                    | 100.000,00 |
| Iir Oqja           | Tirane         |        | 33276348    | ALL                    | 150.000,00 |
| Julian Beqiri      | Tirane         |        | 32404400    | ALL                    | 100.000,00 |
| Adriana Sokoli     | Tirane         |        | 8E6609996   | ALL                    | 100.000,00 |
| Adela Karaspici    | Tirane         |        | 32639864    | ALL                    | 100.000,00 |
| Iljana Smailaj     | Tirane         |        | 32448646    | ALL                    | 100.000,00 |
| David Curri        | Tirane         |        | 26046819    | ALL                    | 100.000,00 |
| Alaj Bllaku        | Tirane         |        | 24629423    | ALL                    | 111.200,00 |
| Blenard Nona       | Tirane         |        | 30276570    | ALL                    | 100.000,00 |
| Edmond Panariti    | Tirane         |        | 29115331    | ALL                    | 150.000,00 |
| Arjan Korpa        | Tirane         |        | 24436864    | ALL                    | 100.000,00 |
| Viktor Tushaj      | Lazhe          |        | 27597182    | ALL                    | 512.500,00 |
| Piro Kapurani      | Korce          |        | 670124285   | ALL                    | 200.000,00 |
| Florida Kerpaci    | Tirane         |        | 30150862    | ALL                    | 125.000,00 |
| Iir Cencilli       | Korce          |        | 28080342    | ALL                    | 200.000,00 |
| Santon Zotaj       | Tirane         |        | 25081595    | ALL                    | 100.000,00 |
| Daniela Cekani     | Tirane         |        | 24460581    | ALL                    | 100.000,00 |
| Scalci Mici        | Tirane         |        | 33587788    | ALL                    | 100.000,00 |
| Tedjan Loci        | Tirane         |        | 25679574    | ALL                    | 410.000,00 |
| Ardian Gjoni       | Tirane         |        | 32685604    | ALL                    | 100.000,00 |
| Geragi Petro       | Tirane         |        | 33363341    | ALL                    | 313.000,00 |
| Florian Lusha      | Tirane         |        | 16274190    | ALL                    | 110.000,00 |
| Shyqiri Klapiani   | Tirane         |        | 27968669    | ALL                    | 200.000,00 |
| Shara Lieshi       | Tirane         |        | 30125482    | ALL                    | 145.000,00 |
| Olimbi Neca        | Tirane         |        | 32666636    | ALL                    | 102.000,00 |
| Syria Proi         | Kavaje         |        | 24776653    | ALL                    | 219.051,00 |
| K&L Law Firm shpk  | Tirane         |        | K92107011H  | ALL                    | 408.980,00 |
| Linda B0 Shpk      | Lazhe          |        | K37513530U  | ALL                    | 501.000,00 |

ALEANCA POPULLORE P.B.D.K.SH

Zgjerohet taksa progresive, nga 1 janari mbi pagat dhe të ardhurat e tjera

TAKSA PËR MAKINAT E LUKSIT

Në draftligjin "Për taksat kombëtare", që kaloi në qeveri bëhet një ndryshim të neni për taksimin e makinave të luksit. Që të taksohet një automjet për këtë arsye duhet të përmbushë një nga dy kriteret: ose të ketë cilindratin e barabartë/ mbi 3000 cm³ ose të ketë vlerën, çmimin të barabartë/ mbi 5 milionë lekë. Sipas DPTSHRR, janë rreth 909 autovektura të regjistruara aktualisht me kapacitet 6+1, të cilat u janë nënshtruar modifikimeve për arsye të shmangies së kësaj takse. Efekti negativ në buxhetin e shtetit është 19.000.000 lekë nga mostaksimi i këtyre automjeteve, të cilat duhet të konsiderohen makina luksi. Për këtë qëllim propozohet me anë të këtij ligji, rritja e kapacitetit të vendeve nga 4+1 në 6+1.



Ornela Manjani

Qeveria do të ndryshojë formulën për taksim mbi të ardhurat. Çdo e ardhur do të tautohet me 13-23%, duke nisur nga 1 janari i vitit të ardhshëm. Ndryshimi i formulës së taksimit është paraloguar nga ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj. "Do të përfshijë të ardhurat e integruara në bazë të taksueshme, jo si tani, të fragmentuara. Çdo e ardhur do të përlogarit si një e tërë në periudhë tatimore dhe do t'i vendoset sipër norma", deklaroi ministri i Financave, Arben Ahmetaj në Komisionin e Ekonomisë, ku u diskutua paketa fiskale. Sipas ligjit në fuqi, qeveria takson progresivisht vetëm pagat, ndërsa të ardhurat e tjera, si qiraja apo e drejta e autorit taksohen me normë fikse, 15 për qind. Sipas skemës së re, të gjitha të ardhurat do të bashkohen në një bazë të vetme, mbi të cilën pastaj zbatohet taksa progresive 0, 13 ose 23 për qind, në varësi të nivelit të të ardhurave.

# Propozimi i Ahmetajt: Çdo e ardhur të tautohet 13-23%

## Të ardhurat nga qiraja dhe e drejta e autorit taksohen 15%

### DEBATI TABAKU-BRAÇE PËR TAKSAT

**JORIDA TABAKU:** Për të gjithë paketën fiskale sigurisht që vota jonë është kundër ashtu, sikurse është kundër edhe për buxhetin. PD do të marrë masa për të çuar disa nga këto ligje edhe në Gjykatën Kushtetuese.

**ERION BRAÇE:** Veprimtaria turistike që zhvillohet në një mjedis fshati dhe që është orientuar drejt një përdorimit të burimeve lokale të turizmit, thuhet këtu. Natyrisht që duke kërkuar për këtë pjesë, pashë që në asnjë prej akteve nënligjore që kanë dalë në funksion të këtij ligji, ky definicion nuk është zhvilluar më tej. Kam shqetësimin që lidhet me pensionistët e vetëm, pra pensionistët që jetojnë në ndarë nga familjet e tyre, që kanë një shtëpi 60-70 metra katrorë dhe që natyrisht, unë mendoj që preken nga aplikimi i këtij tatimi të ri, kësaj takse të re. Doja të dija, ju e gjykoni diferencimin edhe për këtë kategori?

**EDMOND HAXHINASTO:** Mos do të ishte më mirë që kjo taksë të vendoset pasi ta kemi plotësuar këtë kadastrë, të shohim efektet që do të sjellë kjo taksë për zona të ndryshme dhe kategori të ndryshme?



Komisioni i Ekonomisë

### PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE SIPAS ZËRAVE PËR VITIN 2018

- Të ardhurat nga Tatimi mbi Fitimin vlerësohen me rritje 7% më shumë se viti 2017, duke u realizuar në masën 33.9 miliardë lekë. Kjo, si rezultat i rritjes së deklarimit dhe qarkullimit të realizuar të operatorëve ekonomikë.
- Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale vlerësohen me rritje 9.7% më shumë se viti 2017, me një realizim në masën 37.3 miliardë lekë. Në parashikimin e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale janë marrë në konsideratë rritja e numrit të kontribuuesve aktivë, bazuar në ecurinë e vitit 2017 dhe prishmëritë për formalizim të mëtejshëm të të ardhurave nga punësimi.
- Të ardhurat nga TVSH-ja parashikohen të jenë në masën 150.7 miliardë lekë, 11.4 miliardë lekë më shumë se prishmëria për vitin 2017 ose 8.2%. Krahas TVSH-së, që do të gjenerohet si rezultat i rritjes ekonomike, rritjes së vullmit të importeve dhe konjunkturës së çmimeve ndërkombëtare, burimi kryesor i të ardhurave shtesë nga TVSH-ja për vitin 2017, do të jetë përmasimi i administrimit të këtij tatimi, lufta ndaj informalitetit si dhe kontrolli i zinxhirit të transaksioneve të subjekteve në TVSH.
- Të ardhurat nga akciza vlerësohen të jenë 49.5 miliardë lekë me një rritje prej 3.9 miliardë lekë ose 8.5% më shumë se prishmëritë për vitin 2017. Faktorët kryesorë që ndikojnë në rritjen e parashikuar të të ardhurave nga akciza, krahas rritjes së importeve të mallrave të akcizës, do të jetë lufta kundër informalitetit, kontrolli më rigoroz i subjekteve të akcizës si dhe disiplinimi i mëtejshëm i procedurave të përfitimt të përjashtimeve dhe rimbursimeve nga kjo taksë.
- Të ardhurat nga taksa nacionale dhe të tjera vlerësohen në masën 38 miliardë lekë. Parashikimet për këtë taksë për vitin 2018 janë 2.9 miliardë lekë më pak se i prishmëri 2017 dhe lidhen me pasqyrimin në vitin 2017 në këtë zë të të ardhurave nga rivlerësimi i pasurisë (one off revenue) për rreth 3.6 miliardë lekë, të cilat nuk do të jenë në vitin 2017.

### NDIKIMI I TAKSËS

Ndryshimi i formulës së taksimit do të ketë efekte të ndryshme në varësi të nivelit të të ardhurave. "TCH" e ilustron me dy shembuj konkretë. Rasti i parë është një individ, i cili aktualisht ka një pagë 130 mijë lekë në muaj dhe një të ardhur nga qiraja 30 mijë lekë në muaj. Për këtë individ, taksa rritet. Ajo shkon nga 17 mijë e 500 lekë në muaj që është aktualisht, në 19 mijë e 900 lekë në muaj. Pra, 2 mijë e 400 lekë më shumë në muaj. Rasti i dytë është një individ tjetër, i cili e ka pagën 60 mijë lekë në muaj dhe një të ardhur nga qiraja po 30 mijë lekë në muaj. Për këtë qytetar, taksa ulet. Ajo shkon nga 8 mijë e 800 lekë në muaj që është aktualisht, në 7 mijë e 800 lekë, duke u ulur me 1 mijë lekë në muaj. Siç tregohet nga të dy shembujt e mësipërm, mënyra sesi ndryshon barra e taksës varet nga niveli i të ardhurave. Por, për gjithësisht, për një individ që ka të ardhura nga paga dhe qiraja mbi 160 mijë lekë në muaj, barra rritet. Ndërsa për ata që i kanë të ardhurat nën këtë nivel, taksa ulet.

### DEBATET

Opozita ka kundërshtuar paketën fiskale për 2018-ën. Nënkretarja Jorida Tabaku kërkoi që lehtësirat fiskale në sektorin e turizmit të bëhen edhe për bizneset e vogla, gjë që u mbështet edhe nga kryetari i komisionit, Erjon Braçe. "Për të gjithë paketën fiskale sigurisht që vota jonë është kundër ashtu, sikurse është kundër edhe për buxhetin. PD do të marrë masa për të shkuar disa nga këto ligje edhe në Gjykatën Kushtetuese", tha Tabaku. "Veprimtaria turistike që zhvillohet në një mjedis fshati dhe që është orientuar drejt një përdorimi të burimeve lokale të turizmit

përjashtohet nga TVSH-ja thuhet këtu. Natyrisht që duke kërkuar për këtë pjesë pashë që në asnjë prej akteve nënligjore që kanë dalë në funksion të këtij ligji, ky definicion nuk është zhvilluar më tej", - deklaroi Braçe. Rezerva deputetët kanë pasur edhe për aplikimin e taksës së banesës. Mazhoranca

ka kërkuar që pensionistët të mos përfshihen.

### TVSH-JA

Kreu i Financave shqiptare, Ahmetaj ka thënë se duhet të bëhet deklarimi i njëherësh në tre muaj për biznesin e vogël. "Thjeshtimi për deklarimin e biznesit të vogël përcaktohet me vendim të Këshillit të Minis-



## Tatimfitimi, zero tek turizmi dhe 5% tek IT

Hotelit me 4 dhe pesë yje nuk do të paguajnë tatim fitim për një periudhë 10-vjeçare, nëse arrijnë që të përfitojnë statusin special. Është kjo një nga nxitjet më të mëdha fiskale që qeveria ka vendosur që t'u japë investitorëve të ardhshëm në turizëm. Turizmi pa taksa, por vetëm për ata që skanë ardhur ende. "Përjashtimi nga tatimfitimi aplikohet për një periudhë 10-vjeçare për ato struktura, të cilat përfitojnë autorizimin nga Këshilli i Ministrave deri në dhjetor 2024. Efektet e përjashtimit nisën në momentin e fillimit të veprimtarisë ekonomike të strukturës akomoduese, por jo më vonë se 3 vjet nga marrja e statusit special. Parashikimi është bërë me qëllim dhënien e incentivës në momentin e fillimit të aktivitetit ekonomik, atëherë kur ky aktivitet realizon fitim", përcaktohet në draft ligjin e kaluar në qeveri. Sakaq, për të gjithë ata që ushtojnë aktivitet në prodhim dhe zhvillim të 'softwear'-ve, tatimfitimi do të jetë 5%. Efekti negativ në buxhet llogaritet 93 milionë lekë.

### Ndryshimet tek TVSH-ja

Ligji "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar" ka pësuar ndryshime në paketën 2018, ku propozohet së pari vendosja e një niveli TVSH-je prej 6 për qind për furnizimin e shërbimeve që ofrohen në hotel me 5 yje me status special. Aktualisht ky nivel TVSH-je ofrohet vetëm për furnizimin e shërbimit të fjetjes në të gjitha strukturat akomoduese në vend. Por, trajtimi i diferencuar do të bëhet vetëm për ata me status special që të thotë se edhe bar-restorantet, saunat, pishinat, shelzonget e këtyre hoteleve do të faturojnë shërbimin me 6% TVSH. Drafti gjithashtu i hap rrugë ndryshimit që do të bëhet për futjen në regjim TVSH-je të biznesit të vogël, me një prag 2 milionë lekë qarkullim. Qeveria nuk ka përcaktuar prag në këtë rast, por ka bërë ndryshimet që i hapin rrugë procesit. Kjo masë pritet të ketë një efekt 1.5 miliardë lekë në buxhet.

trave", - tha ai. Deputetja Evis Kushi drejtoi pyetjen mbi rëndësinë e performancës së administratës tatimore dhe doganore dhe mekanizmave shtesë që mund të ndiqen për ta përmbësuar. Ministri Ahmetaj u përgjigj se përmirësimi administrativ është pjesë e administrimit së të

ardhurave. "Do të aplikojmë sistem 'online' për të pasqyrimin në kohë reale të transaksione", - shtoi ai. Deputetja Gjylameti i vuri theksin zhvillimit të sektorit të turizmit. Ajo përmendi se projektligjet financiare që shoqërojnë buxhetin 2018 do të ulin evazionin fiskal në këtë sektor dhe nga ana tjetër,

uljen e kostove operative, duke shtyrë TVSH. Pyetjes nga opozita se sa është numri i hoteleve me 5 yje? Cilat janë llojet e shërbimeve, për të kuptuar efektin real, deputetja u përgjigj: "Ka të bëjë me ato njësi akomoduese me pesë yje që do të investohen. Çdo lloj shërbimi do të ketë TVSH të reduktuar".



## Shtatë piketat për zhvillimin e bujqësisë

### Peleshi: Nga zinxhiri i vlerës tek agroturizmi, ja plani



Ministri i Bujqësisë, Niko Peleshi

Shtatë do të jenë piketat për zhvillimin e bujqësisë në vend. Ministri Niko Peleshi gjatë takimit sektorial për bujqësinë, mjedisin dhe turizmin në prezencë të zëvendësministrave dhe anëtarëve të Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese dhe disa detaje. Së pari, sipas ministrit sfidë mbetet rritja e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë, dy elemente që ende në vend i mungojnë sektorit. Së dyti, është ulja e kostove të prodhimit duke iu referuar modeleve më të mira. Zinxhiri i vlerës, i treti në ren-

ditje, është një tjetër element që lidhet më pas me një pikë të rëndësishme, siç janë eksportet. Sipas Peleshit, kjo është e vetmja mënyrë për të rritur tregtinë, duke riparuar ato halka të zinxhirit ku sot vihet re se nuk funksionojnë apo janë inekzistente. Agroturizmi, një nënkomponent, që qëndron mes bujqësisë dhe turizmit

mund të shihet si më përfitim të lartë, pasi të njëjtin produkt e sheh me një vlerë më të lartë. Në vijim dy elemente të tjerë janë përmirësimi i standardeve. Ministri nënvizoi se gjatë vitit në vazhdim do të ketë një rritje të mbështetjes për bujqësinë edhe përmes programit IP-ARD me 93 milionë euro, por edhe përmes buxhetit. Por,

para se të fillojë mbështetja, sipas tij duhet që të ketë formalizim të sektorit, pasi ky është një nga kushtet për të përfuturat fondet e BE. Decentralizimi nga ana tjetër, ku një pjesë e kompetencave që lidhen me institucione të rëndësishme në bujqësi si bordet e kullimit, sipas ministrit ka dhënë efekt pozitiv. Ujtitja dhe kullimi synohen

që të mbështeten në vijim dhe së treti, vijimi i një programi të nisur prej kohësh me Bankën Botërore, që tani ka planifikuar edhe 25 milionë euro shtesë.

Pronarët e puseve duhet të pajisen me leje dhe me sahat. Rezultojnë 25 mijë të tilla

# Sahatet e ujit, 270 mijë familje 90 ditë afat për vendosjen e matësit

Reforma e ujit. Rama: Shkelësit e ligjit do të procedohen penalisht

Ornela Manjani

Nga 1 shkurti 2018 të gjithë konsumatorët që kanë lidhje të paligjshme në sistemin e ujit do të procedohen penalisht. Kryeministri Edi Rama bëri këtë deklaratë në mbledhjen e Task Forcës, që do të zbatohet edhe reformën në këtë sektor. "U japim kohë konsumatorëve të vetëregullohen, në bashkëpunim me bashkinë dhe Policinë e Shtetit. Pastaj do fillojmë prerjen e lidhjeve të paligjshme, por s'do ketë penalizime për 90 ditë. Natyrisht që nga 1 shkurti 2018 të gjithë ata konsumatorë, familjarë apo biznese që kanë ende lidhje të paligjshme do procedohen penalisht dhe rrezikojnë masa të rënda. Konsumatorët me detyrime të prapambetura të marrin masa për t'i likuiduar para se të nisë ndërprerjen e shërbimit", tha Rama. "Brenda viti 2018 çdo konsumator që do të përdorë ujërat nëntokësore duhet të ketë autorizim, leje shfrytëzimi. Në çdo katër 4 litër uji që prodhohet, vetëm 1 litër faturohet dhe kjo bën që shteti të subvencionojë ujësjellësit që të mos falimentojnë. Është një situatë që nuk ka si bëhet me keq - deklaroi Rama. - Ka vite që uji konsiderohet si



Kryeministri Edi Rama

mall pa zot dhe jo si një pasuri kolosale për t'u përkthyer në përfitime për të gjithë", këtë deklaroi kryeministri Rama gjatë lancimit të aksionit kombëtar për pastrimin e rrjetit nga lidhjet e paligjshme të ujit. **FAMILJET PA SAHAT** Në vendin tonë rezultojnë 270 mijë familje, të cilat përdorin ujë në mënyrë të paligjshme, pa matës, duke u bërë shkak që të penalizohen edhe familjet e rregullta. Në disa qytete në çezma uji vjen 4-5 orë, e në fshatra akoma më rrallë. Gjithashtu, rezul-

tojnë të hapura 25 mijë puse, nga të cilat vetëm 265 kanë leje. "Brenda vitit 2018 çdo konsumator që do të përdorë ujërat nëntokësore duhet të ketë autorizim, leje shfrytëzimi. Në çdo katër 4 litër uji që prodhohet, vetëm 1 litër faturohet dhe kjo bën që shteti të subvencionojë ujësjellësit që të mos falimentojnë. Është një situatë që nuk ka si bëhet me keq", deklaroi Rama. Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Damian Gjiknuri theksoi rëndësinë e këtij procesi. "Sot jemi përpara në një tjetër sfidë,

që synon ndërmarrjen e një operacioni kombëtar me qëllim miradministrimin e ujit, duke i dhënë fund abuzimit e paligjshmërisë me të. Prodhimë 20% më shumë sa nevojitet sikur të gjithë të kishim një furnizim 24 orë në 7 ditë të javës. Në 3 litra uji që prodhohet vetëm 1 arrin të faturohet, pjesa tjetër vhihet dhe shpërdorohet", - u shpreh ministri në fjalën e tij. Më tej, ai theksoi se prej 20 vitesh ndërmarrjet e ujësjellësve janë konceptuar si vende pune për militantët dhe jo kompani që duhet të administrojnë këtë pasuri publike dhe se pavarësisht investimeve të kryera nga ana e bashkive nuk është garantuar rritja e performancës së ujësjellësve, ndaj theksoi ai është bërë e detyrueshme tashmë për qeverinë që të ndërmarrë këtë operacion kombëtar për luftën ndaj informalitetit në ujë dhe pijshëm. "Objektivi kryesor është që brenda vitit 2018 çdo konsumator të jetë i pajisur me kontratë dhe matës, të paguajë rregullisht detyrimet dhe të jetë i ndërgjegjshëm për rëndësinë e ujit të pijshëm", nënvizoi më tej Gjiknuri, ndërsa paralajmëroi takime në ditët e ardhshme me drejtuesit e ujësjellësve për të sqaruar mënyrën se si do të funksionojë ky operacion.

### SITUATA AKTUALE E UJIT

- 12% e energjisë së faturuar shkon për të nxjerrë ujë të pijshëm, afro 30 milionë euro në vit.
  - Gjatë 4 viteve të fundit janë shpenzuar rreth 400 milionë euro për të ndërtuar ujësjellës të rinj.
  - Shteti shqiptar përmes qeverive të ndryshme ka shpenzuar para në 23 vite për të pasur 27 strategji, pra janë investuar, por askush s'e di çfarë është bërë me to.
- NISJA E AKSIONIT**
- 90 ditë kanë kohë të gjitha ata që furnizohen me ujë të vetëregullojnë situatën e tyre.
  - Qeveria në bashkëpunim me bashkitë dhe policitë do të nisë prerjen e lidhjeve të paligjshme, por jo me dërmime.
  - 1 shkurt të vitit 2018 të gjithë ata konsumatorë që do të verifikohen që kanë lidhje të paligjshme do të ndiqen penalisht.
  - Konsumatorët që kanë detyrime të prapambetura të marrin masa për pagesën, para se t'u rrehet lidhja.
  - Të gjitha ndërmarrjet e ujësjellësit që nuk përfshihen në aksion nuk do të përfundojnë subvencione nga qeveria.
  - Në këtë operacion pjesë është edhe paketa e solidaritetit për shtresat në nevojë.

## BSH, memorandum bashkëpunimi me Bankën Qendrore turke

Banka e Shqipërisë nënshkroi një memorandum bashkëpunimi me Bankën Qendrore të Republikës së Turqisë. Memorandumi u nënshkrua nga guvernatorët Gent Sejko dhe Murat Çetinkaya. "Ky memorandum u shton një dimension të ri marrëdhënieve midis vendeve tona. Ai konfirmon vullnetin për të rritur më tej këtë bashkëpunim dhe për të konsoliduar lidhjet midis dy vendeve, duke u krijuar të dyja institucione hapësirë e nevojshme për intensifikimin e shkëmbimit të ndërsjellë të informacionit dhe ekspertizës në fusha të ndryshme të bankingu qendror, si: mbikëqyrja, stabiliteti financiar, puna kërkimore, edukimi financiar etj., si dhe të dialogut të rregullt në nivel teknik e politik. Ai përbën një hap të rëndësishëm për të përfutur maksimalisht nga efektet pozitive të integritimit dhe për të minimizuar ato negative", tha në fjalën e rastit guvernatori Sejko. Ai nënvizoi rëndësinë e memorandumit në kontekstin ndërkombëtar, stadin e marrëdhënieve dypalëshe dhe drejtimet kryesore të bashkëpunimit në të ardhmen. Peshja e Turqisë në ekonominë shqiptare është e fortë, si partneri i katërt tregtar me Shqipërinë dhe i gjashtë sa u përket investimeve. Sejko nënvizoi gjithashtu se janë rreth 429 kompani të përbashkëta dhe interesi i investitorëve turq është i madh. "Stoku i investimeve të huaja direkte nga Turqia llogaritet në rreth 481 milionë euro, duke përfqësuar rreth 4.3% të Prodhimit të Brendshëm Bruto në fund të gjashtëmujorit të parë të këtij viti. Këto investime janë përqendruar kryesisht në fusha si: energjëtika, përpunimi i metaleve, telekomunikimi dhe ajo financiare", deklaroi guvernatori.



Përmbuesi gjyqësorë Gentil Bushati nxjerr për shitje në ankand pasurine :  
 a) Tokë are e rregjistruar në regjistrin hipotekorë me nr pasurie 111122, volumni 5, Fage 27, në zonen kadastrale nr 1898, me sipërfaqe totale 5990 m<sup>2</sup>, e ndodhur në adresën Gur i Zi, Shkodër  
 b) Tokë are e rregjistruar në regjistrin hipotekorë me nr pasurie 147456, volumni 7, Fage 48, në zonen kadastrale nr 1898, me sipërfaqe totale 3492 m<sup>2</sup>, e ndodhur në adresën Gur i Zi, Shkodër  
 1. Çmimi me të cilin do të fillojë shitja në ankand është në masën sipërcaktuar me posthë  
 a) për pasurinë "Toka Are" me sipërfaqe 5990 m<sup>2</sup>, është në vlerën 1,920,000 leke  
 b) për pasurinë "Toka Are" me sipërfaqe 3492 m<sup>2</sup>, është në vlerën 1,400,000 leke  
 Shitja e pasurisë do të bëhet (zhvillohet) me datë 14.11.2017 ora 16.16 në Zyren e përmbuesit gjyqësorë Gentil Bushati me adresë Rruga Don Bosko, Partëllë Gjykatës së rrethit Gjyqësorë Shkodër. Personat e interesuar duhet të dorëdhin përpara fillimit të ankandit 10% të vlerës si garanci në Tiranë Bank me nr IBAN AL74 2065 1017 0000 6003 1383 9100.

Përmbuesi gjyqësorë Gentil Bushati nxjerr për shitje në ankand pasurine :  
 "Apartamenti" me sipërfaqe 127.7 m<sup>2</sup>, e rregjistruar në regjistrin hipotekorë me nr 82 date 02.06.2011 me volumni 5 fage 108 me nr pasurie 16/130-18, në Zonen Kadastrale 8597 me adresë, lagja "Pazar", Shkodër  
 2. Çmimi me të cilin do të fillojë shitja në ankand për pasurinë e sipërcaktuar, është në vlerën 3,124,800 (tremilëme e njëqind e njëzetatë mijë e tetëdhjetë) leke .  
 Shitja e pasurisë do të bëhet (zhvillohet) me datë 15.11.2017 ora 16.16 në Zyren e përmbuesit gjyqësorë Gentil Bushati me adresë Rruga Don Bosko, Partëllë Gjykatës së rrethit Gjyqësorë Shkodër. Personat e interesuar duhet të dorëdhin përpara fillimit të ankandit 10% të vlerës si garanci në Bankën BKT dega Shkodër me nr llogarie 41064051, ose në Tiranë Bank me nr IBAN AL74 2065 1017 0000 6003 1383 9100 .

Përmbuesi gjyqësorë Gentil Bushati nxjerr për shitje në ankand pasurine :  
 a) Tokë are e rregjistruar në regjistrin hipotekorë me nr pasurie 5821, volumni 10, Fage 248, në zonen kadastrale nr 1100, me sipërfaqe totale 2230 m<sup>2</sup>, e ndodhur në adresën Barbullush Shkodër  
 b) Tokë are e rregjistruar në regjistrin hipotekorë me nr pasurie 52321, volumni 9, Fage 3, në zonen kadastrale nr 1100, me sipërfaqe totale 2360 m<sup>2</sup>, e ndodhur në adresën Barbullush Shkodër  
 1. Çmimi me të cilin do të fillojë shitja në ankand është në masën sipërcaktuar me posthë  
 a) për pasurinë "Toka Are" me sipërfaqe 2360 m<sup>2</sup>, është në vlerën 697,680 leke .  
 b) për pasurinë "Toka Are" me sipërfaqe 2360 m<sup>2</sup>, është në vlerën 509,760 leke  
 Shitja e pasurisë do të bëhet (zhvillohet) me datë 08.11.2017 ora 16.16 në Zyren e përmbuesit gjyqësorë Gentil Bushati me adresë Rruga Don Bosko, Partëllë Gjykatës së rrethit Gjyqësorë Shkodër. Personat e interesuar duhet të dorëdhin përpara fillimit të ankandit 10% të vlerës si garanci në Tiranë Bank me nr IBAN AL74 2065 1017 0000 6003 1383 9100.

Gjykata e Tiranës ka vendosur dje masën e sigurisë arrest me burg për Hasan Sulën, të cilit ju gjetën në banesë e tij në Rinas 1.2 tonë kanabis. Bashkëshortja e tij, Merita Sula, u la e lirë nga gjykata, pasi Hasan Sula e mori përsipër gjithë përgjegjësinë. Para hetuesve Hasan Sula me arsim 8-vjeçar dhe me profesion roje ka deklaruar se drogën e ka kultivuar ai në tokën rreth banesës dhe



## Bashkëshorti mori përgjegjësinë, lirohet gruaja Iu gjetën 1.2 tonë kanabis, burg për Hasan Sulën

asnjë nga familjarët e tij s'ka pasur dijeni. Për Hasan Sulën dhe Merita Sulën, prokurori Julian Zonja kërkoi caktimin e masës arrest me burg, por kjo kërkesë u pranua vetëm për kryefamiljarin, ndërsa bashkëshortja e tij u lirua në sallën e gjyqit. Sipas prokurorit Zonja, oficerët e

policisë gjyqësore në të gjithë banesën e Hasan Sulës kanë konstatuar një laborator canabisi që niste me tharjen, paketimin e më pas tregtimin e lëndës narkotike. "Nga kontrolli i ushtruar në banesë u gjetën lënda e dyshuar si kanabis sativa e ndarë në 170 thasë

plastik të mbyllur me vakum, një pushkë me gjastë plumba dhe një peshore elektronike, e cila dyshohet se përdorej për peshimin e lëndës narkotike", u shpreh prokurori Zonja. Policia e Tiranës bëri publike operacionet "Befasia" dhe "Pafafindo" që çuan në pran-

gosjen e 6 personave mes tyre dhe çiftit Sula, por për prokurorinë ende po kryen hetimet për të parë nëse të ndaluarit kanë apo jo bashkëpunim mes tyre. Burime nga akuzat sqaruan për ReportTV se po kryhen hetimet si për arrestimin e dy djemve të Hasan Sulës, Klodjan e Sajmir Sula, si dhe për të gjetur kush janë investitorët e këtij grupi që shtëpinë e Hasan Sulës e kishin kthyer në një laborator kanabisi.

Krimet e Rënda: Më 8 nëntor jepet vendimi për ndryshimin ose jo të masës së sigurisë

Ina Allkanjari

Prokuroria për Krimet e Rënda kërkoi dje masë të re sigurie ndaj të pandehurit Nezar Seiti. Kërkesa e depozituar në gjykatë konsistonte në zgjatjen e afatit të arrestit nga 20 ditë në pa afat ndaj Seitit, një prej të dyshuarve si pjesëtar i grupit kriminal "Habilaj". Krimet e Rënda kishin caktuar në tetor masën e sigurisë arrest me afat 20 ditor ndaj tij, në mënyrë që gjatë kësaj kohe prokurorët të siguronin prova për të arrestuarin e Babicës, i cili u kap me 4 tonë drogë. Masa për Seitin skadon më 14 nëntor dhe ai duhet të ekstradohet në Itali, pasi mbi të rëndon akuzat e përfshirjes në trafikun e drogës Shqipëri-Itali. Organi I akuzës pretendon se i ka siguruar këto prova në kuadër të hetimit të çelur ndaj Seitit, ndaj kërkon burg për të. Ndërkohë avokati i tij mbrojtës, Detar Hysi, tha se është dakord me ekstradimin dhe se nuk duhet të kërkohet shtim afati. Sipas tij në këtë mënyrë po pengohet ekstradimi i Seitit drejt Italisë. "Jemi dakord me ekstradimin, s'ka pse kërkohet shtim afati. Klienti im ka dhënë pëlqimin të ekstradohet, por po e pengojnë, ai kërkon të gjykohe në Itali", tha avokati i Seitit. Sakaq Krimet e Rënda do të japin vendimin për ndryshimin ose jo të masës së sig-

# Droga në Babicë, Nezar Seiti kërkon ekstradimin në Itali: Dua të gjykohe me atje

## Prokuroria kërkesë: "Burg pa afat" për të pandehurin

**AVOKATI MBROJTËS**  
Avokati mbrojtës i Seitit, Detar Hysi, tha se është dakord me ekstradimin dhe se nuk duhet të kërkohet shtim afati. Sipas tij në këtë mënyrë po pengohet ekstradimi i Seitit drejt Italisë. "Jemi dakord me ekstradimin, s'ka pse kërkohet shtim afati", - tha avokati.



I pandehuri Nezar Seiti në gjykatë

urisë ndaj Seitit, më datë 8 nëntor.  
**DËSHMIA E SEITIT TË KRIMET E RËNDA**  
Më herët Prokuroria e Krimet e Rënda ka marrë në pyetje të dyshuarin si bashkëpunëtorin e ngushtë të Moisi Habilajt, Nezar Seitin. Mar-

rja në pyetje ka ardhur pasi Krimet e Rënda kanë siguruar dosjen e Nezar Seitit, të ardhur nga prokuroria e Katanias. Krimet e Rënda e kanë pyetur Nezarin për përgjimet dhe rolin e tij në trafikun ndërkombëtar të drogës. Seiti ka pranuar para prokurorëve

të Krimet të Rënda se ka lidhje krushqie me Habilajt, pasi gruaja e tij i ka kushërinj. Gjithashtu, ai ka thënë se ka udhëtuar shpesh drejt Italisë në kërkim të punëve të ndryshme, dhe se kthehej shpesh në Shqipëri për të parë prindërit e moshuar, që ban-

ojnë në Vlorë. "Me shtetasit Artan, Moisi dhe Florian Habilaj, kam lidhje krushqie, pasi bashkëshortja ime i ka kushërinj. Moisiu më vizitoi kur kreuva një ndërhyrje në Itali. Vëllezërit i kam takuar kur jam kthyer në Shqipëri. Me Moisiun dhe Florianin tako-

hem rrallë, ndërsa me Artanin më shpesh", - ka rrëfyer në dëshminë e tij Nezar Seiti. Lidhur me trafikun e drogës, dhe rolin e tij si bashkëpunëtor i Moisi Habilajt, Nezar Seiti nuk ka preferuar të japë shpjegime. Ai ka kërkuar që të gjykohe në shtetin fqinj, ku janë ngritur akuzat e para, duke i thënë "po" ekstradimit. Nga ana tjetër, pritet që të mbërrinë shkresat përkatëse nga Itali për ekstradimin e Nezar Seitit. Nezar Seiti 40 vjeç, është arrestuar nga Guardia di Finanza e Katanias në Vlorë. Ai akuzohet se është referuesi logjistik dhe personi përgjegjës për zbarkimet e drogës në Itali në kuadër të aktiviteteve të zhvilluara nga organizata shqiptare e kryesuar nga Moisi Habilaj, kryetrafikanti i rrjetit dhe nga bashkëpunëtorët e tij Maridian Sulaj 29 vjeç e Fatmir Minaj 55 vjeç.

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Haki Çako, priti dje në takim një delegacion të lartë të policisë turke të kryesuar nga Selami Altinok, Guvernator dhe Drejtori i Përgjithshëm i Sigurisë së Republikës së Turqisë. Fokusi i këtij takimi ishte diskutimi i çështjeve në interes të përbashkët për fuqizimin e mëtejshëm të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet policive të dy vendeve, në kuadër të luftës kundër terrorizmit, krimin të organizuar si dhe shkëmbimit i eksperiencave në fushën e Policimit. Çako dhe Altinok kanë vlerësuar si të shkëlqyer bashkëpunimin midis autoriteteve policore shqiptare dhe turke, për parandalimin

## Altinok: Gjatë 2018-ës të mblihdhet Komisioni për Sigurinë në Turqi

# Tiranë, Çako takon homologun turk: Luftë kundër terrorizmit

**SELAMI ALTINOK**  
"Jam tepër i lumtur që si Drejtor i Përgjithshëm i policisë turke ndodhem këtu në Shqipëri, në Drejtorinë e Përgjithshme të policisë shqiptare. Unë uroj dhe dëshiroj që kjo vizitë të kontribuojë shumë në zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit që vazhdon prej një kohe të gjatë midis dy drejtorive të përgjithshme të dy institucioneve tona".

dhe goditjen e terrorizmit, krimin të organizuar dhe trafikeve të paligjshme. Të dy drejtuesit kanë nënvizuar gatishmërinë që ashtu si me vendet e tjera të Ballkanit, të

thellojnë edhe më tej luftën kundër elementëve radikalë. Gjatë takimit Çako u shpreh se pavarësisht nga gjuha, misioni dhe qëllimi mes dy vendeve ka qenë i njëjtë, për

këtë arsye operacionet e përbashkëta kanë pasur sukses. "Në emër të Policisë së Shtetit ju shpreh mirënjohjen e thellë lidhur me çdo mbështetje, e në mënyrë të veçantë, me kontributin që i është dhënë Policisë së Shtetit në arsimimin policor, por edhe me vazhdimin e specializimeve që bëjnë oficerët e policisë shqiptare në Akademinë e Turqisë. Keni treguar se pavarësisht nga gjuha, misioni dhe qëllimi ka qenë i njëjtë, ndaj dhe operacionet e përbashkëta kanë pasur sukses të



padiskutueshëm dhe të vlerësuar nga partnerët tanë", - tha Haki Çako. Ndërkohë Guvernatori dhe Drejtori i Përgjithshëm i Sigurisë së Republikës së Turqisë, Selami Altinok gjatë takimit uroi që kjo vizitë të kontribuojë në zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit mes dy vendeve. "Jam tepër i lumtur që si Drejtor i Përgjithshëm i Policisë Turke ndodhem këtu në Shqipëri, në Drejtorinë e Përgjithshme të

Policisë Shqiptare. Unë uroj dhe dëshiroj që kjo vizitë të kontribuojë shumë në zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit që vazhdon prej një kohe të gjatë midis dy drejtorive të përgjithshme të dy institucioneve tona. Marrëdhëniet tona po vazhdojnë në të gjitha fushat në një mënyrë të përkryer. Ka pasur një bashkëpunim shumë të mirë dhe intensiv në fushën e trajnimeve midis dy drejtorive të Përgjithshme", - u shpreh Altinok. Në fund të takimit Altinok shprehur kërkesën që gjatë vitit 2018 të mblihdhet Komisioni i Përbashkët për Sigurinë, dhe ky Komision të mblihdhet në Turqi, kërkesë që u mirëprit dhe u vlerësua si shumë e vlefshme nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Haki Çako.



Të pandehurit akuzohen për trafikim të lëndëve narkotike

# "Xibraka" në Apel, nipi i Enverit dhe 8 të tjerët kërkojnë rigjykim

## Prokuroria bie dakord me gjykimin e shkurtuar

**A**peli për Krimet e Rënda ka shqyrtuar dhe ankimimet e 9 të pandehurve të dosjes "Xibraka", për rigjykim të dënimit të tyre. Përmes avokatëve mbrojtës të dënuarit kanë kërkuar ndryshimin e vendimit të Shkallës së Parë dhe pranimin e gjykimin të shkurtuar. Gjatë seancës gjyqësore avokati Ermal Hoxhës argumentoi se klienti i tij kishte lidhje shoqërore me Genc Xhixhën dhe se ai miqësisht i ka kërkuar të shoqërojë kolumbianët deri te fabrika, ku u gjet edhe droga. Por sipas tij, Hoxha nuk ka pasur asnjë informacion se çfarë bëhej në atë fabrikë. Prokuroria është dakord me gjykimin e shkurtuar, por kërkon lënie në fuqi të fajësise. 9 të dënuarit akuzohen për veprat penale "Moskallëzim krimi" dhe "Mbajtje narkotikësh". Sakaq vendimi për kërkesën e 9 të dënuarve të "Xibraka" do të jepet më 15 nëntor. Ndërkohë 9 të pandehurit më herët i janë njohur me dënimet Ermal Hoxha - 10 vjet burg; Arjan Dalipi - 10 vjet burg; Cezar Avila - 12 vjet burg; Ilir Hysenaj - 12 vjet burg; Saimir Batku - 13 vjet burg; Klement Dalipi - 11 vjet burg; Genci Xhixha - 13 vjet burg; Gentjan Gjonaj - 11 vjet burg; Walter Moreno - 12 vjet burg.

### HETIMI I PROKURORISË

Hetimi i Prokurorisë së Krimëve të Rënda nisi më 17 dhjetor 2014 pas mbërritjes së një informacioni nga ana e autoriteteve gjermane mbi organizimin e një aktiviteti



Droga e kapur në Xibrakë

### DËNIMET E DHËNA PËR 9-TË PËRVEPTARËT E DOSJES "XIBRAKA"

- Ermal Hoxha - 10 vjet burg
- Arjan Dalipi - 10 vjet burg
- Cezar Avila - 12 vjet burg
- Ilir Hysenaj - 12 vjet burg
- Saimir Batku - 13 vjet burg
- Klement Dalipi - 11 vjet burg
- Genci Xhixha - 13 vjet burg
- Gentjan Gjonaj - 11 vjet burg
- Walter Moreno - 12 vjet burg

të trafikimit të një sasi lëndë narkotike të dyshuar si kokainë nga Shqipëria drejt Gjermanisë. Ky informacion iu përcoll Prokurorisë për Krimet e Rënda, e cila në dt. 18.12.2014, regjistroi procedimin penal për "Trafikim të lëndëve narkotike" dhe vijoi hetimet lidhur me personat e dys-

huar si të përfshirë në këtë grup të strukturuar kriminal. Në bazë të hetimeve të Prokurorisë për Krimet e Rënda rezultoi se të pandehurit kanë krijuar një grup të strukturuar kriminal për trafikimin e lëndëve narkotike, në kuadër të të cilit ata kanë importuar në territorin e Republikës së Shqipërisë një sasi lëndë në përmbajtje të së cilës ka qenë e fshehur kokainë. Për ekstraktimin e saj, ata kanë ngritur edhe një laborator ku përpunohej lëndë bazë që përmbante kokainën deri sa nxirrej në formën e saj përfundimtare, e gatshme për t'u shitur në treg apo trafikuar. Prania e kokainës në një sërë lëndësh që ndodheshin të depozituara në enë, shishe qelqi, qese, kontenerë etj, provon plotësisht se në magazinën në Xibrakë ishte ngritur një laborator për ekstraktimin e ko-

kainës nga lëndë ku ishte fshehur më parë, me qëllim kalimin me lehtësi të kontroleve në pikat doganore.

### OPERACIONI I POLICISË

Laboratori i kokainës në Xibrakë dhe përfshirja e nipit të Enver Hoxhës, Ermal

Hoxha, ishte një prej operacioneve më të rëndësishme të zhvilluara nga policia. Në datë 14.01.2015 uniformat blu të asistuar nga agjentë të policisë gjermane, sekuestruan një sasi rekord të kokainës prej 100 kg. Droga u gjet në një magazinë në fshatin Xibrakë 10 km larg qytetit të Elbasanit. Gjatë operacionit u arrestuan në flagrancë tetë persona, të cilët u gjenden brenda dhe pranë magazinës së drogës, mes tyre dhe kreu i grupit Saimir Batku, nipi ish-diktatorit Enver Hoxha, Ermal Hoxha dhe dy shtetas kolumbianë. Ndërkohë që u shpall në kërkim Genci Xhixha, i cili njihet si kreu i një rrjeti të fuqishëm të trafikut të kokainës në Europë dhe më gjerë. Në vijim të operacionit ra në pranga edhe Genc Xhixha.



Shkëlqim Gjiq për ish-kreun e Burgjeve Artur Zoto, mungon prokuroria

Shkëlqim Gjiq për ish-kreun e Burgjeve Artur Zoto, për shkak të mungesës së prokurorës, Elizabeta Imeraj. Imeraj nuk është parqitur për arsye shëndetësore, ku po nga të njëjtat burime mësohet se ndodhet e shtruar në spital. Vlen të theksohet se Elizabeta Imeraj është një ndër prokurorët që po heton ish-ministrin Tahiraj për lidhjen e tij me vëllezërit Habilaj të arrestuar nga drejtësia italiane për trafik droge. Po ashtu sot pritej që të dëshmonte edhe ish-zvëndësi i tij, Ilja Lazë. Ish-drejtori i Burgjeve Artur Zoto, është arrestuar shkurtin e këtij viti pasi akuzohet për korrupsion. Gjykata ka vendosur masën "Arrest me burg" për ish-zyrtarin e vënë në pranga nga policia pas vendimit gjyqësor.

## Doshi nën akuzë për fshehje e deklarim të rremë të pasurisë

# Mosdeklarimi i pasurisë, Gjykata e Lartë çon Tom Doshin te Krimet e Rënda

**TIRANË** - Gjykata e Lartë ka shpallur mos kompetencë për akuzat e mos deklarimit të pasurisë të deputetit Tom Doshi. Çështja do t'i kalojë tani Gjykatës për Krimet e Rënda. Po kështu edhe për çështjen tjetër "Doshi-Frroku-Bami", që e dyshon për kallëzim të rremë, Gjykata e Lartë shpalli mos-kompetencë disa ditë më parë. Pak muaj më parë, qershor 2017, prokuroria nuk mundi të provojë qëndrimin e ILDKPI se deputeti ka fshehur 23 milionë euro. Pasuritë që Doshi nuk ka deklaruar janë automjete e pasuri të patundshme, thonë prokurorët.

### DOSJA "DOSHI 2"

Kujtojmë se ILDKPI ka dorëzuar në Prokurorinë e Përgjithshme kallëzimin penal për deputetin Tom Doshi, i cili akuzohet për fshehje dhe deklarim të rremë të pasurisë. Bëhet fjalë për një shumë, që sipas Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë, shkon deri në 23 milionë euro. Shkeljet, sipas ILDKP-së, janë kry-



Deputeti Tom Doshi

er nga viti 2005 deri në vitin 2014. ILDKPI ka dërguar kallëzimin penal në Prokurorinë e Përgjithshme për veprat penale të parashikuara duke insistuar që hetimet të shtrihen më tej për të parë nëse ka ndonjë shkelje tjetër. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Kontrollit të Interesave, bazuar në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhur dhe të disa nëpunësve publike", i ndryshuar, përfundoi kontrollin

dhe rikontrollin e plotë të deklaratave të interesave private të subjektit Tom Doshi, me funksionin Deputet i Kuvendit të Shqipërisë, për periudhën kohore 2005-2014, nga ku rezultuan fshehje të pasurive, deklarime të rreme, për pasuritë në shumën rreth 14.000.000 euro, kontrata fiktive pasurish, transferata bankare të dyshimit e pa burime të ligjshme financiare dhe dyshime për pastrim parash, brenda dhe jashtë vendit, në shumën rreth 9.000.000 euro.



### LAJMËRIM PËR KONTRAKTIM KOMPANIE NDËRTIMI

Caritas Shqiptar kërkon të kontraktojë një kompani ndërtimi për të kryer punime si:

- Rinovimin dhe mobilimin e një ambjenti të përcaktuar si dhomë intervistimi në Drejtorinë Rajonale të kufirit dhe Migracionit në Shkodër.
- Rinovimin dhe mobilimin e një ambjenti të përcaktuar si dhomë intervistimi në Drejtorinë Rajonale të kufirit dhe Migracionit në Kukës.

Informacionin për zhvillimin e këtij tenderi mund ta gjeni duke u interesuar në adresën e facebook-ut: "Caritas Albania-Shqiptar".

Afati i fundit i dorëzimit të ofertave: **10.11.2017, ora 14:00.**

Adresa për dorëzimin e dokumentacionit:

Rruga "Don Bosko", Nr. 4 Tiranë;  
Tel: + 355 4 22 30088; Fax: + 355 4 22 34327

**Kreshnik Nazëraj, i dënuar me 12 vjet burg**

**Vrau dhe plagosi 2 vetë, kapet pas 3 vitesh i kërkuari**

**DURRËS** - Policia e Durrësit në bashkëpunim me blutë e kryeqytetit, në vijim të punës për kapjen e personave të shpallur në kërkim kanë arrestuar pas një operacioni të mirorganizuar një 34-vjeçar nga Fieri, pasi është dënuar nga gjykata me 12 vite burg për vrasje me dashje dhe armëmbajtje pa leje. Në pranga ka përfunduar Kreshnik Nazëraj, banues në fshati Cakran të Fierit, pasi më 6 janar të vitit 2014 në lagjen "Uji i Ftohtë" në Vlorë ka vrarë me armë

zjarri pas një konflikti Myrdar Binjakaj, 32 vjeç, ndërsa kanë mbetur të plagosur: Klodian Binjakaj (vëllai i Myrdarit) dhe Reshat Muska, 43 vjeç kushëri i vëllezërve Binjakaj. Nga hetimet është zbuluar se krimi ka ndodhur, pasi një prej të plagosurve, Klodian Binjakaj ka pasur me qira hotelin e babait të autorit, Kreshnik Nazëraj. Por, kontrata ishte ndërprerë dhe familja Binjakaj pretendonte një shumë të madhe parash si pasojë e prishjes së kontratës së qiradhenies. Nazëraj është kapur në am-



Kreshnik Nazëraj gjatë arrestimit


bientet e një pallati në lagjen nr.17 në Durrës, pasi Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë me vendimin nr.540 dt.10.11.2014 e ka dënuar atë me 12 vjet burg për veprat penale: "Vrasja me dashje" dhe "Armëmbajtje pa leje".

**Autorët i morën 200 mijë lekë e makinën**

**Kurbin, rrëmbehet dhe grabitet emigranti Artur Tushi nga Lezha**

**A**rtur Tushi, një emigrant nga fshati Raboshhtë i Lezhës, i cili jeton në Itali, u denonca se ishte rrëmbyer nga persona të panjohur më 2 nëntor të këtij viti në zonën mes Milotit dhe Burrelit. Sipas TV "Klan", familja e tij denoncoi se ai kishte humbur kontaktet me ta dhe se nuk ishte bërë i gjallë. Menjëherë pas njoftimit të marrë, policia nisi kërkimet në zonën mes Fushë-Milotit dhe në fshatrat që ndodhen pranë rrugës nacionale Milot-

Burrel. Blutë gjetën në këtë aks automjetin në pronësi të Artur Tushit. Nga deklarimet e Tushit, kanë qenë disa persona ende të paidentifikuar, të cilët i kanë vënë një thes në kokë dhe më pas e kanë dërguar në një banesë të panjohur, ku i kanë marrë 200 mijë lekë dhe automjetin. Nga verifikimet e kryera nga hetuesit është mësuar se i riu nuk ka pasur precedentë penalë në Shqipëri, por as në Itali. Blutë dyshojnë se ngjarja mund të ketë lidhje me përfshirjen e të riut në ak-



Artur Tushi

tivitete të paligjshme jashtë apo brenda e vendit, çka ka sjellë edhe ngjarjen. Policia ka nisur hetimet me akuzën vjedhjes me dhunë në bashkëpunim, si dhe të heqjes së paligjshme të lirisë.

Dëmi i shkaktuar mbi 2 mln euro, nis procedura e ekstradimit në Shqipëri

**Kontrabanda e naftës "Virxhin", kapet në Zvicër biznesmeni Xhillari**

*Kompania akuzohet se ka shitur 4.4 mln litra naftë të papërpunuar*

**ZVICËR**

**B**iznesmeni i njohur, Adrian Xhillari, i cili ishte shpallur në kërkim prej vitit 2015, si njëri prej personave të përfshirë në skemën e kontrabandës së naftës "Virxhin" është arrestuar në Zvicër për llogari të drejtësisë shqiptare. Burime nga prokuroria e Fierit i pohuan "BIRN" se Xhillari ishte ndaluar javën e kaluar në Zvicër, ndërkohë që pala shqiptare pret që ai të ekstradohet për t'u përballur me drejtësinë. Të njëjtat burime thanë se Prokuroria e Përgjithshme ka dërguar menjëherë letër-porositë dhe shoqëruar me urdhër-ndalimin dhe dosjen hetimore në ngarkim të Xhillarit, me qëllim ekstradimin e tij në Shqipëri.

Administratori i kompanisë "Tea Konstruktion & Petrol sh.a.", Adrian Xhillari akuzohet për veprat penale "Fshehje e të ardhurave", "Mospagimitaksave" dhe "Pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" dhe ndaj tij vazhdon të qëndrojë në fuqi masa e sigurimit "arrest në burg" e dhënë në mungesë. Mbrojtësit e Xhillarit ishin të paarrtshëm për një koment ditën e djeshme.

Çështja në ngarkim të Xhillarit, ish-zv/drejtoreshës së Përgjithshme të



Doganave, Lula Njebza dhe ish-kreut të degës së Doganës së Tiranës, Mirabër Teneqexhiu po shqyrtohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë deri në momentin që Gjykata e Lartë do të vendosë për kompetencën territoriale. Më herët, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier vendosi të shpallë moskompetencën për gjykimin e kësaj çështjeje duke e dërguar atë në Gjykatën e Tiranës, por kjo e fundit gjeti se vendimi i kolegëve në Fier ishte i paligjshëm dhe vendosi të ankohe në Gjykatë të Lartë për mosmarrëveshje të kompetencës tokësore.

Çështja ndaj tre të akuzuarve të sipërcituar nisi pas një denoncimi të kryer nga Croëan Agents në maj të vitit 2015 në prokurorinë e Fierit. Në dhjetor të po atij viti, prokuroria urdhëroi ndalimin e Xhillarit, Njebzës dhe disa doganierëve të tjerë të akuzuar për "Falsifikim" dhe "Shpërdorim detyre", ndërsa disa muaj më vonë dosja u dërgua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier për shqyrtim.

Sipas prokurorisë, Adrian Xhillari në cilësinë e administratorit të shoqërisë "Tea Konstruktion & Petrol", ka blerë në maj të vitit 2010 një sasi prej 5.65 milionë kg naf-

**2 MLN EURO**  
Sasia e naftës prej 4.4 mln litra, e cila nuk lejohet të dalë në treg pasi është e cilësisë bruto, nuk ka mbërritur në depozitat në Ballsh, por është shpërndarë nëpër pika karburanti në qytete të ndryshme të Shqipërisë, duke u shitur në treg të lirë. "Zhdokja" e kësaj sasive të madhe naftë, i ka shkaktuar shtetit një dëm mbi 2 mln euro nga shrmangia e pagimit të akcizës.

të "Virxhine" me vlerë 500 milionë lekë nga rafineria e Ballshit. Në janar 2014, drejtorja e Doganave, drejtorja e Tatim Paguesve të Mëdhenj dhe Dogana e Tiranës kanë inspektuar depozitat e kompanisë në Kodër Mëzës në Tiranë për të verifikuar sasinë e naftës "Virxhine" që kompania kishte në gjendje, e cila është vlerësuar nga grupi përbashkët i inspektimit në 4.4 milionë litra. Sipas prokurorisë, pas inspektimit në gusht 2014, Xhillari ka ndërthur në bash-



Viktima Zamir Latifi

**"Policia e prokuroria, një me krimin"**

**Masakra në Lushnjë, babai i viktimës Zamir Latifi: Nuk duam hakmarrje**

**LUSHNJË** - Afro një muaj pas masakrës së ndodhur në qendër të qytetit të Lushnjës, ku mbetën të vrarë dy të rinj dhe u plagosën dy të tjerë, babai i njërit prej viktimave dhe konkretisht, Fatos Latifi ka bërë një deklaratë për mediat, ndërsa i bën apel shtetit që të zbardhë ngjarjen. Familja Latifi pohon se në asnjë rast nuk kanë menduar apo diskutuar që të bëjnë drejtësi përmes hakmarrjes, ndërsa gjithçka ia kanë lënë në dorë shtetit. Mes të tjerash familja Latifi u shpreh se policia dhe prokuroria e Lushnjës, është një me krimin.

**REAGIMI**

"Unë babai i Zamir Latifit, Fatos Latifi bashkë me familjen time deklaroj se nuk kam menduar apo diskutuar ndonjë moment për hakmarrje. Unë e kam lënë çdo gjë në dorë të shtetit duke menduar se shteti dhe ligji do të më ndihmojnë për atë çka ndodhi dhe se do të vendosin drejtësi. Policia dhe prokuroria e Lushnjës është bërë një me krimin. U bënë kaq ditë dhe as policia dhe as prokuroria nuk është marrë me hallin që kemi ne, por përkundrazi po ndihmon autorët e krimin që të largohen nga Shqipëria. Atentatorët kërkojnë t'i heqin familjarët e tyre nga Shqipëria që të jenë të lirë, të veprojnë përsëri. Kam kërkuar takim me zotin Rama dhe nuk mora përgjigje, njëkohësisht kërkova dhe takim me ministrin e Brendshëm, zotin Xhafaj, por nuk ma afruan këtë mundësi. Në këto kushte u bëj apel nëpërmjet medias që të vendosin drejtësi për masakrën që u kushtoi jetën dy djemve të rinj në qytetin e Lushnjës dhe të parandalojnë humbjen e jetëve të tjera të pafajshme", - thuhet në deklaratën e Fatos Latifit.

këpunim me të pandehurën Lula Njebza, në atë kohë zv/drejtoreshë e Përgjithshme e Doganave dhe të pandehurin Mirëarbër Teneqexhiu, me detyrë drejtor i Doganës së Tiranës një skemë fiktive për zhvendosjen e sasive së naftës të depozituar në Kodër Mëzës drejt depozitës G-43 në Ballsh, duke i mundësuar kompanisë Tea Konstruktion & Petrol të hedhë në treg në mënyrë të paligjshme, sasinë prej rreth 4.4 milionë litra "naftë virx-

hine" dhe të shmangë detyrimet tatimore të akcizës. Më herët, në lidhje me këtë dosje u dënuar Alfred Bushi dhe Syrja Misiraj në gjykatën e Fierit, Bushi mori pajfajësi në Apel, ndërsa Misiraj u dënu me 1 vit burg. Në një proces të mëvethëm po shqyrtohet çështja edhe ndaj Adrian Alikajit. Pritet që në ditët në vazhdim, autoritetet e drejtësisë zvicerane të vendosin për ekstradimin ose jo të Xhillarit. / Reporter.al/





Foto ilustruese

## Kapen 2 shqiptarë, "kokat" e bandës së trafikut

### Sekuestrohen 75 kg kokainë në portin e Genovas

**ITALI** - Policia italiane ka vënë në pranga dy shqiptarë, pasi akuzohen si kokat e një bande të trafikut të drogës. Bëhet fjalë për 38-vjeçarën Besnik Dauti dhe 37-vjeçarin Artur Mahmutaj. Dy shqiptarëve iu sekuestruan 75 kg kokainë e zbarkuar në portin

e Genovës. Mediat italiane raportojnë se lënda narkotike fillimisht do të shkarkohej në Itali dhe më pas do të shpërndahej në vendet e tjera europiane. Ishte pikërisht një anëtar italian i bandës, i cili spiunoi tek policia italiane shqiptarët, duke zbuluar se si funksion-

onte rrjeti i trafikut të drogës. Përgjimet dhe ndjekjet e tij çuan në zbulimin e gjithë bandës. 45-vjeçari Massimo Roça zbuloi informacione të vlefshme për policinë italiane. Drejtuesit kryesorë të kësaj bande cilësohen dy shqiptarët e arrestuar,

ndërkohë ata koordinoheshin me një tjetër person, me emrin Rao. Ky i fundit nga verifikimet e bëra rezultoi që ishte personi, i cili do të merrej me transportimin e drogës. Dy shqiptarët tashmë janë në paraburgim në pritje të dënimit.

Blutë, kontrolle antikanabis në banesat e 2 të rinjve dhe në Vlorë, 6 persona në pranga

# I riu arratiset nga furgoni i policisë me pranga në duar, "blindohet" Saranda

*Ermir Idrisllari u kap me kushëririn për vjedhje, u largua nga automjeti i ndihmuar nga banorët*

Arbër Sulo

#### SARANDË


Një 26-vjeçar nga Saranda është arratisur nga furgoni i policisë me pranga në duar. Ermir Idrisllari u arrestua dy ditë më parë nga blutë e qytetit bregdetar së bashku me kushëririn e tij, Kosta Pashaj, pasi i grabitën me dhunë shtetasit F.M. shumën prej 30.000 lekësh. Në momentin që shoqëroheshin në rajon me furgonin e policisë, Idrisllari ka hapur derën e automjetit dhe është larguar me vrap. Mësohet se ai është ndihmuar nga bashkëfshatarët e tij. Menjëherë blutë u vunë në kërkim të tij. Policia ka ushtruar kontroll në banesën e të riut ku u gjet dhe u sekuestrua një sasi prej 22 kg hashash. Pas sekuestrimit të drogës, ka përfunduar në pranga edhe babai i 26-vjeçarit, Mustafa Idrisllari. Burime zyrtare nga Policia e Sarandës bënë dje me dije se ngjarja ka ndodhur në fshatin Vrinë të këtij rrethi. Ndërsa, burime jozyrtare deklaruan për "GSH" se SHÇBA ka pezulluar 6 punonjës të Komisarariatit të Sarandës deri në hetimin e plotë të rrethanave të arratisjes së Ermir Idrisllarit. Pas arratisjes së Ermir Idrisllarit, janë ushtruar kontrolle nga policia në Vlorë dhe Sarandë, ku janë sekuestruar në total 39 kg kanabis, ndërsa janë prangosur pesë persona.

#### ARRATISJA

Që prej dy ditësh, policia e Sarandës është vënë në alarm dhe po punon për kapjen e Ermir Idrisllarit. Burimet e mësipërme pohuan se policia kishte shkuar për të shoqëruar Ermir Idrisllarin dhe bashkëmoshatarin dhe njëkohësisht kushëririn e tij, Kosta Pashaj. Kjo, për faktin se ndaj tyre kishte një denoncim nga shtetasi F.M., të cilit i kishin marrë me dhunë 30.000 lekë të reja. Pasi policia ka arritur t'i kapë dy të rinjtë, ka tentuar t'i shoqërojë me furgon drejt Sarandës. Pikërisht në këtë moment, Ermir Idrisllari ka



I arrestuari, Kosta Pashaj



I arratisuri, Ermir Idrisllari

#### PEZULLOHEN 6 POLICË

Ermir Idrisllari ka mundur të largohet nga furgoni i policisë, edhe pse me pranga në duar. Mësohet se ai është ndihmuar nga disa banorë të zonës. Forca të shumta policie janë nisur me urgjencë drejt fshatit Vrinë, ndërkohë që është njoftuar edhe FNSH. Burime jo zyrtare deklaruan për "GSH" se SHÇBA ka pezulluar 6 punonjës të Komisarariatit të Sarandës deri në hetimin e plotë të rrethanave të arratisjes së Ermir Idrisllarit.

#### AKSIONET ANTIKANABIS

mundur të largohet nga furgoni i policisë, edhe pse i prangosur dhe me ndihmën e disa banorëve të fshatit ka ikur në drejtim të paditur. Forca të shumta policie janë nisur me urgjencë drejt fshatit Vrinë, ndërkohë që është njoftuar edhe FNSH. Mësohet se policia ka kryer kontrolle në familjet Idrisllari dhe atë Pashaj, të cilat kanë lidhje krushqie. Kontrollat kanë vijuar me postblloq tek Ura e Çukës dhe fshatrat Vrinë e Shëndelli dhe deri tek brezi kufitar, por pa rezultat. Gjithashtu, edhe policia e Vlorës ka ushtruar kontroll në fshatin Kotë.

Gjatë kontrollit të ushtruar në banesën Mustafa dhe Ermir Idrisllarit janë gjetur dhe sekuestruar 22 kg kanabis, ndërkohë që menjëherë është arrestuar Mustafa i 56-vjeçar, babai i të arratisurit (është shpallur në kërkim). Kontrolli ka vijuar tek banesa e Feti Idrisllarit, 59-vjeç, ku ky i fundit ka kundërshtuar me dhunë policinë dhe është arrestuar. Gjithashtu, blutë kanë ushtruar kontroll edhe në banesën e tezes së Ermir Idrisllarit, njëkohësisht nëna e Kosta Pashajt. Aty janë gje-

#### AKSIONET ANTIKANABIS NË SARANDË DHE VLORË

##### TË ARRESTUAR

1. Mustafa Idrisllari, 56 vjeç, banues në Vrinë (Sarandë)
2. Feti Idrisllari, 59 vjeç, banues në Vrinë (Sarandë)
3. Aslan Pashaj, 57 vjeç, banues në Vrinë (Sarandë)
4. Fiqirije Pashaj, 54 vjeç, banuese në Vrinë (Sarandë)
5. Kosta Pashaj, 26 vjeç, banues në Vrinë (Sarandë)
6. Erjon Danaj, 33 vjeç, banues në Kotë (Vlorë)

##### NË KËRKIM

1. Ermir Idrisllari, 26 vjeç, banues në Vrinë (Sarandë)

tur 3.4 kg kanabis, ndaj dhe është vënë në pranga 54-vjeçarja Fiqirije Pashaj, e cila rezultoi se ka ndihmuar nipin e saj gjatë arratisjes. Ndërkaq, në pranga ka rënë dhe bashkëshorti i saj, Aslan Pashaj, 57-vjeç, pasi bashkë me gruan kundërshtuan policinë gjatë kontrolleve. Policia ka prerë fletë-arresti dhe

për 26-vjeçarin Kosta Pashaj për vjedhjen me dhunë dhe drogën e gjetur në shtëpi. Ndërkaq, policia e Vlorës ka arrestuar 33-vjeçarin Erjon Danaj, 33 vjeç, banues në Kotë, pasi gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e tij (në oborr) janë gjetur dhe sekuestruar 2 thasë sintetikë me kanabis sativa, në total 9.7 kg.

#### Prangoset se përdhanoi të miturën, nëna e vajzës: E drogoi me hashash

**SARANDË** - Vangjel Selimi nga qyteti i Sarandës ka përfunduar në pranga, pasi ka abuzuar seksualisht me një të mitur. Rasti është denoncuar nga e ëma e vajzës. 21-vjeçari është arrestuar sepse shtetësia O.G. ka bërë kallëzim se ky shtetas ka kryer marrëdhënie seksuale me vajzën e saj të mitur, T.Q., 13 vjeçe. Gjithashtu, edhe në përfundim të rezultatit mjekoligjor ka rezultuar se ky shtetas ka kryer marrëdhënie seksuale me të miturën. Materialet hetimore në ngarkim të të riut kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë për veprën penale "Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur". Vangjel Selimi është arrestuar edhe në vitin 2015 si pjesë e një grupi grabitësish që vepronin në Çukë e Konispol. Ndërkaq, kanë reaguar edhe prindërit e 13-vjeçares. Ata pohuan për "GSH" se vajza e tyre bashkëjetonte prej 1 viti me të riun dhe kjo gjë kishte ndodhur me mirëkuptimin e plotë të tyre. Nëna e të miturës, Oltjana Garo deklaroi se kishte aprovuar që i riu të jetonte me vajzën, duke marrë premtimin se nuk do ta prekte të miturën, derisa ajo të arrinte një moshë madhore. Por, në momentin e parë që qëndruan vetëm 21-vjeçari e drogoi dhe abuzoi me të. "Djali e pranon, vajza jo. Atëherë e revoltuar me gjithë bashkëshortin shkuam në maternitet. Vajza ia tregoi të atit, u revoltova për atë që ndodhi, ai e kishte droguar vajzën me kanabis dhe ajo s'mbante mend asgjë", - tha Garo. Ndërsa, babai i 13-vjeçares kërkoi që drejtësia të bëjë punën e saj dhe ta dënojë të riun. Gjithashtu, ka reaguar edhe motra e të riut të arrestuar. Ajo ka deklaruar se nuk ka asgjë të vërtetë në rrëfimet e prindërve të vajzës. "Ata donin ta martonin me një tjetër dhe shpikën këtë histori", - tha motra e 21-vjeçarit.

## Ministria, apel qytetarëve: Mos i prekni, rrezikoni shëndetin

### Nis fushata kundër tërbimit të dhelprat, 560 mijë vaksina karrem në mbarë vendin



Vaksinat karrem

Sot në mbarë vendin ka filluar vaksinimi i dhelprave kundër sëmundjes së tërbimit, ku avionë të vegjël hedhin në terren një lloj vaksine në gjendje të lëngët në mënyrë të kontrolluar. Nga ky vaksinim janë përjashtuar vetëm qendrat urbane dhe sipërfaqet ujore. Ky projekt i mbështetur nga Bashkimi Europian vjen në kuadër të planit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, i cili po zbatohet për të tetin vit radhazi. Vaksinimi kryhet sipas një procedure moderne dhe që garanton vaksinimin e sigurt dhe në një normë të lartë të dhelprave e kuqe, që janë dhe burimi kryesor i shpërndarjes së tërbimit. Gjatë këtij procesi do të shpërndahen rreth 560 mijë vaksina karrem në vend brenda vjeshtës së këtij viti përgjatë një periudhe 12- ditore. Ndërkohë, avionët e

#### PROCEDURA

Vaksinimi kryhet sipas një procedure moderne dhe që garanton vaksinimin e sigurt dhe në një normë të lartë të dhelprave e kuqe, që janë dhe burimi kryesor i shpërndarjes së tërbimit. Gjatë këtij procesi do të shpërndahen rreth 560 mijë vaksina karrem në vend brenda vjeshtës së këtij viti përgjatë një periudhe 12- ditore.

mi kryesor i shpërndarjes së tërbimit. Gjatë këtij procesi do të shpërndahen rreth 560 mijë vaksina karrem në vend brenda vjeshtës së këtij viti përgjatë një periudhe 12- ditore. Ndërkohë, avionët e

vegjël, nëpërmjet makinërive speciale dhe hartave të sakta do të shpërndahen në mënyrë të automatizuar dhe kontrolluar 20 vaksina për kilometër katror. Vaksinimi kundër tërbimit

bëhet të dhelprat, pasi këto kafshë janë burimi kryesor i kësaj sëmundjeje me pasojë fatale, që transmetohet te qentë dhe te njeriu. Bazuar në statistikat e fundit, mënyra se si bëhet fushata e vaksinimit në Shqipëri ka rezultuar e suksesshme. Ndërkaq, avionët specialë që do të procedojnë në realizimin e procesit kanë siguruar lejet përkatëse dhe do të operojnë nga aeroporti i Kuçovës. Këta avionë janë të dallueshëm nga të tjerët, pasi në trupin e

tyre mbajnë shenjat e regjistrimit: Z3-DAK, Z3-DAD, Z3-DAJ dhe Z3-DAH. Ministria bën thirrje për të gjithë personat që gjatë kësaj periudhe apo dhe më vonë mund të shikojnë vaksina karrem, që të mos i

prekin, hapin apo t'ua japin kafshëve, pasi mund të rrezikojnë shëndetin e tyre. Procesi i vaksinimit kundër sëmundjes së tërbimit të dhelprat zhvillohet dy herë në vit, në pranverë dhe vjeshtë.

Dokumentacioni që duhet të dorëzoni brenda 24 nëntorit të këtij viti

Voltiza Duro

# Bursa në Itali për studentët e Universitetit të Tiranës

## Cilat janë degët ku mund të aplikoni

Studentët e Universitetit të Tiranës kanë afat deri më 24 nëntor të këtij viti për të aplikuar për bursë studimi për semestrin e dytë të vitit akademik 2017-2018. Ky është njoftimi i publikuar në faqen zyrtare të këtij universiteti ku bëhet thirrje për aplikim. Në kuadër të programit Erasmus+, të interesuarit që plotësojnë kriteret mund të përfitojnë 3 muaj studime në Universitetin Tuscia të Italisë për nivelet e mobilitetit Bachelor apo Master. Bursat do të përfshijnë kompensimin mujor në vlerën 850 euro për studentët si dhe kostot e udhëtimit në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës. Të gjithë kandidatët që do të përzgjidhen fitues, nuk do të paguajnë asnjë tarifë shkollimi dhe ndërkohë do të vazhdojnë të shlyejnë tarifat në universitetin e vendit të tyre. Këto bursa synojnë shkëmbimin e studentëve përgjatë një semestri studimi në nivelin Bachelor apo Master. Disa nga degët ku mund të aplikoni për ciklin e parë të studimeve Bachelor janë: Gjuhët moderne; Ekonomia e Biznesit; Inxhinieri Industriale; Shkenca Politike; Komunikimi, Teknologjia e Kultura dixhitale; Shkenca Biologjike etj. Ndërsa në nivelin master studentët kanë mundësi të aplikojnë në këto programe studimi: Komunikimi publik, politik dhe institucional; Marketing; Administrim, Financim dhe kontroll; Inxhinieri Mekanike; Filologji Moderne; Shkenca dhe Teknologjia e Ushqimit; Biologji Qelizore e Molekulare etj. Kandidatët e interesuar për bursa në nivelin Bachelor duhet të dorëzojnë këto dokumente pranë Rektoratit të UT-së: kurrikulumin (CV) në gjuhën angleze apo italiane,



Foto ilustruese

### DEGET

Disa nga degët ku mund të aplikoni për ciklin e parë të studimeve Bachelor janë: Ekonomia e Biznesit; Inxhinieri Industriale; Shkenca Politike, etj., ndërsa, në nivelin Master: Komunikimi publik, politik dhe institucional; Marketing etj

kopjen e pasaportës, vërtetimin e studentit, listën e notave, dëshminë e mbrojtjes së gjuhës angleze apo italiane në nivelin B1, një letër motivimi si dhe dokumentin "Learnig Agreement". Ndërsa aplikantët për bursa në nivelin Mas-

ter, bashkangjitur me dokumentet e sipërpërmendura duhet të dorëzojnë edhe diplomën e listën e notave për ciklin Bachelor si dhe listën e notave të nivelit Master të përkthyer në gjuhën zyrtare anglisht apo italisht.

### APLIKIMI

Dokumenti Learning Agreement është një kontratë mes universitetit të origjinës së aplikantit dhe përcakton lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Aplikantët duhet të kenë kujdes dhe të plotësojnë vetëm seksionin e parë "Before the mobility", ku në tabelën A gjenden të përcaktuara lëndët dhe kreditet që do të marrin në universitetin pritës, ndërsa tabela B informon studentët se cilat prej lëndëve që do të zhvillojnë në universitetin italian do të njihen në UT, pas periudhës së shkëmbimit. Për këtë arsye, kandidatët

### TARIFAT

Bursat do të përfshijnë kompensimin mujor në vlerën 850 euro për studentët si dhe kostot e udhëtimit në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës. Të gjithë kandidatët që do të përzgjidhen fitues, nuk do të paguajnë asnjë tarifë shkollimi dhe ndërkohë do të vazhdojnë të shlyejnë tarifat në universitetin e vendit të tyre.

duhet të përzgjedhin të kryejnë në Universitetin Tuscia po ato lëndë që zhvillojnë në fakultetin në Shqipëri, e në këtë mënyrë lëndët dhe kreditet do të njihen nga institucioni arsimor i origjinës. I gjithë dokumentacioni për aplikim për bursa studimi duhet të dorëzohet dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, pranë Drejtorisë së Komunikimit si dhe të skanuar përmes postës elektronike. Dokumenti "Learning Agreement" te seksioni "Commitment" firmoset fillimisht nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe më pas në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus+, Elton Skendaj.

### DOKUMENTACIONI PËR NIVELIN BACHELOR

- CV (në gjuhën angleze/italiane në vartësi të programit të studimit);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit;
- Listë notash (të përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze/italiane në vartësi të programit të studimit);
- Letër motivimi në gjuhën angleze/italiane në vartësi të programit të studimit;
- Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B1/Italisht B1);
- Dokumenti Learning Agreement;

### DOKUMENTACIONI PËR NIVELIN MASTER:

- CV (në gjuhën angleze/italiane në vartësi të programit të studimit);
- Kopje e pasaportës;
- Vërtetim studentit;
- Listë notash e nivelit Master (të përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze/italiane në vartësi të programit të studimit);
- Listë notash dhe diplomë e nivelit Bachelor (të përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze/italiane në vartësi të programit të studimit);
- Letër motivimi në gjuhën angleze/italiane në vartësi të programit të studimit;
- Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B1/Italisht B1);
- Dokumenti Learning Agreement



Ministri Hussen: Emigracioni do të ndihmojë në kompensimin e plakjes demografike

# Kanadaja do të mirëpresë 1 milion emigrantë gjatë 3 viteve të ardhshme

## Ja reagimet dhe kritikrat mbi projektin historik

Voltiza Duro

Gjatë tre viteve të ardhshme, rreth 1 milion emigrantë do të kenë të drejtën të jetojnë e punojnë në Kanada. Ky projekt vjen në kuadër të strategjisë të prezantuar nga qeveria Liberale, e cila e konsideron si "nivelet më ambicioze të emigracionit në historinë e kohëve të fundit", çka konsiston në rritjen e numrit të emigrantëve ekonomikë në shtetin kanadez. Sipas parashikimeve të bëra, pritet që numri i refugjatëve, bashkimeve familjare dhe emigrantëve ekonomikë në 2018 të shkojë 310 mijë, në vitin 2019 mendohet të rritet në 330 mijë e në 2020 të arrijë shifrën 340 mijë. Ministri i Emigracionit në Kanada, Ahmed Hussen u shpreh se objektivat e rinj do të sjellin emigracionin e Kanadasë në gati një për qind të popullsisë deri në vitin 2020, gjë që do të ndihmojë në kompensimin e një plakje demografike. Ai e quajti atë një plan historik dhe të përgjegjshëm dhe e vlerësoi si më ambiciozin në historinë e kohëve të fundit. "Qeveria jonë beson se të sapoardhurit luajnë një rol jetësor në shoqërinë tonë. Pesë milionë kanadezë janë vendosur të dalin në pension deri në vitin 2035 dhe kemi më pak njerëz që punojnë për të mbështetur të moshuarit dhe pensionistët. Në vitin 1971 kishte 6.6 persona në moshën e punës, por deri në vitin 2012 ky raport kishte shkuar në 4.2 me 1 dhe parashikimet tregojnë se do të arrijë në 2 me 1 deri në 2036, kur pothuajse 100 për qind e rritjes së popullsisë do të jetë një rezultat i emigracionit", tha më tej ministri. Gjithashtu, ai shtoi se emigracioni nxit inovacionin dhe forcon ekonominë, duke hedhur poshtë disa pretendime se të sapoardhurit drenazhojnë burimet e Kanadasë dhe bëhen barrë për shoqërinë. Më tej, ai theksoi se qeveria po punon gjithashtu për të reduktuar diferencat e mbetura dhe për të shpejtuar përpunimin e aplikacioneve në mënyrë që të bashkojë familjet dhe të shpejtojë aplikimet për shtetësinë. Këshilli i Qeverisë Federale për Rritjen Ekonomike kishte rekomanduar nivelet e rritjes për të arritur 450,000 të sapoardhur në vit deri në vitin 2021. Hussen tha se qeveria po merr një qasje më graduale për të siguruar një integrim të suksesshëm. "Në arrijtjen e këtyre numrave ne dëgjuam

**SHIFRAT**  
Rreth 1 milion emigrantë do të kenë të drejtën të jetojnë e punojnë në Kanada. Sipas parashikimeve të bëra, pritet që numri i refugjatëve, bashkimeve familjare dhe emigrantëve ekonomikë në 2018 të shkojë 310 mijë, në vitin 2019 mendohet të rritet në 330 mijë e në 2020 të arrijë shifrën 340 mijë.



Ministri i Emigracionit në Kanada, Ahmed Hussen gjatë prezantimit të projektit

| Class  | 2017    | 2018    | 2019    | 2020    |
|--|---------|---------|---------|---------|
| Economic class                               | 172,500 | 177,500 | 181,000 | 195,800 |
| Family reunification                         | 84,000  | 86,000  | 88,000  | 91,000  |
| Refugees, protected persons and humanitarian | 43,500  | 46,500  | 49,500  | 53,200  |

Source: Government of Canada

me shumë kujdes të gjithë palët e interesuara, të cilët na thanë se duan të shohin një rritje, e duke sjellë një të sapoardhur në Kanada është gjysma e punës. Ne duhet të sigurohemi që njerëzve janë në gjendje t'u jepin mjetet që duhet të kenë sukses sapo të arrijnë këtu", u shpreh ministri i Emigracionit.

**KRIKAT NDAJ PROJEKTI**

Kritikja e imigracionit konservator Michelle Rempel ishte skeptike ndaj planit, duke sugjeruar se qeveria duhet të bëjë një punë më të ardhurve. "Kjo nuk është e mjaftueshme për këtë qeveri që thjesht të paraqesë numrin e njerëzve që po sjellin në këtë vend. Singërisht, liberalët duhet të ndalojnë përdorimin e numrit të refugjatëve, sasinë e parave të shpenzuara në sistemin e imigracionit të Kanadasë", tha Rempel. Kjo e fundit shtoi se Liberalët duhet të sjellin sistemin e imigracionit të Kanadasë "mbrapa në rend" duke mbyllur shtegun në Marrëveshjen e Sigurisë së Vendlindit të Tretë që ka parë migrantët të kalojnë në Kanada në vendkalimet kufitare jozyrtare vetëm për të kërkuar statusin e refugjatit. Rempel, gjithashtu, tha se sistemi i imigracionit duhet të përqendrohet në ndihmën për integrimin e emigrantëve përmes efikasitetit të gjuhës dhe përmes planeve të mbështetjes së shëndetit mendor për njerëzit që janë viktimë të traumave.

**REAGIMET**

Drejtori i Përgjithshëm i Shoqatës Kanadeze të Konsulentëve të Imigracionit Profesional, Dory Jade mirëpriti lajmin edhe pse ai

sugjeroi që numrat duhet të jenë më të larta. "Kanadaja do të përparojë shumë dhe do të rritet sapo të kalojë pragu prej 350 mijë. Megjithatë, ne po dëshmojmë një prirje shumë pozitive", u shpreh ai. Edhe Këshilli Kanadez i Refugjatëve, gjithashtu, mirëpriti lajmet, por donte më shumë, duke thënë se pjesëmarrja për refugjatët u rrit vetëm pak nga 13 për qind këtë vit në 14 për qind në secilin nga tre vitet e ardhshme. Në të kaluarën,

**MINISTRI AHMED HUSSEN**

"Qeveria jonë beson se të sapoardhurit luajnë një rol jetësor në shoqërinë tonë. Pesë milionë kanadezë janë vendosur të dalin në pension deri në vitin 2035 dhe kemi më pak njerëz që punojnë për të mbështetur të moshuarit dhe pensionistët.

ka pasur një shifër për sa shumë do të lejohen emigrantët në vend, por

provincat dhe palët e interesit kanë bërë thirrje për parashikime më të gjata.

**MICHELLE REMPEL**

**KRIKAT MBI PLANIN**

"Kjo nuk është e mjaftueshme për këtë qeveri, që thjesht të paraqesë numrin e njerëzve që po sjellin në këtë vend. Singërisht, liberalët duhet të ndalojnë përdorimin e numrit të refugjatëve, sasinë e parave të shpenzuara në sistemin e imigracionit të Kanadasë. Sistemi i imigracionit duhet të përqendrohet në ndihmën për integrimin e emigrantëve", tha Rempel



**DORY JADE**

**TË RRIET NUMRI**

Drejtori i Përgjithshëm i Shoqatës Kanadeze të Konsulentëve të Imigracionit Profesional, Dory Jade mirëpriti lajmin edhe pse ai sugjeroi që numrat duhet të jenë më të larta. "Kanadaja do të përparojë shumë dhe do të rritet sapo të kalojë pragu prej 350,000. Megjithatë, ne po dëshmojmë një prirje shumë pozitive", u shpreh ai.



**LAURA ALBANESE**

**NDIKIM POZITIV**

Ministria e Emigracionit të Onaturës Laura Albanese, tha se krahina mbështet prezantimin e planeve shumëvjeçare. "Ndryshimet e rëndësishme në nivelet e emigracionit nga viti në vit mund të ndikojnë ndjeshëm në kërkimin e burimeve provinciale nga viti në vit. Një vështrim më afatgjatë do të ndihmonte në planifikimin e niveleve të duhura të shërbimit dhe përdorimit e burimeve", - theksoi Albanese.



Në një deklaratë, ministrja e Emigracionit të Onaturës Laura Albanese, tha se krahina mbështet prezantimin e planeve shumëvjeçare të niveleve për të siguruar më shumë parashikueshmëri për sistemin e emigracionit dhe për të informuar planifikimin e programit. "Ndryshimet e rëndësishme në nivelet e emigracionit nga viti në vit mund të ndikojnë ndjeshëm në kërkimin e burimeve provinciale. Një vështrim më afatgjatë do të ndihmonte në planifikimin e niveleve të duhura të shërbimit dhe përdorimit e burimeve", - theksoi Albanese. Gjatë periudhës së konsultimit të qeverisë, Aleanca Kanadeze për Zgjidhjen e Emigrantëve paraqiti "Vizionin 2020", atë që e quajti një plan trevjeçar "të guximshëm" për të adresuar ndryshimet në rritje demografike që po zhvillohen në vend. Kjo aleancë rekomandoi një objektiv prej 350,000 personash në vitin 2018, i cili arrin në 400,000 në vitin 2019 dhe 450,000 deri në vitin 2020. Ndërsa, Chris Friesen, drejtori i organizatës për shërbimet e shlyerjes, tha se është koha për një letër të bardhë ose komision mbretëror mbi imigracionin për të zhvilluar një qasje gjithëpërfshirëse për emigracionin e ardhshëm. "Asgjë nuk do të ndikojë në këtë vend përveç rritjes së automatizimit dhe teknologjisë sesa vullnetit të imigracionit dhe ky ndikim do të rritet në përgjigje të normës së rënies së numrit të lindjeve, të plakjes së popullsisë dhe pensione të përsheptuara", tha ai për CBC News.

MUAJI I LEXIMIT

"DITAR I SHKURTËR KUFIJSH" NË SHTËPINË KADARE



Fushata kombëtare e leximit, "Takohe mi për një libër" është përfunduar në të gjitha qytetet e vendit qysh në ditët e para të nisjes së saj. Muaji nëntor është shpallur muaji i leximit nga Ministria e Kulturës, por duket se kjo nisje vërtet do të jetë e përditshme. Këtë fakt e ka bërë të ditur nga Gjykostrata, ministrja e Kulturës dhe deputetja Mirela Kumbaro, e cila zbuloi dhe sloganin, i cili do të jetë: "Shëtet se po lexoj" teksa kishte përzgjedhur për të lexuar pjesë nga libri i Gazmend Kapllanit "Ditar i shkurtër kufijsh". "Qëllimi është që të jemi sa më shumë që e ndajmë librin me njëri-tjetrin, ashtu siç bëjmë kur dëgjojmë një muzikë të bukur. Prandaj bashkë me ministrin Bushati iu bashkuam aktivitetit tuaj për të lexuar sot një libër. Vitin që vjen kemi menduar një iniciativë tjetër, e cila do të quhet "shëtet se po lexoj", prandaj përgatituni se do ta kemi të përditshme leximin dhe ndarjen e kënaqësisë që libri dhuron", tha Kumbaro në aktivitetin e zhvilluar në shtëpinë Kadare "Takohe mi për një libër". Ky aktivitet i organizuara këtë fundjavë nga nxënësit e gjimnazit "Asim Zeneli", të cilëve iu bashkuar për të lexuar edhe ministrja e Kulturës, së bashku me ministrin Ditmir Bushati. Fushata "Takohe mi për një libër", është pjesë e programit "Edukimi përmes kulturës", prioritet i qeverisë shqiptare dhe Ministrisë së Kulturës. Fushata do të shtrihet në mbarë vendin përgjatë gjithë muajit nëntor, me mbi 200 aktivitete leximi ku përfshihen shkollat, bibliotekat e rretheve, libraritë, etj. Aktivitetet do të angazhojnë të gjitha hallkat e librit: autorë, përkthyes, botues, redaktorë, mësues, nxënës të studentëve, artistë, etj.

IN MEMORIAM



Një rrëfim nga miku i tij për akademikun Androkli Kostallari, me rastin e 95-vjetorit të lindjes

# Androkli Kostallari

## Akademiku që "unifikoi" gjuhën shqipe

Prof. dr. Remzi Përnska\*

*Përvjetori, të gjitha veprat që la pas e varfëria në të cilën jetoi*

Androkli Kostallari është njëri ndër gjuhëtarët më të shquar shqiptarë të gjysmës së dytë të shekullit të shkuar, që ka lënë gjurmë të pashlyeshme në lartësimin e gjuhës shqipe dhe në ngritjen e gjuhësisë shqiptare në nivelin e vendeve të tjera të Europës Lindore. Student i shkëlqyer i Universitetit "Lomonosov" të Moskës (1949-1954) dhe ndjekës i zhvillimeve në gjuhësinë botërore, ai arriti të kishte një formim teorik të admirueshëm. Njihte shumë mirë gjuhësinë tradicionale dhe rrymat gjuhësore strukturaliste e passtrukturaliste që lulëzonin në Perëndim dhe këto njohuri u përpoq t'ua përcillte studentëve e bashkëpunëtorëve të rinj shkencorë, duke arritur të kishte të brezat e rinj të gjuhëtarëve një ndikim që nuk e ka pasur asnjë gjuhëtar tjetër i brezit të tij. Për gati 40 vjet, që nga viti 1953, kur ishte ende student, e deri më 1991 punoi pa u lodhur duke lënë prapa një veprimtari të pasur botuese, që përfshin fjalorë llojesh të ndryshme, 16 monografi dhe një numër të madh shkrimesh. Vetëm monografitë, referatat e artikujt e tij, të botuara në katër vëllime nga Akademia jonë e Shkencave, arrijnë në shumë se 2 mijë faqe, pa llogaritur këtu leksionet e shkruara universitare e pasuniversitare që ka mbajtur në Tiranë e Prishtinë. Që nga viti 1957, kur u vu në krye të Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë, e deri më 1990, punoi me ngulm për ngritjen e këtij institucioni dhe për organizimin dhe drejtimin e punës shkencore të tij, duke u dalluar si drejtues energjik e i palodhur.

TITUJË E VLERËSIMET

Me themelimin e Akademisë së Shkencave më 1972, Androkli Kostallari u zgjodh akademik dhe anëtar i presidiumit të saj. U dekorua më 1959 me Urdhrin e Punës të Klazit të Dytë për veprimtari të shquar në fushën e shtypit, në vitin 1972 me Urdhrin "Naim Frashëri" të Klazit të Parë për ndihmesa të shquara në fushën e arsimit e të kulturës dhe më 1974 mori Çmimin e Republikës të Shkallës së Parë për veprën



"Drejtshkrimi i gjuhës shqipe". Këtë çmim mori edhe për "Fjalorin e gjuhës së stome shqipe". Për meritën në fushën e arsimit, më 1987 u nderua me titullin e lartë "Mësues i Popullit". Emri i tij u bë i njohur edhe jashtë botës shqiptare. Ai e ka përfaqësuar denjësisht gjuhësinë tonë në botën shkencore europiane. Më 1960 u zgjodh anëtar i Komitetit Ndërkombëtar të Shkencave Onomastike (CIOS), më 1963 u bë anëtar dhe për disa vjet nënkryetar i Komitetit të Studimeve për Europën Juglindore (AIESEE), që edhe anëtar i redaksisë së "Atlasit të Gjuhëve të Europës". Për punën e tij në fushën e teorisë së gjuhës letrare, Universiteti i Goteborgut (Suedi) i ka dhënë titullin Doctor honoris causa në shkencat filologjike dhe Magjistër i arteve të lira. Me gjithë këto merita, Androkli Kostallari mbeti një njeri tepër modest, që kurrë nuk u mburr dhe as i shfrytëzoi këto merita për qëllime vetjake. Jetoi thjesht dhe jo pa shqetësime e privacione, për shkak të mjeteve monetare të pamjaftueshme për të mbajtur familjen dhe të mungesës së kushteve për punë në shtëpi. Megjithatë,



Në foto: Androkli Kostallari

pasur, por deri atëherë pothuajse e pastudiuar. Ai ishte i bindur se gjuha shqipe i ka të gjitha mundësitë për të përbëlluar, me mjetet e veta, nevojat e shprehjes në të gjitha fushat e veprimtarisë ligjërimore. Pastërtia e leksikut të gjuhës së shkruar nëpërmjet krijimeve të reja e, sidomos, nëpërmjet aktivizimit të fjalëve shqipe nga leksiku popullor, ka qenë njëri nga qëllimet kryesore të punës së tij shkencore. Ai përgatiti një përthamë leksikografesh, që do të bëheshin bashkautorë të "Fjalorit të gjuhës së stome shqipe" (1980) me 41 mijë fjalë, fjalori më i madh shpjegues i gjuhës shqipe i hartuar deri më sot. Ky fjalor, që u udhëhoq në çdo fazë të tij nga A. Kostallari përmben arritjen më madhore të leksikografisë shqiptare. Ai që edhe bashkautor i një fjalori të vogël shqipërisht (të botuar më 1951, kur ishte ende student) dhe redaktor i të parit fjalor rusisht-shqip me 25 mijë fjalë. Një aspekt tjetër në këtë fushë



këto nuk e penguan të punonte pa u lodhur dhe të ndërtonte marrëdhënie korrekte pune e shogjore. Nuk la cep të Shqipërisë pa shkelur në kërkim të fjalës së rrallë ose në veprimtari shkencore, prandaj nuk kishte njeri që të mos e njhte, ashtu si ai i njhte me emër mësuesit e përkushtuar të gjuhës shqipe që përpqeshin të mblidhnin fjalë të reja ose të merreshin me punë shkencore. Fushat kryesore të veprimtarisë shkencore dhe pedagogjike të tij qenë leksikologjia e leksikografia, fjalëformimi, onomastika, gjuhësia e përgjithshme dhe teoria e gjuhës letrare. Po vendin e kreut në këtë veprimtari e zënë studentet për fjalëformimin, ku spikatim monografitë e punimet për fjalët e përbëra në gjuhën shqipe, një kategori fjalësh me të cilat gjuha jonë është shumë e

që edhe puna si bashkautor në hartimin e mbi 30 fjalorëve terminologjike shqip-gjuhë të huaja, me të cilët shqipes iu zgjerua frymëmarrja edhe në fushë të terminologjisë. Fushë e rëndësishme e veprimtarisë shkencore të Androkli Kostallariit ka qenë edhe historia e formimit dhe zhvillimit të gjuhës letrare shqipe si dhe veçoritë ndërtimore e funksionale të saj, të cilat i ka trajtuar në një varg studimesh, që mbeten model i analizës shkencore. Mori pjesë në komisionin hartues të "Ortografisë së gjuhës shqipe" (1956), kryesoi komisionin hartues të "Rregullave të drejtshkrimit të shqipes" (Projekt, 1976); ishte kryetar i komisionit organizues të Kongresit të Drejtshkrimit (1972), ku mbajti referatin kryesor; kryesoi komisionin për hartimin e "Drejtsh-





**GJUHËTARI**  
Mori pjesë në komisionin hartues të "Ortografisë së gjuhës shqipe" (1956), kryesoi komisionin hartues të "Rregullave të drejtshkrimit të shqipes" (projekt, 1976); ishte kryetar i komisionit organizues të Kongresit të Drejtshkrimit (1972), ku mbajti referatin kryesor; kryesoi komisionin për hartimin e "Drejtshkrimit të gjuhës shqipe" (1973), të "Fjalorit drejtshkrimor" (1976) dhe të doracakëve të tjerë normativë.

← krimin të gjuhës shqipe" (1973), të "Fjalorit drejtshkrimor" (1976) dhe të doracakëve të tjerë normativë.

**DREJTSHKRIMI**

Ndihmesa e A. Kostallarit për trajtimin e problemeve të mëdha të gjuhës letrare, e lidhur me të, edhe të drejtshkrimit ka qenë jo vetëm orientuese, por edhe vendimtare. Puna që ka bërë për të shtruar e mbrojtur tezat teorike për formimin e gjuhës letrare shqipe është sintetizuar jo vetëm në shkrime të botuara në shtypin tonë shkencor, por edhe në referatet përgjithëse të mbajtura në kongrese e konferenca shkencore. Në to, përkrahoi teorikisht fazat e formimit dhe të zhvillimit të gjuhës letrare kombëtare; vuri në pah faktorët gjuhësorë dhe historiko-shoqërorë që përcaktuan rrugën e ndjekur prej saj; mbrojti tezën se ajo u formua si një koine letrare, dmth, si rrjedhim i bashkëveprimit midis traditave letrare, se ajo ka një sistem të vetin mbidialektor me elemente të përbashkëta për të dy dialektet dhe elemente të veçanta të tyre; se në fonetikë dhe morfologji mbizotërojnë elementet jugore të ndërthurura me tipare të rëndësishme të dialektit verior; se gjuha letrare e njësuar kombëtare nuk është shndërrim i drejtpërdrejtë i ndonjë varianti letrar në gjuhë letrare të njësuar, por është sistem ku janë shkrirë elemente të përbashkëta e të veçanta nga të dyja dialektet.

Teza e tij për shqipen standarde si koine letrare, sidomos pas vitit 1990 është bërë objekt kritikash të shumta. Por kritikja e parë e kësaj teze, gjuhëtarja amerikane Xh. Bajron, e cila e vlerëson lart punën e tij për planifikimin gjuhësor të shqipes dhe krijimin e gjuhës letrare të njësuar e sheh si rezultat të përpjekjes së popullsisë shqiptare në ish-Jugosllavi për të riafirmuar identifikimin e tyre etnik me vendin amë duke përvetësuar dialektin standard të tij, e justifikon kështu pikëpamjen e Kostallarit:

"Funksioni më i rëndësishëm i shqipes standarde duket se është ai i unifikimit të një popullate të ndryshme nga ana dialektore. Për mendimin tonë, rëndësia e këtij funksioni është kaq e madhe, sa që ndikon edhe në interpretimin e asaj se çfarë është gjuha standarde: format e saj të përbashkëta dialektore janë mbicmuar (kryesisht nga Kostallari), ndër-sa roli i rëndësishëm i dialektit bazë (toskërishtes) është minimizuar".


Androkli Kostallari spikat edhe si organizues e drejtues i talentuar në të gjitha detyrat që ka kryer - përgjegjës sektori, dekan, drejtor i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, anëtar redaksish e komisionesh - duke u shquar për mendimet novatore e zgjidhjet konkrete që propozonte. Thelbin e aftësi të tij organizuese dhe drejtuese e përbën kyçja në probleme të mprehta që kërkonin zgjidhje shkencore, si nxjerrja e disa revistave e përmbledhjeve shkencore, hartimi i fjalorëve dhe i veprave të tjera themelore për gjuhën shqipe, krijimi i komisioneve dhe i redaksive cilësore. Në mënyrë të veçantë, roli i tij drejtues e organizues ka qenë dukshëm përcaktues në veprimtarinë e mëdha shkencore kombëtare e ndërkombëtare, si Kongresi i Drejtshkrimit e konferencat ndërkombëtare brenda vendit dhe në kongrese e konferenca jashtë vendit - ballkanike, europiane e ndërkombëtare - në të cilat ka përfaqësuar me dinjitet, bashkë me kolegë të tjerë të shquar, shkencën shqiptare.

Androkli Kostallari u shqua edhe si frymëzues, organizues dhe drejtues aksionesh shkencore me përmasa të mëdha. Këto aksione u shtrinë në të gjitha trevat e shqipes dhe sollën lëndë të bollshme e të gjallë faktike leksikore e frazeologjike, e cila jo vetëm u mblodh, por edhe u sistemoi e u klasifikua në kartotekën e leksikut të shqipes me rreth 4 milionë skeda me 150 mijë fjalë, lëndë pa të cilën nuk do të ishte i mundur hartimi i fjalorëve shpjegues (1980, 1984); kurse kartoteka e gramatikës u pasurua me mbi 2 milionë skeda.

Kur drejtoi Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, gjuhësisë shqiptare arriti kulmin e zhvillimit duke bërë që epigendra e studimeve albanologjike nga jashtë trojeve shqiptare të vinte në vendin e vet natyror, në Shqipëri dhe të normëzohej thauja plotësisht leksiku dhe sistemi gramatikor të gjuhës sonë, çka do t'i hapte rrugë dhe do ta lehtësonte sanksionimin e një gjuhe të përbashkët kombëtare shqiptare, që e radhiti kombin shqiptar ndër kombet e qytetëruara. Me veprën e vet shumëpërmasëshe dhe me personalitetin e vet shkencor, prof. Androkli Kostallari ka zënë vend nderi në gjuhësinë shqiptare, krahas figurave të shquara, si A. Xhuvani, E. Çabej, K. Cipoja, M. Domi, S. Riza, Sh. Demiraj, I. Ajeti, Ali Hadri, Kristo Frashëri etj., pa të cilët s'do të kishte bërë atë që bëri. Për meritat e tij organizuese e drejtuese, pëll lartësimin e shqipes në shkallën e gjuhës letrare të përbashkët, Androkli Kostallari meriton që mbi gurvarrin e tij të gdhenden fjalët: "Kombi të është mirënjohës".

**Titulli është i redaksisë**

**"ALLE DA!", TË GJITHË SË BASHKU, NJË HISTORI EMIGRIMI**



Në foto: Kopertina e librit

vështirë integrimin në jetën e njëri tjetrit, sidomos ku vijmë nga kultura të ndryshme! Libri të mban të mbërthyer deri në fund të historisë dhe shkruar me gjuhë të thjeshtë e me humor. Komunikimi ndihmohet nga ilustrimet plot fantazi. Por të gjitha së bashku, gjuha e tekstit dhe ilustrimet, të ushqejnë me mendime dhe informacion të këndshëm falë tekstit të Anja Tuckermann dhe ilustrimeve të Tine Schulz. Libri u përkthye në shqip nga Eljana Mankollari. Redaktimi dhe kujdesin në botim u krye nga Silvana Leka, si pjesë e Botimet "Poeteka", 2017

**PËRMBAJTJA**

Në të gjithë vijnë nga diku tjetër. Në qoftë se kthehemi pas në kohë dhe në histori, mësojmë se kemi ardhur nga larg. Samira erdhi me një anije që u nis nga Afrika dhe një kamion. Amadit u mungojnë shokët e futbollit që kishte në Irak, por për shkak të luftës, ai duhej të largohej nga vendi i tij. Tani ai shënon gola me miqtë e rinj në Düsseldorf. Dilara ka lindur në Berlin, por flet rrjedhshëm turqisht dhe pëlen që festojë "festivalin e sheqerit". Familja e saj erdhi vite më parë nga Anadoli, sepse në Gjermani kishte më shumë mundësi për të gjetur punë. Tani ne jetojmë të gjithë së bashku, në të njëjtin vend. Kjo mund të jetë emocionuese, por nganjëherë kjo është edhe e vështirë. Sidoqoftë, jeta bëhet me e gjallë kur njerëzit nga të katërta anët e botës dhe të gjitha sferat e jetës bashkohen. Të gjithë së bashku, pra! Alle da!

jeje. Libri është tërheqës dhe gjithëpërfshirës në lexim. Ai vërtet u drejtohet fëmijëve dhe adoleshentëve të moshave shkollore dhe është konceptuar për t'u lexuar edhe në klasa, me grupe, por ai është një ftesë për t'u lexuar bashkë me prindërit, në shtëpi, pasi jep kënaqësi në lexim dhe këshilla të shkëlqyera rreth temës së mirëkuptimit, bashkëjetesës dhe tolerancës. Përveç kësaj, libri jap informacion mbi gjeografinë e vendeve, mbi historinë e shteteve, të cilat vijnë jo si leksion, por përmes rrëfimit të personazheve. Përmes ndodhjeve të disa fëmijëve të ardhur nga skaje të ndryshme të botës, ky libër na ndihmon të kuptojmë çfarë kanë të përbashkët mesiv tyre njerëzit dhe çfarë i bën ata të ndryshëm, si lindin dhe çfarë i mban gjallë paragjykimet, çfarë na e bën të

**EKSPERIMENTI KOMUNIST, BULGAKOV NË SKENËN SHQIPTARE**

Kolektiv 38" shfaq premierën "Djallëzorët" në KTKEKS, një shfaqje që reflekton mbi figurën e Bulgakovit. 8 regjisorët Madi Selimi, Valentina Carbonara, Rolando Macrini, Elio Colassanto, Riccardo Mallus, Ashai Lombardo, Mirko Corradini, Silvia Zofoli realizojnë një veper të përbashkët, një kolektiv me ideologji të ndryshme, për të përcjellë këshitu frymën bashkëpunuese. Në një kohë ku artisti përpiqet të luftojë i vetëm, "Kolektiv 38" sjell mesazhin teatror "ne përpiqemi të jemi një grup dhe së bashku të krijojmë aleancë". Kjo shfaqje mbështetet nga Ministria e Kulturës. Shfaqja "Djallëzorët" reflekton mbi figurën e Bulgakovit, (shkrimtar rus) i censuruar dhe i botuar vetëm 30 vitet e fundit, si dhe mbi formimin e komunizmit në Rusi e më pas në Shqipëri. Nëpërmjet shfaqjes teatore, ngrihen reflektime mbi 70 vjet komunizëm (1917-1989) të cilat nëpërmjet ideologjive filozofike kanë shokuar botën. Bulgakov është një ndër të shumtët poet rusë "i censuruar", që shkruan mbi "eksperimentin komunist" duke i kthyer historitë e tij në metafora dhe simbolika. Midis viteve 1924-1925, ai shkruan tri tregime të gjata "Djallëzorët", "Vezët fatale" dhe "Zemra e qenit". Të tria tregimet përshkruajnë "eksperimentin komunist" (sieg e quan Bulgakov) në mënyrë

simbolike burokratike, të mbushura me makina-cione të shtrembëruara dhe të shëmtuara. Ai ironizon dhe e kthen këtë në satirë. Djallëzorët, bashkë me "Vezët fatale" dhe "Zemra e qenit" është një nga tri tregimet, të cilat përbëjnë kryevepra të trozës satirike sovjetike. Këto tri tekste përfaqësojnë "Trilogjinë e heshtjes së kuqe" dhe "Djallëzorët" është spektakli i parë si dhe studimi i parë i "Kolektiv 38". Në "Djallëzorët" Korotkov është në një univers burokratik të pafund, zvarritës plot dhoma, korridore, ndërtesa shumëkatëshe, burra që shfaqen dhe zhduken, dokumente të pafundme, emra që transformohen. Revolucioni, utopia është një bionde krenare, e bukur e veshur me taka të kuqe ku tregon historinë e saj. Ky mekanizëm funksionon. Në skenë mbrapa saj katër qenie njerëzore, të gjithë të barabartë, padyshim viktimat e dhunës së pushtetit. E vetmja mënyrë për të shpëtuar veten është të mos jesh protagonist i historisë që po tregohet. Ata janë të gjithë Korotkov. Revolucioni vazhdon historinë

e saj gjithnjë e më groteske. Por, qenia njerëzore ende ka një shans, një akt liric për të shpëtuar nga i gjithë ky sistem. Dhe është këtu ku Revolucioni nuk bën dot më. Dështon. Shfaqja vjen në skenë në datat 9 dhe 10 nëntor 2017, ora 19:00 në TKEKS.

**Regjia: Kolektiv 38**

**DJALLËZORËT**  
MICHAIL AFANAS'EVICH BULGAKOV

Perktheu : Madi Selimi

Aktorë:

- MARJANA KONDI
- ERMELA RURI
- ANDERSON GURRA
- ARJON MAMAJ
- ANA KUQO

Producent : Soni Karamani  
Kostumograf: Sofi Kara

Opinion i Ditës

# Mbi tri data që ndryshuan historinë

Nga dr. Jorgji KOTE


(Vijon nga faja e parë)

... i Madh Socialist i Tetorit përmbysi kapitalizmin në 1/6 e globit. Moska u bë për një kohë të gjatë "Meka" e komunizmit dhe vend pellingrinazi për mijëra njerëz të thjeshtë, politikanë dhe artistë planetarë me emra tingëlues. Shumica prej tyre u kthyen me pesimizëm, por zhgënjimi më i madh do të vinte më vonë, kur në vend të barazisë dhe një jete më të mirë u përmbyu gjithçka dhe vendi u përgjak nga dhuna, ekzekutimet masive, internimet dhe skamja e papërshkruar për dhjetëra miliona.

Ka dhe analistë dhe ekspertë që nënvizojnë se ai revolucion nisi mbrapsht, si zbatim i Manifestit Komunist nisi mbrapsht, sepse, sipas Marksit, që e bënë pa të drejtë Profet, se vetëm i tillë nuk mund të ishte, revolucioni socialist mund të shpërthente njëherazi vetëm në disa vende të zhvilluara kapitaliste, si në Angli, Francë apo Gjermani. Madje, Raoul Peck, producent i njohur kinematografik që ka studiuar Marksit për 4 vjet në Universitetin Humboldt në Berlin, pohon se "po të ishte gjallë, ai do të ishte i pari që do të puskatohej nga bolshevikët".

Ishte Lenini që "pasuroi" doktrinën e Marksit me tezën se revolucioni mund të triumfojë dhe në një vend të vetëm, të madh dhe të prapambetur si Rusia". Do thënë se bolshevikët shfrytëzuan mjeshtrërisht krizën e rëndë në Rusi, disfatën e saj ushtarake në Luftën e Parë Botërore, gabimet e Carit, të qeverisë së përkohshme të asaj kohe dhe faktorë të tjerë. Ish-Bashkimi Sovjetik tentoi ta eksportonte revolucionin bolshevik në shumë vende të Evropës, duke filluar nga Gjermania. Gjithsesi, do të ishte fitorja ndaj nazizmit gjerman, bashkë me SHBA-në, Britaninë e Madhe dhe popujt liridashës që mundësoi Stalinin dhe ish-BS të shtrinte kthetrat e sundonte gjysmën e Evropës, krahas vendeve të tjera si në Kinë e jetkë.

Në Shqipëri, revolucionin bolshevik "erdhi" më 8 Nëntor 1941, me krijimin e PKSH-së në Tiranë. Ashtu si në rastin e bolshevikëve rusë, komunistët shqiptarë veç të tjerash përfituan shumë nga gabimet e kundërshtarëve politikë dhe mbështetja e aleatëve perëndimorë. Dihet tashmë se si regjimi komunist i Tiranës zbatoi një vijë shumë më të ashpër se "mësuesit e saj". Përditë dalin fakte dhe të dhëna të reja, që tregojnë egërsinë e pajustificueshme të atij regjimi, ndjekjen, persekutimin dhe ekzekutimet e shumta për një vend të vogël si i yni. "Tirana e Kuqe" shkoi dhe më larg, duke pretenduar të bëhej "vendi i vetëm i vërtetë dhe fanar i socializmit në botë". Veç të tjerash, ajo u nda për arsye ideologjike nga aleatët e saj të mëdhenj, BS dhe Kina, u "ftoh" me të ashtuqajturat "vende revolucioniste lindore" mohoi ndihmat dhe kreditë e huaja, duke e mbyllur vendin në një vetrrethim absurd me pasoja tragjike.



Dihet se si ish-BS-ja përdori të gjitha mënyrat dhe metodat për të mbajtur në këmbë sistemin socialist në ish-BS dhe në vendet "satelite"-bllokada ekonomike, presione e shantazhe ushtarake, pushime të tipit fashist, me topa, tanke dhe qindra-mijëra ushtarëve sovjetikë dhe së fundi me Murin e Berlinit, këtë megaimpiant absurd të ndarjes dhe izolimit.

Për fat të mirë, komunizmi nuk e pati jetën e gjatë. Nuk ishte thjesht koincidenca historike që në një ditë tjetër të shënuar, më 9 Nëntor 1989 shembja emblematike e Murit të Berlinit ribashkoi Gjermaninë dhe bashkë me të gjithë Evropën; kjo ditë shënoi dhe procesin përfundimtar të rrëzimit të regjimeve totalitare në Evropën Qendrore dhe Lindore.

Në Shqipëri, Muri i Berlinit ra pak më vonë, më 8 Dhjetor 1990, me njohjen e pluralizmit politik dhe ekonomisë së tregut.

Arritjet gjatë 27 vjetëve të fundit kudo në Evropë janë të njohura, të shumta dhe të pamohueshme, sidomos në fushën e integritimit Eruro-Atlantik. Por, siç po vihet me të drejtë në dukje nga shumë ekspertë dhe analistë, edhe zhgënjimi nuk është i vogël. Sepse Evropa është ende larg entuziazmit dhe frymëzimit që shkaktoi ai 9 Nëntor.

Kështu, Gjermania e bashkuar

vërtet është kampione e demokracisë dhe "lokomotivë" e ekonomisë botërore, por, pjesa e saj lindore është ende shumë larg afrimit me nivelet sociale-ekonomike të pjesës tjetër. Sipas disa sondazheve të fundit në Gjermani, shumica e popullsisë në landet lindore pohon se rënia e Murit të Berlinit ishte që e mirë; megjithatë, sipas tyre, atëherë jetohej më mirë. Nuk është rastësi që në të gjashtë landet lindore prej kohësh qeverisin bashkë me social-demokratët "Të majtët" e ish-Partisë Komuniste; ndërsa në zgjedhjet parlamentare të muajit shtator, për herë të parë në 70 vjetët e fundit hyri në Bundestagun gjerman me 98 deputetë Partia ekstremiste Aleanca për Gjermaninë. (AFD)

Duke shkuar pak më tej, katër vende të ish-blokut komunist, të cilat kanë qenë në pararojë të shembjes së mureve ndarëse dhe aderimit në BE, tashmë po krijojnë "Bllokun populist" brenda BE-së, së bashku me forca të tjera ekstremiste në disa vende perëndimore. "Perdja e hekurt" dhe komunizmi janë zëvendësuar tashmë me plot "izma" të tjerë po aq, në mos më të rrezikshëm - populizmi, nacionalizmi, ekstremizmi, separatizmi, fundamentalizmi, terrorizmi, racizmi, etj. Rendi dhe siguria në botë po kërcënohen dita-ditës nga dhjetëra kriza të shumta financiare, luftëra

rajonale, krizat e azilit, sulmet terroriste, demonstrimet e forcës duke përfshirë dhe atë bërthamore; papunësia, sidomos të rinia, varfëria ekstreme, dhuna, shtrëngimet e vazhdueshme financiare ose austeriteti, siç njihet, e kanë bërë jetën më të pasigurt dhe kanë shtuar ndjeshëm pabarazinë shoqërore.

Vetë BE-ja është tronditur rëndë nga disa kriza, së fundi ajo e Brexit dhe po mundohet të reformohet e të mbrojë identitetin e saj, që të mos ketë fatin e perandorive të mëparshme; ndryshe nga entuziazmi i disa viteve më parë, ajo po ndeshet me një lodhje të dyfishtë e me pasoja - vendet anëtare nga zgjerimi kurse ato kandidatë nga padurimi.

Këto dukuri dhe fenomene shihen më qartë edhe në vendin tonë, duke zbehur jo pak mjaft hapa dhe arritjet pozitive në të gjitha këto fusha. Katalogu ynë i ri "demokratik" është plot sfida dhe pengesa të tjera serioze, si krimi i organizuar, korrupsioni galopant, kërcënimet ndaj rendit dhe sigurisë, dhuna në familje, kanabizimi dhe së fundi, por më i rëndësishëm, mungesa e drejtësisë. Pjalët e reja në fjalorin tonë të përditshëm si dekriminalizimi, vetingu, etj. janë dëshmia më e qartë e dështimit të këtij komponenti përcaktues të demokracisë.

Më tej, dihet se dyndja e mijëra shqiptarëve drejt ambasadave për azil më 2 korrik 1990 e më vonë, u bë paralajmëtar i shembjes së diktaturës së fundit në Evropë. Por, ç'mund ta thuash këto vitet e fundit kur kjo dukuri ka marrë përpjesëtime shumë më të mëdha e të frikshme, duke shkaktuar brenga, dyshime dhe shqetësime serioze dhe te partnerët tanë evropianë?

Problematicës së lartpërmendur i shtohen me të drejtë edhe disa "punë të pambaruara", lidhur me pasojat që la sistemi monist në vendin tonë, si hapja e dosjeve, dëmshpërblimet, pronat, etj. të cilat vendet e tjera i kanë përfunduar këtu e dy dekada më parë. Ka disa institute dhe agjenci si dhe shkrimtarë që vazhdojnë të merren aktivisht me evokimin e asaj të kaluarë, duke dhënë një ndihmesë të jashtëzakonshme me krijimet, konstatimet dhe rekomandimet e tyre të dobishme. Por, krahas tyre, në jo pak raste, edhe pse totalitarizmi i kuq ka gati tri dekada që ka vdekur, sërish vërehet prirja për ta bërë njohjen apo dhe denoncimin e saj si qëllim në vetvete, duke nxirë, diabolizuar dhe mohuar edhe dukuritë pozitive; këto të fundit, fryt i punës dhe mundit të njerëzve të thjeshtë. Kur përvoja e përparuar tregon se përparësia në këtë fushë i takon gjetjes së rrugëve për të mos përsëritur fajet dhe mëkatet e të kaluarës diktatoriale. Sepse demokracia është shumë më komplekse dhe shkon shumë më larg se anti-komunizmi apo dhe anti-fashizmi. Ndaj, nuk ka pse të habitemi dhe të fajësojmë të tjerët, ca më pak BE-në, që ende nuk kemi çelur bisedimet për anëtarësimin tonë BE.

Ja pse këto tri data janë kujtesë dhe apel për reflektim dhe vepërime të guximshme, për t'u distancuar nga përvoja dhe trashëgimia negative e 7-8 Nëntorit dhe për të realizuar ëndrrat dhe ideat emblematike të 9 Nëntorit 1989.

**P**aradise Papers", një projekt i përbashkët i disa mediave të njohura botërore dhe konsorciumit ndërkombëtar të gazetarëve investigativë, publikoi dje disa të dhëna lidhur me hetimet jashtë Shteteve të Bashkuara mbi aktivitetin e krerëve të shteteve dhe shumë figurave të njohura politike dhe nga fusha të tjera që mund të kenë transferuar para në paraiza fiskale me qëllim për të shmangur taksat.

Hollësitë e këtyre aktiviteve dolën pas nxjerrjes së rreth 7 milionë dokumenteve nga Appleby, një firmë juridike, që i kështillon kompanitë e fuqishme dhe elitat e pasura lidhur me disa transakcione për t'u shmangur taksave në vendet e tyre.

Projekti ekspozon investime prej miliona dollarësh të Mbretëreshës së Anglisë, të anëtarëve të kabinetit të ministratës Trump dhe të administratës së kryeministrit kanadez, dhe tregon, gjithashtu, se si kompanitë "Twitter" dhe "Facebook" sigurojnë qindra miliona dollarë në investime →



Opinioni i Ditës

Nga Bardh Spahia

(Vijon nga faqja e parë)

... apo indiferent ndaj politikës, nëse do të pyetjet sot se cili është problemi më i madh i tij dhe i familjes së tij, do të thoshte fillimisht se ishte varfëria. Kështu ngjan se do të thotë edhe nesër.

Normalisht, varfëria dhe përpjekja për ta zbutur atë, do të duhej të ishte një nga synimet kryesore të qeverisë shqiptare. Dhe ditët e hartimit dhe diskutimit të buxhetit do të duhej të ishin ditë shumë të rëndësishme, kur si në një familje të madhe, të diskutohet se çfarë do të bëhet me të ardhurat e familjes. Si janë fituar dhe si janë shpenzuar. Gjetkë, në demokraci të konsoliduara, është pikërisht kështu dhe qeveritë janë kujdestare të parave publike. Në Shqipëri është ndryshe. Për disa arsye.

E para, sepse ai që do të duhej të ishte njëri i përgjegjshëm, është sjellë dhe po silltet si njeri i lig.

E dyta, sepse shpenzimet nuk shkojnë ashtu siç do të duhej të bëhej për arsimin, shëndetësinë, për ndërhyrje në infrastrukturë dhe në përgjithësi, për orientimin e ekonomisë shqiptare drejt një strukture të shëndetshme dhe konkurruese, por shkojnë kryesisht në kozmetikë, 'make up' dhe në xhepat e ca klientëve të lidhur me këtë qeveri.

Shqiptarët thonë duam punë, Edi Rama, e pas tij i gjithë shteti i tij virtual që ka ngritur, ju jep fasada. Shqiptarët kërkojnë dinjitet për bukën e tyre të përditshme, Edi Rama, e pas tij gjithë edushkat socialistë vrapojnë t'i japin fjalime. Por edhe varfëria durohet. Kur ka shpresë dhe kur ka seri-ozitet për të ndryshuar, kur ka besim dhe mendim të qartë, pritja që varfëria të zbutet, që punësimi të shtohet, që ekonomia të forcohet,

# Nga çunat e Ramës e Tahirit, te zotërinjtë e drogës



është më e lehtë. Në Shqipëri nuk jemi në asnjë prej këtyre rasteve dhe varfëria bëhet më e rëndë dhe e nesërma bëhet edhe më e zymtë. Sepse përtej shifrave të ekonomisë, gjithë vendi është shndërruar në një skenë krimi.

Duke nisur me Parlamentin që nuk përfaqëson vullnetin e qytetarit shqiptar. Ai dëshmon imponimin e parave të kimit dhe të drogës në 25 qershor dhe qeverisjen me imponim të një segmenti gjithmonë e më të kriminalizuar në PS.

Duam të gjejmë autorësinë e krimi? Mjafton të ndjekim gjurmët e lekëve dhe do të shohim se ku do të përfundojnë lekët e dhëna për shëndetësinë dhe do të gjejmë lehtësisht emrat e klientëve të pushtetit. Po të shohim fondet e akorduara për Shkodrën, këtë

kryeqendër të Shqipërisë, do të dallojmë urrejtjen e kësaj mazhorance jo vetëm për shkodranin, por edhe hakmarrjen e saj të ulët ndaj tij. Një hakmarrje primitive prej një mendësie po primitive.

Shqipëria është një skenë gjigante krimi, sepse nga veriu në jug, vendi u mboll me kanabis. Se qindra tonelata të kapura, kryesisht në Italinë dhe Greqinë fqinje, dëshmojnë për qindra tonelata të tjera që kanë kaluar dhe male të tërë që presin ende të kalojnë kufirin.

Duke prodhuar qindra milionë euro para të zeza, të cilat nesër do të përdoren sërisht për të blerë pushtet, për të paguar fasadat e Ramës dhe fjalimet e tij.

Qeveria flet për paratë me lehtësinë e atyre që i zhvendosin eurot me thasë dhe i numërojnë ato

duke i peshuar. Dhe kjo është një nga arsyet se pse kjo mazhorancë ka rënë që kur rierdhi në pushtet. Sepse rierdhi me krimin. Ka legjitimitetin e shifrave, por jo atë moral dhe politik. Dhe tani është delegitimuar edhe penalisht. Saimiri është vetëm një emër që dëshmon sesa i keq do të jetë fati juaj.

Socialistët e mbrojtën ish-ministrin e tyre, jo sepse e donin Saimirin, por sepse dhanë votën drejtësisë dhe i dhanë imunitet kryeministrit, ish-ministrave të tjerë dhe ministrave aktualë. Megjithatë, dorëzimi i tyre përpara drejtësisë do të ndodhë herët a vonë. Është çështje kohe.

Dhe do të dorëzohen të gjithë njëri pas tjetrit. Ashtu siç u dorëzuan ish-deputetë dhe kryetarë bashkish. Siç u dorëzua kjo mazhorancë përpara të vërtetës së frikshme se mbolli Shqipërinë me turp dhe kanabis.

Autori është Edi Rama. Ai është i akuzuari kryesor i kësaj kohe. Si kreu i grupit. Si drejtuesi i tij. Si frymëzues, si përgjegjës dhe si fajtor i parë ndër fajtorët që e shndërruan vendin në një hambar droge dhe shqiptarët në mëditës për kultivim droge. Dysjha Rama-Tahiri ishte simboli i qeverisjes së djeshme, i çunave të policisë, që në shumë raste u shndërruan në zotërinjtë e drogës. Dysjha ishte simboli i banditëve të rrugës, që u shndërruan në klientët dhe pronarët e politikës së majtë dhe i gjithë politikës së majtë që u bë peng i drogës dhe krimi. Pa ditur se ku niste njëra dhe ku përfundonte tjetra. Në një bashkëlidhje e bashkëqeverisje të pandarë mes krimi, që jepte vota dhe pushtet, i cili më pas, me votë dhe pushtet i jepte imunitet krimi.

**HOROSKOPI**

**DASHI**  
Përpicuri të vendosni regull në jetën tuaj, si në nivelin fizik, ashtu edhe në atë mendor, nëse nuk dëshironi të krijoni konfuzion, gjë që nuk ju pëlqen aspak. Përdorni kohën e lirë që do të kenë në dispozicion për të organizuar me mirë hapësirën, ndoshta duke ndryshuar diçka.

**DEMI**  
Krijoni miqësi edhe kur gjendeni para opinionëve dhe pozicioneve të ndryshme. Bashkëprimi i Jupiterit me Saturnin do t'ju ndihmojë të zgjeroni rrethin e njohjeve tuaja. Në shumëllojshmërinë natyrale do të zbuloni një tërësi që do të arrijë t'ju pasurojë shumë.

**BINJAKET**  
Do të arrini më në fund të hidhni pas kraheve një çështje të së kaluarës që ju pengon të shihni përpara, sidomos në jetën private. Do të ndeheni shumë më mirë. Nuk jeni më të gatshëm të toleroni gjëra që nuk ju pëlqejnë dhe të tjerët do ta kuptojnë vendosmërinë tuaj.

**GAFORJA**  
Mos lejoni asgjë dhe asnjëri që t'ju shkatërojnë planet tuaja, edhe pse e keni planifikuar programin e të ditës me shumë kujdes. Çdo detaj është i rëndësishëm dhe ju nuk ia lini lënë asgjë rastësisë.

**LUANI**  
Nga njëherë nuk dini si të menaxhoni një lloj tendence që keni për t'u dekurajuar shpejt. U kthehni mendimeve negative që nuk kanë arsye të ekzistojnë. Përfiton nga kjo ditë e qetë që të qetësoheni disi nga të gjithë gjërat që ju rëndojnë pak.

**VIRGJERESHA**  
Në këtë periudhë mund të jepni maksimumin në sportin tuaj të preferuar. Aktiviteti fizik i moderuar është shumë i shëndetshëm, jeni shumë mirë. Do të keni një ditë të gëzueshme dhe kohë e lirë e çmuar, për t'ua përkushtuar të tjerëve, por sigurisht edhe pak vetes.

**PESHORJA**  
Një çështje pune rrezikon t'ju prishë disi ditën. Nëse nuk është aq urgjente, tregohuni të vendosur që ta mbani jashtë portës. Do ta zgjidhni nesër. Momente të këndshme të kaluar në familje dhe me miq do t'ju kthejnë humorin e mirë.

**AKREPI**  
Gjatë ditës së sotme të tjerët do t'ju ndihmojnë në punët e shtëpisë, kështu që do arrini të keni pak kohë të lirë për vetë. Jeni gjithmonë të gatshëm të ndihmoni të tjerët dhe asnjëri nuk do refuzojë t'ju japë një ndihmë të vogël, nëse ia kërkon ju.

**SHIGJETARI**  
Plutoni që nuk ju favorizon mund t'ju shkaktojë të bëni regjime të papritura e të tepruara, edhe për motive banale dhe me pak rëndësi. Shkarkoni tensionin e krijuar duke u marrë me pak sport. Lodhja në nivelin fizik do ju qetësojë në profilin mendor.

**BRICJAPI**  
Dita e sotme do të jetë një ditë e përkryer për të kaluar kohë me të afërmit tuaj dhe miqtë. Nuk ka rëndësi nëse e kaloni në shtëpi apo jashtë. A do të ketë vendime të rëndësishme për t'ua marrë? Falë bonsensit tuaj, nuk do të lini t'ju shpëtojë asnjë detaj.

**UJORI**  
Duke qenë se duhet të analizoni një situatë, duhet të merrni parasysh më shumë se një aspekt, nëse nuk doni të humbini një gjë shumë të rëndësishme. Keni atësi të shkëlqyera, por që njanjëherë mbeten në hije nga nxitimi juaj për të përfunduar çdo gjë.

**PESHQIT**  
Bashkëprimi i Saturnit, Uranit dhe Plutoni ju mbështesin, do t'ju dhurojnë një ditë të paharueshme, në të gjitha aspektet. Është e sigurt që nuk do të mërziteni dhe do jeni gjithmonë në mes të aktiviteteve interesante dhe personale intrigues.

Dje në "Zëri i Amerikës"

# "Paradise Papers" - politikanët dhe parajsa fiskale

← nga institucione financiare të shtetit rus.

Në mesin e tyre është emri i sekretarit amerikan i Tregtisë Wilbur Ross, për të cilin dokumentet tregojnë se ka lidhje të rëndësishme biznesi në Rusi me dhëndërrin e Presidentit rus Vladimir Putin dhe me një oligark, ndaj të cilit janë vënë sanksione nga Shtetet e Bashkuara.

Në dokumentet e rrjedhura të "Paradise Papers", sekretari Ross, një industrialist miliarder 79-vjeçar, ka investuar në kompaninë e transportit Navigator Holdings dhe e ka pjesën më madhe të pasurisë së tij prej rreth 2 miliardë dollarësh në Cayman Islands, një parajsë fiskale.



Ross nuk i kishte bërë të njohura lidhjet e biznesit me Rusinë kur ai mori konfirmimin e Senatit.

Zbulimi i dokumenteve lidhur me interesat financiare të zotit Ross në Rusi vjen ndërsa prokurori special Robert Mueller dhe tri komisione të Kongresit janë duke zhvilluar hetime lidhur me ndërhyrjen ruse në zgjedhjet presidenciale amerikane.

Një zëdhënës i Departamentit të Tregtisë tha se zoti Ross nuk përfshihet në çështje që lidhen me transportin transoceanik dhe konsultohet me zyrtarë të etikës të agjencisë që ai drejton, për të siguruar standardet e duhura të etikës.

SITUATA



Mesfushori i ri i Kombëtares Shqiptare, Kamer Qaka, ka treguar emocionet e tij të para pas marrjes së ftesës së grumbullimit për median norvegjeze "Nettavisen". "Është e pabesueshme, kam qarë për 20 minuta. U shokova. Idhujt e mi të fëmijërisë luajnë për Shqipërinë dhe nuk di çfarë të them. Ende nuk më besohet. Kam qenë në formë të mirë këtë vit dhe gjërat duken mjaft pozitive.

Qaka: Kam qarë 20 minuta kur mësova grumbullimin

Dëgjova 3-4 javë më parë nga njerëz të rëndësishëm në Shqipëri se unë duhet të grumbullohesha në kombëtare dhe se isha mjaftueshëm i mirë për të merituar dëkta të tillë. Më pas papritur mora një mesazh nga klubi ku më thanë se FSHF-ja i kishte kontaktuar

për të më grumbulluar. Më telefonuan nga Shqipëria për të më pyetur nëse isha i gatshëm të bashkohesha me kombëtares"-tha fillimisht Qaka. "Nuk kam folur direkt me Panuçin, por kam folur me disa njerëz të tjerë. Më pyetën: 'A do të vish në kombëtare?' Dhe unë u përgjig-

ja: 'Nuk është nevoja të më pyesni. Isha shumë i lumtur', shtoi 22-vjeçari. Mesfushori foli edhe për zgjedhjen e tij përfundimtare sa i përket ekipit kombëtar, duke qenë se më parë ka luajtur për moshat e Norvegjisë. "Unë dua të luaj për Shqipërinë, kjo është ëndrra ime. Staf i Shqipërisë më ka parë të luaj, por unë dua të aktivizohem edhe për Kombëtares që të më shohin më shumë", - përfundoi Qaka

Braziliani beson se skuadra vlonjate është pretendente për titullin kampion



Ky është sezoni i tretë që luaj me Flamurtarin dhe në skuadrën kuqezi, Danilo Alvësh është një nga lojtarët më të rëndësishëm. Sulmuesi brazilian është titullar i padiskutueshëm dhe në ndeshjen e djeshme kundër Kukësit, ai ishte në fushë. 26-vjeçari ka dhënë një intervistë ekskluzive për newsportal ku ka folur për këtë sezon të Superiores, duke dhënë edhe mendimin e tij për sa i përket gabimeve të gjyqtarëve kundër ekipit të Flamurtarit.

Danilo tregon edhe marrëdhënien e tij me trajnerin Duro ku zbulon se gjithçka ka ndryshuar dhe tashmë të dy shkojnë mjaft mirë për njëri-tjetrin.

Më në fund gjithçka duket e qetë në aspektin tuaj personal të Flamurtarit.

Mirë, faleminderit. Po, është e vërtetë. Jam shumë mirë dhe shumë i lumtur.

Luajtët kundër Kukësit, një ndeshje e kontestuar për sa i përket gjykimin. Çfarë ndodhi?

Në pjesën e parë ishte një lojë e balancuar nga të dy skuadrat, ndërsa në të dytën ne e kontrolluam lojën dhe luajtëm më mirë. Ne e merituar fitoren. Në golin e dytë, asnjëri nuk e preku topin dhe besoj se ishte i rregullit. Gjithashtu pati edhe një penallti për Flamurtarin, që nuk u shënuar.



Pra, mendon se unë ndëshkuar nga gjyqtari?

Unë po flas për atë që shoh në video. Në momentin e penalltisë, mbrojtësi i Kukësit ndërhyri keq ndaj dy lojtarëve tanë njëkohësisht. Në fakt, penalltia nuk është diskutuar, ndërsa për rastin e golit analistët kanë konkluduar se është pozicion jashtë lojë.

Nuk di çfarë të them (Qesh)

Mendon se Flamurtari është i denjë për të rivalizuar Skënderbeun?

Ne jemi duke punuar

shumë për të qenë mes të parëve. Janë edhe shumë ndeshje për t'u luajtur dhe shumë gjëra mund të ndodhin. Ka shumë gjëra dhe nuk mund të themi kaq shpejt se cili do të jetë ekipi kampion.

Ju kenë në skuadër një trajner që e njeh mjaft mirë Superligën. Tashmë duket se kenë një marrëdhënie të mirë me të. Sa beson Danilo në titull dhe sa beson te Duro?

Po, e vërtetë. Trajneri ka shumë eksperiencë. Diferencat e Flamurtarit në këtë se-

zon janë falë punës së mirë të bërë nga trajneri Duro. Unë tashmë kam një marrëdhënie mjaft të mirë me të. Dhe çfarë ka ndodhur, është pjesë e së kaluarës, gjëra që ndodhin në futboll. Kërkoj ndjesë dhe ndeshje pas ndeshje po mendohem të jap më të mirën. Për sa i përket titullit, ne po punojmë që të jemi të parët. Siç e thashë edhe më lart ka edhe shumë ndeshje në lojë dhe gjithçka mund të ndodhë. Ne jemi të fokusuar për të fituar ndeshjet dhe për të bërë më të mirën.

Danilo, a ndiheni të paragjykuar nga arbitrat? A hyni në fushë të frikësuar për vendimet e tyre?

Jo, ne nuk hyjmë në fushë me mendimin se do të dëmtohem. Shkojmë në fushë për të bërë gjithmonë më të mirën tonë. Megjithatë ga-

bimet e arbitrave po bëhen tashmë si një refren. Por, kjo çështje i takojnë drejtorit dhe presidentit për t'u zgjidhur. Ne futbollistët duhet të fokusohemi vetëm në ndeshjet.

Pse mendon se ndëshkohen vetëm Flamurtari nëse mund ta themi kështu? Pse jo ndonjë skuadër tjetër? Ti ke disa kohë që jeton në Shqipëri dhe e ke njohur mirë ambientin e futbollit tonë...

Nuk e di çfarë të them se çfarë ndodh me gjyqtarët kundër skuadrës sonë. Besoj se ky sezon është më i balancuar se gjithë vitet e tjera për sa i përket nivelit të ekipeve. Unë jam shumë i lumtur në Shqipëri dhe në Vlorë. Shpresoj të gënderrojmë.

Ç'premtim për të ardhmen?

Do të jap maksimumin tim dhe shpresoj të shënoj sa më shumë gola.

PLAY-OFF



Ventura: Do kualifikohemi ne, kemi vendin me vete

Gian Piero Ventura dhë konferencën e parë për shtyp, pas nisjes së grumbullimit të Italisë për përballjen e dyfishtë me Suedinë në fazën play-off të Botërorit. 69-vjeçari i ka të qarta vështrësitet që paraqet përballja me një kundërshtar fizik si Suedia, por ai thekson se Italia s'mund të mungojë në Rusi. Do të jetë një sfidë e vështirë, por ne duam të shohim përpara. Këtu ka futbollistë që mund të nisnin apo të mbyllnin një cikël, duke shkuar në Botëror, pra mund të ndryshojë fati i karrierës. Italia patjetër që duhet të jetë pjesë e "Rusi 2018". Nga risitë e listës, është Jorginho, por përse nuk është grumbulluar më parë? "Sepse e penalizonte moduli i lojës. Tani është thirrur sepse jemi para një përplasjeje të dyfishtë shumë të rëndësishme. Luhat për gjithçka dhe mund të bëjmë zgjedhje për çdo rol. Më shumë se moduli, në këtë rast vlen dëshira për të fituar. Zaza? Është rritur shumë muajt e fundit dhe ftesën e ka merituar. Është pjekur shumë nga Euro-piani, sidomos në aspektin psikologjik. Mbetet një vlerë e shtuar për ne." Belotti dhe Immobile, që janë pika referimi në fazën sulmuese, kanë shqetësime fizike. "E them edhe me ton egoist që, për fat të mirë, Immobile nuk luajti në ndeshjen mes Lazios dhe Udineses. Gara është kaq delikate se këto janë problemet e fundit që më shqetësojnë."

BATUTA

Daja: Nuk e heq Xhejms, e kam çun!

Ilir Daja është nga ata që nuk i pëlqen t'i ndërhyjnë. Punën e tij si trajner e sheh të "shenjtë" dhe vendimet kërkon që t'i marrë gjithmonë vetë, sigurisht duke u konsultuar me stafin e tij. Kohët e fundit, tifozët e ngacmojnë shpesh sidomos për nigerian Xhejms Adenij, i cili po luan në krahun e majtë të sulmit. Për të ka pasur goxha raste për gol, por nuk ka mundur të finalizojë. Daja e sheh si profesionist paraqitjen e Xhejms, ndërkohë që në sfidën me Villazninë një tifoz nuk ka ngurrur të ngacmojë, duke i thënë teknikut nga tribuna: "Po hiqe atë Xhejms, apo e ke njeriun tënd?!". E menjëherëshme përgjigja e Dajës, që me batutë ia kthen: "Nuk dua ta heq, e kam çun dajë".



ANGLI

Uest Hem shkarkon Biliç, vjen Mojes


Shkarkimi i trajnerëve pas rezultateve të dobëta është një manual që përdoret në gjithë botën. Në Superiore e pësoi një ditë më parë Mark Juliano, që u shkarkua nga Partizani. Paraqitjet dhe rezultatet bënë të veten, ndërkohë që për të njëjtën arsye në Angli ka ardhur shkarkimi i kroatit Slaven Biliç. Lajmi është dhënë nga klubi i Uest Hem Junajtidi, që falënderon trajnerin dhe



shprehjet se tashmë janë në kërkim të zëvendësuesit. Emri që do ta pasojë me shumë mundësi është 54-vjeçari David Mojes, që së fundmi ka drejtuar Sanderlendin. Skocezi është bërë i njohur tek Evertoni, ekip që e ka drejtuar për 11 vite. Ai ka drejtuar edhe Manchester Junajtidi dhe Real Sociedadin. Tashmë pritet zyrtarizimi të Uest Hemi.



**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

1. Salacrou dramaturg
6. Blair e Ekzorcistët.
9. I bylbylit ai i Mjedës.
10. Inicialet e Morricones
12. Gjysmë vektor.
13. Një port përballë Xhibutit.
14. Në mes të Salt dhe City.
16. Janë stacionet e beduinëve.
19. Një pjesë e taktikës.
20. Janë tifozë partie.
22. Janë firmat mashtruese.
23. Përpunojnë naftë.
27. Janë konservatorë.
28. Eshhtë derri.
30. Një monedhë maqedonase.
31. Kufizojnë ambiente.
33. Inicialet e Gould aktor.
34. Fillojnë jetën.
36. Janë dëshmorët.

39. U shkrua nga Garcia Lorca.
44. Janë baballarët.
45. Tregon çmimin dhe modelin.
47. Eshhtë ujëvara.
48. Një mund të jetë mbi xhiro.

**VERTIKAL**

1. Film i James Cameron.
2. Jeronim de i Milosaos.
3. Eshhtë doktori me bluzë të bardhë.
4. Agjenci Informacioni Ndërkombëtare.
5. Janë si jerm.
6. Fillojnë lejen.
7. Klikohet me mouse
8. Një vegël.
11. Luftohet me kinina.
12. Janë cilësi.
15. Janë reaksionet në epurveva
17. Një sportist që kërcen me shkop.
18. Janë tek në zhele
20. Eshhtë kullë xhamie.
21. Bëhet një për zakon.
22. Gruaja e Fantozzi-t
24. Gjysmë afërsi.
25. Janë ndriçues.
26. Nuk duhet shkelur një i tillë.
29. U shkel për herë të oarë nga Neil Armstrong.
30. Një fjalë për gjoja.
32. Garbo e kinemasë.
35. Braktisi Didonën.
36. Me të bëjnë një thikë.
37. Mund të jetë gjaku.
38. Janë dhoma.
40. Ai dhe ajo.
41. Ushtria republikane irlandeze.
42. Agjenci Transporti Korçë.
43. Me stpon në box.
46. Inicialet e Moravia-s.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


1. Ishite babai i parë.
6. I ndërmarrj progresistët.
14. Thyhet një me kohën më të mirë.
16. U braktis nga Helena.
17. Seritë pa zë.
18. Kryeqyteti i Kinës.
20. Ramazotti këngëtar.
21. Eshhtë sport me vozitje.
25. Ndërmarre Industriale Rajonale.
26. Janë sherre në shtyp.
27. Inicialet e Clapton.
28. Eshhtë shuma e brinjëve të drejtëndëshit.
30. Një letrar është tregimi.
32. Fillojnë nazet.
33. Matet pa kufij.
36. Inicialet e Kokoschka piktor
37. Kufijë mendimet.
38. Bergman që qe aktore.
40. Eshhtë shpërblimi në para.

**VERTIKAL**


1. Wenger trainer.
2. Stefan i interpretuar nga Horst Tappert
3. Një është edhe Bujar Lako
4. Fillojnë mobilizimin.
5. Institucione Rajonale Polake.
7. Një rapper i famshëm.
8. Kështu thirrej Ronaldo, bomberi brazilian
9. Ndezur në aparatë.
10. Një film i ribërë.
11. Ekstreme në model.
12. Dy asa.
13. Eshhtë fytyra kamionit.
15. Mund të bëhet me medalje trimërie.
19. Mund të jenë të rastit.
22. E ka simbolin Ti.
23. Eshhtë dëm, qeder.
24. Inicialet e Tappert.
26. Një pjesë e pejsazhit.
28. Ndahet në barazim.
29. Janë kandilë deti
31. Hayborh që qe aktore
34. Eshhtë enë për të skuqur.
35. Emri i Zola.
39. Gjysma e globit.
41. Janë në skaje.
42. Kryqyteti i Letonisë.
43. Eva... Isabel Allende-s
47. Një stacion i famshëm orbital
51. Inicialet e Lennon.
52. Diftong në duet



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)



FJALËKRYQI (2)

**SUDOKU**

|   |   |   |   |   |   |   |   |   |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 |   | 9 |   | 5 | 7 |   |   | 6 |
| 3 | 2 | 5 | 1 |   |   |   |   |   |
|   | 8 |   |   | 3 |   | 4 |   | 1 |
|   | 7 |   |   | 2 | 8 |   |   |   |
|   | 6 | 2 |   |   |   | 9 | 1 |   |
|   |   |   | 9 | 6 |   |   | 7 |   |
| 6 |   | 3 |   | 8 |   |   | 9 |   |
|   |   |   |   |   | 4 | 5 | 3 | 7 |
| 1 |   |   | 5 | 9 |   | 2 |   | 8 |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

|   |   |   |   |   |   |   |   |   |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 8 | 3 | 6 | 9 | 5 | 2 | 4 | 7 |
| 5 | 9 | 6 | 7 | 2 | 4 | 1 | 8 | 3 |
| 2 | 7 | 4 | 1 | 3 | 8 | 9 | 5 | 6 |
| 6 | 3 | 5 | 9 | 7 | 2 | 4 | 1 | 8 |
| 7 | 4 | 9 | 8 | 1 | 6 | 3 | 2 | 5 |
| 8 | 1 | 2 | 4 | 5 | 3 | 6 | 7 | 9 |
| 4 | 2 | 8 | 3 | 6 | 7 | 5 | 9 | 1 |
| 9 | 6 | 7 | 5 | 4 | 1 | 8 | 3 | 2 |
| 3 | 5 | 1 | 2 | 8 | 9 | 7 | 6 | 4 |

*Argëtim filozofik*

- Njeriu që vepron qëndron më pranë njerzëve se sa njeriu që shkruan dhe është në dorën e njerzëve që idetë e reja, të përthehen në gjuhën e ashpër të veprave. (Rudru Uillson)
- Kur i drejtoheni forcës, një gjë nuk duhet të bëni kurrë: të humbisni. (Duajt Ajzenhauer)
- Një njeri i guximshëm arrin të jetë mazhorancë. (Endrju Xhekson)

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

|    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |    |
|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|
| 14 | S  | I  | S  | P  | A  | 3  | 11 | 11 | 15 | 9  | 14 | 3  |
| 2  | 8  | 2  | 9  | 2  | 6  | 15 | 9  | 2  |    | 17 | 11 |    |
| 6  |    | 6  | 5  | 8  | 2  | 6  |    | 8  | 2  | 8  | 2  | 14 |
|    | 11 | 4  | 12 | 2  | 7  |    | 6  | 2  | 11 | 2  |    | 3  |
| 8  | 2  | 9  | 4  | 6  | 3  |    | 6  | 9  | 15 | 9  | 3  |    |
|    | 9  | 8  |    | 3  | 2  | 12 |    | 4  | 7  | 3  | 2  | 14 |
| 4  | 6  | 2  | 6  |    | 2  |    |    | 6  | 3  | 14 |    | 17 |
| 8  | 5  | 13 | 19 |    | 4  | 9  | 3  |    | 3  | 15 | 6  |    |
| 3  | 7  |    | 6  | 19 | 12 | 5  |    | 4  | 12 |    | 11 | 4  |
| 6  | 3  | 9  | 2  | 13 | 4  | 6  |    | 9  | 3  | 12 | 2  | 6  |
| 4  | 13 |    | 6  | 3  | 6  | 2  | 13 | 3  | 11 | 4  |    | 4  |
| 0  | 2  | 15 |    |    | 4  | 9  |    | 11 | 15 | 9  | 2  | 6  |

|   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| E | P | O | S |   | M | P | L |   |   |   |   |   |
| R | E | T | E |   | V | A | R | I | A | N | T |   |
| E | L | I |   |   | T | E | N | I | S | T | E | T |
| N | E |   |   |   | K | A | P | I | T | U | L | L |
| D | M | I | U | R | A |   | S | E | S |   |   |   |
| E | A | L | L | A | K | U |   | T | O | T |   |   |
|   | K | A | M | A | T | E |   | I | N | O |   |   |
| A | S | E | N | T |   | T | K |   | P |   |   |   |
| V | A | R | T | I |   | I | R | A | N | I |   |   |
| A | L | T |   | E | M | I | L | E | D |   |   |   |
| R | O | J | E | T |   | K | E | N | D | E | T |   |
| I | N | E | S |   | P | A |   | I | N | R | I |   |

*Thënie të mënçura*

- Fëmijët kurrë nuk kanë qenë të zotë të dëgjojnë të rriturit, por kurrë nuk kanë dështuar t'i imitojnë ata...
- Papjekuria është paaftësia që dikush të përdorë inteligjencën e vet pa u prirë nga të tjerët. Immanuel Kant, Filozof (1724-1804)
- Mënyra e vetme për të jetuar, është të pranosh çdo minutë të kësaj jete si një mrekulli të papërsëritshme. (M. Storm Xhejmson)
- Mediokriteti nuk njih asgjë më të lartë se veten e vet. (A. Konan Dojl)

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

# GAZETA SHQIPTARE

# GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

# GSH

www.gsh.al

## GAZETA SHQIPTARE



## Tashmë edhe lundroni!

